

الله
رسول
محمد

FSHEHTËSIA E SPROVËS

Çdo krijesë do ta shijojë vdekjen,
e Ne, në shenjësprove ju
sprovojmë me vështirësi
e kënaqësi, dhe ju
ktheheni te Ne.
(Enbija, 21:35)

HARUN JAHJA
(ADNAN OKTAR)

Me çfarë je preokupuar gjatë jetës: me brengosje se si do të regjistrohesh në fakultetin e preferuar, si ta gjesh një vend pune të mirë, bashkëshort/e për qejfi, për të fituar shumë para..? Çfarë je munduar të arrish: famë, pasuri, reputacion..?

Derisa je munduar që t'i arrish këto synime, a të ka ra ndërmend ndonjëherë kjo e vërtetë: se të gjitha këto caqe janë të përkohshme, dhe se asnjërin nuk do ta marrësh me vete pas vdekjes. Pas vdekjes, çfarë do të ndodh? Do të kalosh në botën e pastajme, ku e vetmja gjë që do të jetë e dobishme do të jenë veprat e punuara në këtë botë që kanë pasur qëllim që të fitohet kënaqësia e All-llahut.

Kur'ani thekson se kjo botë është "vend sprovës" që do të përcaktojë vendin e secilit në jetën e pastajme. Gjatë këtyre sprovave, i zbulohemi njeri tjetrit si dhe All-llahut, se kush jemi në të vërtetë.

Ata që arrijnë të kuptojnë këtë fshehtësi dhe jetojnë duke e ditur se janë në sprovë do të fitojnë një begati të amshueshme: kënaqësinë e All-llahut në xhenet.



RRETH AUTORIT

Adnan Oktar, i cili shkruan nën pseudonim Harun Jahja, ka lindur në Ankara në vitin 1956. Që nga viti 1980, autori ka botuar shumë libra mbi çështjet lidhur me besimin, shkencën dhe politikën. Ai është i njohur si autor i veprave të rëndësishme të njohura për demaskimin e mashtrimit të evolucionistëve, pretendimet e tyre të pavlefshme, dhe lidhjeve të errëta në mes të Darvinizmit dhe ideologjive të tilla të përgjakshme si fashizmi dhe komunizmi.

Të gjitha veprat e autorit kanë një qëllim të vetëm, të përcjellin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit të marrin në konsideratë besimin bazë lidhur me çështje të tilla si ekzistenca e Zotit, unitetit dhe botën tjetër, dhe për të ekspozuar e vënë në dukje themelet e sistemeve të dobëta dhe të ideologjive çoroditëse jofetare. Më shumë se 300 veprat e tij, të përkthyer në 72 gjuhë të ndryshme, gëzojnë dhe kanë një rrjet të gjerë lexuesish në të gjithë botën. Me vullnetin e Zotit, librat e Harun Jahja do të jetë një mjet përmes të cilit njerëzit në shekullin njëzet e një do të arrijnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kuran.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



اللَّهُ
رَسُولُهُ
مُحَمَّدٌ



FSHEHTËSIA E SPROVËS

Çdo krijesë do ta shijojë vdekjen, e Ne, në
shenjë sprove ju sprovomë me vështirësi
e kënaqësi, dhe ju ktheheni te Ne.
(Enbija, 21: 35)

HARUN JAHJA
(ADNAN OKTAR)



Dy fjalë rreth autorit dhe veprave të tij

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Harun Jahja është njohur mirë si autor i veprave të rëndësishme, të cilat zbulojnë mashtrimin e evolucionistëve, pohimet e tyre të pavërteta dhe lidhjet e errëta midis Darwinizmit dhe ideologjive gjakësore, të tilla si: fashizmi dhe komunizmi.

Veprat e Harun Jahjasë, të përkthyer në 72 gjuhë të ndryshme, përbëjnë një koleksion prej mëse 55,000 faqesh me 40,000 ilustrime. Pseudonimi i tij është një ndërthurje e emrave të Harunit (Aaron) dhe Jahja (John), në kujtim të dy Profetëve të nderuar, të cilët luftuan kundër mohimit të besimit. Vula e Profetit në librat e tij është një simbol i cili është i lidhur me përmbajtjen e tyre. Ky simbol paraqet Kur'anin (Shpalljen e Fundit) dhe Profetin Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), Profetin e fundit. Nën dritën e udhëzimit të Kur'anit dhe Sunnetit (traditës dhe mësimëve të Profetit), autori i ve vetes si qëllim të hedhë poshtë çdo ngrehinë të ideologjive që mohojnë fenë dhe të thotë "fjalën e fundit" në mënyrë që ta bëjë të heshtë çdo kundërshtim ngritur kundër fesë. Ai e përdor vulën e Profetit të fundit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), i cili arriti urtësinë më të lartë dhe përsosmërinë morale, si një shenjë të qëllimit të tij për të ofruar fjalën e fundit.

Të gjitha veprat e Harun Jahja kanë një qëllim të përbashkët: të japin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit për të menduar mbi çështje që kanë të bëjnë me besimin, si për shembull, ekzistenca e Allahut dhe njëshmëria e Tij dhe besimi në Botën Tjetër dhe njëkohësisht të nxjerrë në pah rrënjët e kalbura të sistemeve antifetare dhe ideologjive të devijuara.

Harun Jahja gëzon një rang të gjerë lexuesish në shumë vende të botës, që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, Poloni, e deri në Bosnjë, Spanjë, Brazil, Malajzi, Itali, Francë, Bullgari, e deri në Rusi. Disa nga librat e tij mund të



gjenden në gjuhën Angleze, Frënge, Gjermane, Spanjolle, Italiane, Portugeze, Urdu, Arabe, Shqipe, Kineze, Dhivehi (folur në ishujt Mauritius) Ruse, Serbo-Croate (Boshnjake), Polake, Malaje, Turke, Uygur, Indoneziane, Bengali, Daneze dhe Suedeze.

Duke qënë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një depërtim më të thellë në besimin e tyre. Menguria dhe sinqeriteti që i karakterizon librat e tij, së bashku me një stil të veçantë që është i lehtë për t'u kuptuar, ndikon drejtpërdrejt çdokënd që i lexon. Ata që i studiojnë me kujdes këta libra, nuk mund të mbrojnë më ateizmin apo ndonjë ideologji tjetër të devijuar apo filozofi materialiste, sepse këta libra karakterizohen nga një ndikim i shpejtë, përfundime të qarta dhe janë të pakundërshtueshëm. Edhe nëse këta njerëz do të vazhdojnë të këmbëngulin në të tyren, nuk do të jetë gjë tjetër veçse një këmbëngulje të kotë, sepse këta libra përmbysin ideologji të tilla që nga themelet. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore antifetare tashmë mbrohen ideologjikisht, falë librave të shkruar nga Harun Jahja.

Kjo është, pa dyshim, një rezultat i urtësisë dhe dritës së Kur'anit. Autori në mënyrë modeste dëshiron të shërbejë si një mjet në kërkimin njerëzor të rrugës së drejtë të Allahut. Prej botimit të këtyre materialeve nuk kërkohet asnjë përfitim material.

Ata njerëz që inkurajojnë të tjerët për të lexuar këto libra, për të hapur mendjet dhe zemrat e tyre dhe për t'i udhëzuar ata të bëhen robër të devotshëm të Allahut, kryejnë një shërbim të paçmuar.

Njëkohësisht, do të ishte një humbje kohe dhe energjie për të reklamua libra të tjerë, të cilët krijojnë çoroditje në mendjet e njerëzve, i shpien ata në kaos ideologjik dhe që nuk kanë një ndikim të fortë dhe preciz në largimin e dyshimit prej mendjeve të njerëzve, siç është vërtetuar nga përvoja e përparshme. Për librat që janë shkruar vetëm e vetëm për të nxjerrë në pah fuqinë letrare të shkrimtarit se sa qëllimin fisnik për t'i shpëtuar njerëzit nga mungesa e besimit është e pamundur që të kenë një ndikim kaq të madh. Ata që e venë në dyshim këtë mund të shohin qartë se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjasë është të mposhtë mosbesimin dhe, njëkohësisht, të përhapë vlerat morale të Kur'anit. Suksesi dhe ndikimi i këtij shërbimi shfaqen qartë në bindjen e lexuesve.

Një gjë duhet të mbahet parasysh: Arsyeja kryesore për vazhdimin e mizorisë, konflikteve dhe telasheve të tjera që po përjetojnë shumica e njerëzve sot është mbizotërimi ideologjik i mosbesimit. Kësaj mund t'i jepet fund vetëm me mposhtjen ideologjike të tij dhe, njëkohësisht, duke transmetuar mrekullitë e krijimit dhe moralin e Kur'anit, në mënyrë që njerëzit të jetojnë sipas tij. Duke patur parasysh gjendjen e botës sot, që po precipiton në një spirale dhune, korrupsioni dhe lufte, është e qartë se ky shërbim duhet të jepet shpejt dhe në mënyrë të suksesshme, përndryshe, do të jetë tepër vonë.

Në këtë drejtim, librat e Harun Jahjasë marrin një rol udhëheqës. Me lejen e Allahut, këto libra do të jenë një mjet, nëpërmjet të cilit njerëzit në shekullin e XXI do të gjejnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.

PËR LEXUESIN

Të gjithë librat e Harun Jahjasë shpjegojnë tema që kanë lidhje me besimin nën dritën e vargjeve kuranore dhe i ftojnë lexuesit të mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë në përputhje me to. Të gjitha çështjet në lidhje me ajetet kuranore janë shpjeguar në mënyrë që të mos lihet vend për dyshim apo për pyetje në mendjen e lexuesit. Stili i thjeshtë dhe i rrjedhshëm i librave bën të mundur që çdo njeri i çfarëdo moshe qoftë dhe i çfarëdo grupi shoqëror t'i kuptojë ata me lehtësi. Falë shpалosjes së tyre mbresëlënëse dhe të ndritshme, ata mund të lexohen me një frymë. Madje, edhe ata njerëz që e refuzojnë besimin ndikohen nga faktet që dokumentojnë këta libra dhe nuk mund të hedhin poshtë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

Ky libër, po ashtu, të gjithë librat e Harun Jahja mund të lexohen vetëm ose të diskutohen në grup. Lexuesit e etur për të përfitur nga librat do të zbulojnë se diskutimi është mjaft i dobishëm dhe u mundëson atyre të shkëmbejnë mendimet dhe përvojën e tyre me të tjerët.

Një shërbim i madh për Islamit do të ishte ndihma në botimin dhe leximin e këtyre librave shkruar vetëm për hir të Allahut. Të gjithë librat e Harun Jahjasë janë jashtëzakonisht bindës. Për këtë arsye, për t'ia komunikuar të tjerëve fenë e vërtetë, një nga mënyrat më të dobishme do të ishte nxitja për të lexuar këta libra.

Shpresojmë se, lexuesi do t'i hedhë një sy përmbledhjeve të librave të tjerë të autorit, të cilat janë vendosur në pjesën e pasme të këtij libri. Lënda e tij e pasur në çështjet e besimit është mjaft e dobishme dhe të sjell kënaqësi në lexim.

Në këta libra, ndryshe nga librat e tjerë, janë mënjeluar tërësisht pikëpamjet personale të autorit, shpjegimet e bazuara në burime të dyshimta, stile që nuk i kushtojnë kujdesin e duhur temave fetare, dhe as argumente të pashpresë apo pesimistë, të cilët krijojnë dyshime në mendjen e lexuesit dhe mosbesim në zemrat e tyre.

www.harunyahya.com/albanian

www.en.harunyahya.TV

PËRMBAJTJA

Hyrja	8
Bota është vendi sprovës	10
Fsheht sia e sprovës	21
Myslimani n momentete vështira	30
Si sillen jobesimtarët kur përballen me vështirësi.	58
Sprova vazhdon deri në vdekje	64
Përfundimi	71
Mashtrimi I Evolucionit	73

HYRJA

Për të fituar një gjë të bukur gjatë gjithë jetës tuaj keni shpenzuar energji dhe punë serioze. Kujtojeni periudhën e shkollimit, kur gjërat që kanë zënë vend më së shumti në kokën tuaj, dhe shpesh herë jeni përballuar me to, janë provimet. Kurse më i rëndësishmi nga këto pa dyshim që është provimi pranues i fakultetit. Shumë njerëz këtë provim e njohin si

uar. Sipas kësaj njeriu gjatë gjithë kësaj kohe duhet të mendojë që ta njohë Krijuesin, t'i nënshtrohet ligjeve të Tij dhe vetëm nga Ai të kërkojë strehim, mëshirë dhe begati. Mbi të gjitha njeriu është i obliguar që çdo gjë që i ndodhë brenda kësaj jete kalimtare t'i përgjigjet më kënaqësi, të bëj durim dhe të tregoj moral të lartë. Ai duhet ta dijë se të gjitha ato që i ndodhin janë sprova që vijnë nga All-llahu i madhëruar. Këto sprova janë fshehtësi që u përkasin të gjithëve.

Pa dyshim ai që i kupton këtë fshehtësi të sprovave dhe jeton sipas tyre, dhe kur ti ndodh ndonjë gjë thotë “ Në të All-llahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi” ka fituar një gjë të madhe që do ta bëjë të lumtur si në këtë botë gjithashtu dhe në botën tjetër.

Qëllimi i këtij librit, është që t'ua bëjë të njohura këto te vërteta njerëzve që e kalojnë jetën e tyre pa e qarë kokën për përgatitjen për botën tjetër. All-llahu xh. sh. në thotë kështu:

Dhe i sqaruam atij për të dy rrugët. E ai nuk u hodh në përpjetëzen (rruga e vështirë -qaf malit)? E ç'gjë të mësoj ty se ç'është Akabe (rruga e vështirë)? Është lirimi i një skllavi, Ose dhënia e ushqimit në kohën kur mbretëron uria: Ndonjë jetimi që është i afërt, Ose ndonjë të varfëri që e ka molisur varfëria. E pastaj të bëhej prej atyre që besuan, që këshilluan njëri- tjetrin për durim dhe që këshilluan për mëshirë (për ndihmë) Të tillët janë të zotët e anës së djathtë Ndërsa ata që nuk i besuan argumentet Tona ata janë të së majtës. Kundër tyre është zjarri i mbyllur. (Beled, 90: 10-20)

BOTA ËSHTË VEND I SPROVËS

Njeriu si çdo krijesë tjetër është krijuar nga Allahu për një qëllim. Qëllimin e krijimit të tij dhe se si duhet të kalojë jetën e kësaj bote, më së miri e tregon udhëzuesi, këshilltari që ka zbritur nga ana e All-llahut, Kur'ani famëlartë, në të cilin Allahu thotë: **“A menduat se Në ju krijuam kot dhe se nuk do të ktheheni ju te Ne?”** (Mu'minun, 23:115). Siç shihet në këtë ajet njeriu qenka krijuar për një qëllim. Se cili është qëllimi i krijimit të tij, All-llahu na bën me dije ku thotë: **“Unë nuk i krijova njerëzit dhe xhinët për asgjë tjetër vetëm që t'më adhurojnë”** (Dharijatë, 51:56). Pra sipas këtij ajeti njeriu qenka krijuar vetëm ta adhurojë All-llahun.

Jeta e njeriut zgjatë rreth 60-70 vjet. Porsi ora e rërës, jeta kalon në mënyrë të vazhdueshme. Në këtë botë çdo gjë qëndron vetëm sa e ka caktuar All-llahu. Kurse këtë caktim nuk mund ta dijë askush përpos Tij. Këtu hyn dhe jeta e njeriut që nuk mund ta ndryshojë askush.

Kur të vije koha një ditë do të shkatërrohet çdo gjë që ekziston në këtë gjithësi, ku do të mbizotëroj vetëm Zoti bujar. Pra në këtë botë, çdo gjë qenka kalimtare e përkohshme. Por bota tjetër është e përhershme dhe e paskajshme. Kjo botë në të cilën jetojmë ne, është

si një përjetim ku edhe këtë e thotë All-llahu në Kur'an: **“E jeta e kësaj bote ndaj botës tjetër nuk është tjetër vetëm se një përjetim (i shkurtër)”**. (Rra'd, 13:26). Siç shihet edhe nga ajeti kuranor kjo botë qenka vetëm një përjetim i përkohshëm. Kurse bota tjetër e përhershme e cila nuk do të ketë fund kurrë. Në rregull, por pse po themi që kjo botë ku gjendemi është kalimtare? Sepse çdo gjë që gjendet në të nga dita në ditë shkon drejtë prishjes, shkatërrimit dhe vjetërimit. Koha çdo gjë e dërgon kah shkatërrimi dhe ata të cilët lidhën pas këtyre gjërave kaluese janë në një humbje te madhe. Prandaj edhe i dërguari ynë savs ka këshillua njerëzit që të kenë mendjen tek vdekja duke thënë: *“Ata që ia vejnë veshin vdekjes dhe përgatitën për të, ata janë më të mençurit.”*¹

Dijetari islamik Bediuzzaman Said Nursi vazhdimisht lexuesve të vet u ka theksuar përkohshmërinë e kësaj bote dhe që njeriu duhet të bëjë përpjekje serioze për të fituar botën e pastajme:

“Kjo bote është si një han e sa për njeriun, ai do të qëndroj aty shumë shkurt. Ai është mysafir me shumë detyra dhe gjatë jetës së tij të shkurtër duhet përgatitur të gjitha gjërat e nevojshme për jetën e amshueshme”.²

Dijetari që e përshkruan jetën e kësaj bote si një *“fjetore të përkohshme”* në një shembull tjetër thotë kështu: *“Ekzistenca njeriut nuk i është dhënë që ta fitojë jetën e kësaj bote sikur kafshët”*, dhe vazhdon duke thënë:

“O shoku im dhe epshi im! Mblidhni mendtë. Mos e harxhoni në këtë jetë të përkohshme kapitalin dhe talentin e jetës tuaj sikur kafshët bile edhe më poshtë se ato. Sepse kafshët vetëm sipas rrethanave të kësaj bote jetojnë dhe çfarë është bota tjetër nuk e dinë”.³

Pra, pas gjitha këtyre fjalëve të dijetarit islam jeta e kësaj bote qenka e përkohshme ku njeriu nuk duhet të jepet pas bukurive, vlerave të përkohshme dhe epsheve që gjenden në të. Mos të

harrojmë se njeriu me këto bukuri, stoli vazhdimisht është duke u sprovuar. Ai nëse nuk jepet pas tyre, atëherë a ka fituar lumturinë dhe kënaqësinë në të dy botët.

Njeriu në këtë botë sprovohet me durim, që treguar gjatë situatave që i përjeton. Kur t'i ndodh diçka çdo herë duhet ta dijë se kjo është nga Allahu. Por vetëm kjo s'është e mjaftueshme; por duhet besuar në All-llahun me një besim të paluhatshëm. Nuk mjafton vetëm të thotë "Besova". Ai duhet të mos gënjejë, të mos shajë, te mos bëj zina, etj. dhe të largohet nga të gjitha ato punë që i ka ndaluar Kur'ani, sepse nëse i vepron ato punë që i ka ndaluar i Lartëmadhërishmi në botën tjetër do të jetë nga të hidhëruarit. Në botën tjetër nuk do të mbesë asgjë e fshehur nga veprat që ka vepruar në këtë botë. Të gjitha do të dalin në shesh dhe llogaria për veprat që ka vepruar do të bëhet në mënyrë shumë korrekte. Siç thuhet në Suren Nisa, 4:49: **"All-llahu vlerëson atë që do dhe nuk bën padrejtë asnjë fije"**. Ata që kanë vepra të mira do të hynë në bukuritë që ka përgatitur All-llahu xh sh për ta, kurse ata që kanë bërë vepra të këqija do të përballohen me zjarrin e xhehenemit, e sa i keq është ai. Shkuarja në këto dy vende bëhet sipas veprave që i punon njeriu në këtë botë. Sepse Allahu jetën e shkurtër të kësaj bote e ka krijuar që t'i sprovtoj njerëzit se cili nga ata është më vepër mirë. Këtë të vërtetë Allahu në suren Mulk, 67:2 e thotë kështu:

Ai është që krijojë jetën dhe vdekjen për t'iu provuar se cili prej jush është më vepër mirë, Ai është ngadhënjyes mëkat falës.

Këmbimi i jetës së pastajme me jetën e kësaj bote

Njëra nga gabimet më të mëdha që bëjnë jobesimtarët, është bindja i tyre se do të qëndrojnë gjithmonë në jetën e kësaj bote dhe mosdija se do të sprovohen. Ka shumë bukuri dhe kënaqësi në këtë

botë që mashtrojnë njerëzit dhe jetojnë të papërgatitur për botën tjetër. Njerëzit në shoqëritë ku shpërfillet bota tjetër, që nga fillimi i ardhjes së tyre në këtë botë anojnë me lakmi që t'i posedojnë ato vlera vetëm për vetën e tyre. All-llahu në Kur'an për ata njerëz që pasojnë me lakmi stolitë dhe kënaqësitë e kësaj bote tregon kështu:

Njerëzve u është zbukuruar dashuria ndaj të këndshmeve, ndaj grave, djemve e ndaj pasurisë së grumbulluar nga ari e argjendi, ndaj kuajve të stolisur, bagëtisë e bujqësisë. Këto janë kënaqësi të kësaj bote, po tek All-llahu është e ardhmja më e mirë. Thuaj: "A t'iu kumtoj për diç shumë më të mirë se ato (kënaqësitë e dynjasë)? Për ata që janë ruajtur, ata kanë tek Zoti i tyre xhennete nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe aty do të jenë përgjithmonë, kanë edhe bashkëshorte të pastra e gëzojnë edhe kënaqësinë e All-llahut. All-llahu është i kujdesshëm për robët". (Ali-Imran, 3:14-15)

Sipas këtyre dy ajeteve kuranore shihet qartë se njerëzit kanë shumë dëshira. Po edhe nëse i realizojnë ato dëshira që u përmenden më lartë në ajetet kuranore nuk duhet ta harrojmë Krijuesin duke ndjekur këto dëshira. Nëse e harrojmë Atë dhe pasojmë këto dëshira, puna jonë nuk do të jetë në rregull. All-llahu në ajetet 45-46 të sures Kehf në këtë mënyrë përshkruan gjendjen e vërtetë të njerëzve që pasojnë me lakmi jetën e kësaj bote:

E ti (Muhammed) paraqitu atyre shembullin e kësaj bote që është si një ujë (shi) që Në e lëshojmë nga qielli, e prej tij bima e tokës zhvillohet e shpeshtohet, saqë përzihet në mes vete, e pas pak ajo bëhet byk (pas tharjes) që e shpërndajnë erërat. All-llahu ka fuqi për çdo send. Pasuria dhe fëmijët janë stoli e jetës së kësaj bote, kurse veprat e mira (fyti i të cilave është i përjetshëm) janë shpërblimi më i mirë te Zoti yt dhe janë shpresa më e mirë.

FSHEHTËSIA E SPROVËS

Siç u tregua në këto ajete kuranore të gjitha këto stoli, bukuri, kënaqësi të lloj-llojshme që i përkasin kësaj bote si; pasuria, bashkëshortët, xhevahiret, fama, karriera...etj nuk janë asgjë tjetër vetëm se një mashtrim që shumë shpejtë një ditë do ta humbasin vlerën dhe ekzistencën e tyre.

Por një pjesë e madhe e njerëzve nuk janë në dijeni se këto gjëra janë të përkohshme. Ata bëjnë çmos vetëm për t'i arritur këto. Disa vazhdimisht mundohen që të grumbullojnë mall, e disa përpiqen që të fitojnë respekt nga njerëzit, ndërsa disa përpiqen që të gjejnë bashkëshortë tërheqës dhe të mrekullueshëm kurse disa të tjerë mundohen të bëhen më të suksesshmit në lëmin e tyre. Ata aq shumë jepen pas këtyre gjërave që i përmendëm më lartë sa që këto gjëra bëjnë ta harrojnë krejtësisht jetën e amshueshme. Ata vdekjen e konsiderojnë si zhdukje dhe nuk mendojnë të përgatiten për jetën pas vdekjes.

Ndërsa dijetari islam Beduizzaman Said Nursiu vdekjen nuk e përshkruan si zhdukje po si një shpagim i punëve që bëhen gjatë sprovave në jetën e kësaj bote. Dhe vazhdon duke thënë:

“Në këtë gjithësi është e dukshme zhdukja, humbja dhe ndarja. Ndarje të vërtetë nuk ka, por ka bashkim. Humbje, zhdukje nuk ka, por ka përtëritje. Vdekja është transferim nga kjo botë e përkohshme për në botën e përhershme.

Vdekja nuk është edhe aq e tmerrshme sa duket. Nën dritën e Kur'anit Famëllartë, në shumë pjesë të Risale-i Nur kemi dëshmuar në mënyrën më të qartë dhe të padyshimtë se vdekja e besimtarit është vetëm shkarkim nga detyrat e kësaj jete. Është pushim nga adhurimi, që ishte udhëzim dhe ushtrim në arenën e sprovave të kësaj bote. Gjithashtu do të thotë bashkim me shokët dhe të afërmit, me 99 përqind të tyre që kanë kaluar në botën tjetër. Ka domethënie të kalimit në vendlindjen e vërtetë dhe vendbanim të amshueshëm së lumturisë. Është gjithashtu edhe ftesë për

kopshtet e xhenetit nga qelia e kësaj bote. Është koha që të marrin pagesën nga bujaria e Krijuesit të Gjithëmëshirshëm si shpërblim për shërbimin ndaj Tij. Pasiqë kjo është e vërteta për vdekjen, ajo nuk duhet konsideruar si e tmerrshme, por përkundrazi, si një hyrje për në mëshirë dhe lumturi.⁴

Me fjalë tjera, është gabim i madh nëse mendohet se kjo botë është vendbanimi ynë i vërtetë. Në krahasim me jetën e pastajme, kjo jetë nuk zgjatë as një minutë i plotë. Në një vend tjetër, Beduizzaman jep një shembull se si është e pakuptimtë nëse dikush zgjedh jetën e kësaj bote, në vend të pastajmes:

Gjithashtu, ai flet vërtetë për ardhmërinë duke krahasuar ardhmërinë në këtë botë me një vegim. Ai flet me tepër seriozitet për lumturinë ku lumturia e kësaj kohe është vetëm si një shkrepitimë e shpejtë e vetëtimës në krahasim me diellin e amshueshëm.⁵

Myslimanët që janë në dijeni për këtë të vërtetë nuk largohen nga kjo botë me hidhërim, por largohen me kënaqësi e lumturi. Ata shpresojnë se do ta marrin atë që ua ka premtuar All-llahu në jetën e amshueshme. Ata jetojnë me një entuziazëm duke shpresuar në mëshirën e Krijuesit. Kur’ani Famëlartë për gjendjen e atyre që menduan se kjo botë është e përhershme e tregon kështu:

Ata janë që në vend të udhëzimit e morën humbjen dhe dënimin në vend të shpëtimit. Sa të durueshëm qenkan ata ndaj zjarrit?” (Bekare, 2:175).

Në një ajet tjetër thuhet se ata kanë bërë një gabim të madh “duke e blerë mosbesimin me çmim të besimit”. Do të përpiqem ta japim një shembull për ta kuptuar me lehtë gjendjen e këtyre personave që gjenden në një humbje të tillë:

Paramendojeni dy njerëz! Këtyre dy njerëzve t’iu jepet një kapital i madh, kurse mënyra se si do ta shpenzojnë le të vendosin vetë. Njëri nga këta, duke e shpenzuar kapitalin pa masë në gjëra të kota, pas një kohe të shkurtër, pa dyshim, do të falimenton, dhe në

dorë nuk do t'i mbetet asgjë. Pa dyshim se ky person në këtë gjendje -kur ta kupton se nuk ka kthim prapa- do të pendohet thellë. Kurse tjetri nëse e shpenzon kapitalin e tij në ndihmë të varfërve, të ngratëve, për fitimin e zemrave, ndërtimin e ndonjë objekti që të tjerët të kenë dobi nga ai, a do të pendohet? Pa dyshim që jo, sepse sa më shumë që shpenzohet për All-llahun, All-llahu atij do t'ia shumëzojë shumëfish. Pra të gjitha këto mirësi që u janë dhënë njerëzve si: pasuri, kulturë, famë, respekt, bukuri dhe shumë mirësi tjera janë te njohura si raste për tu përgatitur për ahiret. Besimtari këto raste i vlerëson në mënyrë korrekte.

Kurse shembulli i jobesimtarit i përngjan personit që e shpenzon të hollat kot së koti. Jobesimtari jetën e tij të shkurtër e shpenzon pa e qarë kokën duke u dhënë pas bukurive, stolive të mrekullueshme të kësaj bote. Ata në botën e pastajme do të jenë në një humbje të madhe që nuk do të mund t'iu ndihmoj as të hollat, as shoku, as miku, as fëmija, as nëna, as babai apo ndokush tjetër, por do t'iu ndihmoj vetëm ajo që e kanë punuar. Kur'ani Famëllartë ka njoftuar për gjendjen e këtyre njerëzve kështu:

Thuj: "A t'ju tregojmë për më të dëshpëruarit në veprat e tyre?" Ata janë veprimi i të cilëve u asgjësua në jetën e kësaj bote, e megjithatë ata mendojnë se janë kah bëjnë mirë. Të tillët janë ata që nuk besuan argumentet e Zotit të tyre as takimin (ringjalljen) e Tij, andaj veprat e tyre shkuan huq dhe në ditën e gjykimit atyre nuk do t'u jepet kurrfarë vlere.. (Kehf, 18:103-105).

Ata që janë të vetëdijshëm se kjo botë është kalimtare do të kenë një fund të mrekullueshëm. Ngaqë e dinë se kjo botë është kaluese, nuk vrapojnë pas kënaqësive, stolive, të kësaj bote mashtruese. Për këtë arsye All-llahu xh sh është i kënaqur me ta dhe si shpërblim do t'ua jap atë që u ka premtuar në ajetin 111-të të sures Teube ku thotë:

All-llahu bleu prej besimtarëve shpirtrat dhe pasurinë e tyre me xhennet. ... E kush është më zbatues i sigurt i premtimit të vet se All-llahu? Pra, gëzoju tregtisë që bëtë me Të. Ky është suksemi i madh. (Teube,9:111)

All-llahu sprovon njeriun me kënaqësi dhe vështirësi

Siç e kemi cekur në fillimin e librit që njerëzit gjatë tërë jetës së tyre sprovohen në mënyra të ndryshme. Në Kur'an tregohet se njeriu sprovohet me vështirësi dhe me kënaqësi. All-llahu xh sh këtë të vërtetë në Kur'anin Famëlartë e tregon kështu :

Në, asnjë njeri para teje (Muhammed) nuk i dhamë jetë të përhershme, e nëse ti vdes a mos do të mbesin ata përgjithmonë? Çdo krijesë do ta shijojë vdekjen, e Ne në shenjë sprove iu sprovomë me vështirësi e kënaqësi, dhe ju ktheheni te Ne". (Enbija, 34-35)

Sipas këtyre ajeteve kuranore njeriu mund të sprovohet në mënyra të ndryshme. Për shembull, derisa është duke shijuar të mirat e pasurisë me bollëk, njeriu duhet të jetë i kujdesshëm që të sillet me atë moral me të cilin është i kënaqur All-llahu, të kthehet kah Ai në të gjitha qëllimet dhe veprat, t'i bindet urdhrave të Tij, dhe të pasojë këshillat e Tij. Nëse dikush preokupohet me kënaqësitë e përkohshme të kësaj bote, sidomos pasuria e bën që të jetë i pakujdesshëm ndaj realitetit. Por besimtari, pa marrë parasysh se çfarëdo e mirë ta ketë shijuar, çdoherë mbetet falënderues para All-llahut.

Përveç kësaj njeriu mund të sprovohet me sëmundje, fatkeqësi, kurthe, shpifje... etj. Jobsimtarit, kur t'i ndodh ndonjëra nga këto mërzhitet, shqetësohet, dhe brengoset, kurse besimtarit, kur t'i ndodhin këto, fort mirë e di se këto janë një pjesë e sprovave dhe

FSHEHTËSIA E SPROVËS

nuk harron se duhet të bëj durim që përfundimisht do të shpie në të mirë.

Siç thamë më parë, këta kanë bërë tregti të mirë duke ndërruar këtë botë me tjetrën. Në Kur'an thuhet: **“Dhe, dinë mirë se pasuria e juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë, dhe se te All-llahu është shpërblimi më i madh”**. (Enfal, 8:28), dhe ata e dinë se jeta dhe pasuria, dhe të gjithat i takojnë All-llahut, prandaj çdo humbje apo fitim nuk ia u ndërron karakterin moral, pikëpamjet, apo besimin në Zotin. Shumë ajete përshkruajnë këtë veti, në mes të cilave janë:

Por, i dërguari, e së bashku me të edhe ata që besuan, luftuan me pasurinë dhe veten e tyre dhe atyre u takuan të gjitha të mirat, ata janë të shpëtuarit. All-llahu u ka përgatitur atyre xhennete që në të rrjedhin lumenj, ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Ai është suksezi i madh. (Teube, 9:88-89)

Besimtarë janë vetëm ata që besuan All-llahut, të dërguarit të Tij, e mandej nuk dyshuan dhe për hir të All-llahut luftuan me pasurinë dhe me jetën e tyre. Të tillë janë ata të vërtetit. (Huxhuratë, 49:15)

Siç u pa në ajetet e me lartë përmendura, për myslimanin jeta e kësaj bote është vend ku bëhet përpjekje që të fitohet kënaqësia e All-llahut. Dijetari Islam Beduizzaman Said Nursi në thënien e tij e mëposhtme për jetën e kësaj bote ka thënë se është një vend i shërbimit dhe se njeriu do të sprovohet me sprova të vështira dhe kënaqësi, dhe se durimi përballe këtyre sprovave do ti sjell shpërblim te madh nga All-llahu.

Jeta e kësaj bote është një vend i sprovës dhe vendbanim i shërbimit, kurse nuk është vend i kënaqësive, shpërblimeve dhe shpagesave. Meqenëse qenka vendbanim i shërbimit dhe vend i adhurimit, sëmundjes dhe fatkeqësive- nëse këto nuk ndikojnë në

besim dhe bëhet durim- të jenë në pajtim me shërbimin dhe adhurimin, e bile këto veçse e forcojnë atë. Adhurimi përbëhet nga dy lloje, pozitiv dhe negativ. Çfarë mendohet si pozitiv është e qartë. E sa i përket adhurimit negativ, është kur dikush përballat me fatkeqësi apo sëmundje, kupton dobësinë dhe pafuqinë e vet, dhe i kthehet të Gjithëmëshirëshmit, kërkon strehim tek Ai, mendon në Të, i lutet Atij dhe në këtë mënyrë ofron formën e pastër të adhurimit dhe nuk mund të depërtojë hipokrizia. Nëse është i durueshëm, mendon për shpërblimin që do ta marr nëse bën durim gjatë fatkeqësisë dhe falënderon, çdo moment që ka kaluar do t'i llogaritet sikurse ka kaluar tërë ditën në adhurim. Jeta e shkurtër, bëhet e gjatë. Ekzistojnë raste kur edhe një minutë i vetëm llogaritet si të bëhet adhurim tërë ditën.⁶

Është me rëndësi që të vrasim mendjen me këto fjalë të mençura. Siç thamë edhe më herët se njeriu është përgjegjës që të jetë në shërbim të All-llahut dhe të jetë i nënshtruar dhe të jetë me All-llahun në të gjitha rrethanat. Njëra ndër mënyrat se si të mbetet me All-llahun është të jetë i durueshëm në të gjitha vështirësitë dhe frustrimet e kësaj bote. Bile, kohërat e vështira mund të ngjaj të vijnë kur më së paku priten dhe duket se zgjasin shumë. Për shembull, pasaniku mund të bëhet i varfër, njeriu i suksesshëm mund të përballat me ndonjë dështim, dikush mund të humbas të dashurin, të sëmuret apo të mbetet invalid. Por pa varësisht nga sprova All-llahu premtion të mira të amshueshme për shërbëtorët e Tij të durueshëm.

Për këtë arsye, njeriu duhet shfrytëzuar çdo çast të vetin në këtë botë. Para se të bëj apo të thotë diçka në këtë botë, njeriu duhet të pyes veten se çfarë është më e mira që të fitohet kënaqësia e All-llahut. Por çka është më e rëndësishmja, ai duhet që t'i shmanget rreziqeve të kësaj bote dhe të harroj jetën e pastajme, dhe se nuk

FSHEHTËSIA E SPROVËS

duhet ndërruar amshimin me ndonjë kënaqësi të përkohshme. Rruga se si të arrihen gjërat e mira të amshueshme është kthimi tek All-llahu:

Secili njeri do të shijojë vdekjen, e shpërblimet tuaja u plotësohen ditën e kiametit, e kush shmanget zjarrit e futet në xhennet, ai ka arritur shpëtim, e jeta e kësaj bote nuk është tjetër pos një përjetim mashtrues. Ju patjetër do të sprovoheni si në pasurinë tuaj, si në vetën tuaj, madje do të dëgjoni ofendime të shumta prej atyre që u është dhënë libri para jush, e edhe prej idhujtarëve, por në qoftë se duroni dhe ruheni, ajo është gjëja më vendimtare. (Ali-Imran, 3:185-186)

FSHEHTËSIA E SPROVËS

Allahu ka njoftuar besimtarët se do të kalojnë nëpër prova të ndryshme. Për shembull, do të sprovohen në jetën e tyre personale dhe me pasuri, të ballafaqohen me kurthet e vendosura nga pabesimtarët dhe do të akuzohen pafajshëm. Me fjalë të tjera, ata mund të hasin në vështirësi në çdo periudhë të jetës së tyre. Por gjëja më e rëndësishme është se ata duhet të vazhdojnë praktikumin e moralit kuranor në periudhat e vështira, duhet përkujtuar Allahun pandërprerë, të falënderojnë dhe të kuptojnë se çdo gjë do të përfundojë mirë.

Natyrisht, është lehtë që të bëhen këto gjëra kur dikush është duke shijuar të mirat e Tij e shumë më vështirë e ka dikush që është duke kaluar kohëra të vështira. Por njëra ndër gjërat kryesore është që të dëshmohet fuqia e besimit të myslimanit është kundërshtimi që të bëhet kompromis me karakterin e moralit të tij. Ata që me durim përballojnë varfërinë, urinë, frikën, humbjet personale dhe materiale, sëmundjet, kërcënimet nga jobesimtarët, shpifjet dhe kurdisja e kurtheve, do të marrin shpërblim edhe më të mirë për cilësinë e moralit të tyre.

FSHEHTËSIA E SPROVËS

Në Kur'an tregohen shumë shembuj në lidhje me torturat dhe kurdisjen e kurtheve nga shoqëritë jobesimtare kundër pejgamberëve dhe besimtarëve të devotshëm. Njëri nga këta shembuj është edhe torturimi që shtroi Faraoni mbi popullin e tij. Në Kur'an tregohet se kjo torturë e Faraonit që shtroi mbi popullin e tij ishte sprovë. All-llahu thotë:

Përkujtoni edhe kur u shpëtua prej popullit të faraonit, që nga ai shijuat dënimin më të hidhët, duke ua therur bijtë tuaj, e duke ua lënë gjallë gratë tuaja. Në këtë torturë përjetuat një sprovim të madh nga Zoti juaj. (Bekare, 2:49).

Siç u tregua në këtë ajet çdo torturë që shtrohet nga jobesimtarët për myslimanët është një sprovë. Dhe ata që besuan kur të tregojnë moral të lartë, trimëri dhe qëndrueshmëri përballe këtyre torturave në jetën e pastajme do t'iu rritet shkalla dhe shpërblimi. All-llahu i përshkruan sprovat që mund ti përjetojnë në jetën e kësaj ata që besuan kështu:

Ne do t'ju sprovojmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta e edhe nga frytet, po ti jepu myzhde durimtarëve. Të cilët, kur i godet ndonjë e pakëndshme thonë: "Ne jemi të All-llahut dhe ne vetëm tek Ai kthehemi!" Të tillët janë që te Zoti i tyre kanë bekime e mëshirë dhe të tillët janë ata të udhëzuarit në rrugën e drejtë. (Bekare, 2:155-157).

Besimi dhe nënshtrimi që bëhet fjalë në këto ajete është si një shembull i mirë për të gjithë myslimanët. Por jobesimtarët nuk mund të kuptojnë durimin e besimtarit, dhe mendojnë se besimtarët janë sikurse ata veçse sillen sipas një kriteri të gabuar.

Por ky është një gabim i madh i tyre, e për myslimanin që kupton të fshehtën e sprovës e di se gjëja më e mirë në rastet e tilla

është që të jetë durimtar. Për ata myslimanë që praktikojnë moralin kuranor dhe bëjnë çmos që këtë gjë të mbjellin në mendjen e të tjerëve, të gjitha problemet e tilla tregojnë se janë në rrugë të drejtë. Si rezultat, tek ata forcohet kënaqësia dhe përcaktimi në vazhdimësinë e pasimit të rrugës së drejtë.

Në Kur'an, All-llahu tregon për ligjet që kanë mbetur të pandryshuara gjatë historisë. Njëra ndër to është që besimtarët do të ndeshen me vështirësi dhe frustrime dhe do të jenë cak i dhunës së jobesimtarëve. Sido që të jetë, jobesimtarët kurrë nuk do t'i arrijnë qëllimet e tyre:

Ata gati të shqetësuar në tokë (në Mekë) për të përzënë prej saj, po atëherë edhe ata nuk do të mbeteshin pas teje (pas pak kohe do të shkatërroheshin). Ky është ligji i Tij edhe me të dërguarit që i dërgoi para teje. E në ligjin Tonë ti nuk gjen ndryshim. (Isra, 17:76-77)

Pra, kjo është njëra nga fshehtësitë e sprovës së kësaj bote. All-llahu ka paralajmëruar myslimanët për shumë gjëra që do të përballohen, dhe se do të hyjnë në xhenet vetëm nëse përballen me vështirësitë sikurse besimtarët para tyre:

Po ju menduat se do të hyni në Xhennet, pa u provuar edhe ju me shembullin e atyre që ishin para jush, të cilët i patën goditur skamjet e vuajtjet dhe qenë tronditur, sa që i dërguari thoshte, e me te edhe ata që kishin besuar: "Kur do të jetë ndihma e All-llahut?!" Ja (u erdhi ndihma) vërtetë ndihma e All-llahut është afër!" (Bekare, 2: 214).

Nënshtrimi ndaj kaderit (përcaktimit të All-llahut)

Fshehtësi tjetër e rëndësishme është edhe realiteti i kaderit. Gjithë myslimanët e dinë se All-llahu çdo gjë e ka krijuar sipas përcaktimit të Tij dhe çdo gjë ndodh sipas vullnetit të Tij. Kur'ani na

FSHEHTËSIA E SPROVËS

tregon se çdo gjë që ndodh në botë, pa përjashtim, ngjet me vullnetin e All-llahut:

Çfarëdo e keqe që ndodhë (godet) nuk mund të jetë ndryshe, vetëm sipas caktimit të All-llahut, e kush i beson All-llahut, Ai ia udhëzon zemrën e tij; All-llahu është i gjithëdijsëm për çdo send”.

Çelësat e fshehtësive janë vetëm te Ai, atë (fshehtësinë) nuk e di kush pos Tij. Ai e di çka ka në tokë dhe në det, Ai e di për çdo gjeth që bie dhe s’ka kokërr në thellësi të tokës, s’ka të njomë dhe s’ka të thatë që nuk është (shënuar) në librin e qartë (Levhi Mahfudh). (En’am, 6: 59).

Askush nuk e di të ardhmen, pasi njerëzit janë të kufizuar me kohë dhe mund t’i qasen ngjarjeve vetëm nga pikëpamja e momentit në të cilin jetojnë. Pasiqë nuk e dinë të ardhmen, ata mund të mos jenë të vetëdijsëm çdoherë mbi rëndësinë apo dobinë afatgjate të asaj që e përjetojnë. Por, All-llahu, Ai i Cili krijoi kohën, është i Vetëdijsëm dhe për këtë shkak Ai i sheh të gjitha nga “perspektiva jashtëkohore”. Ja ku erdhëm edhe deri tek realiteti i kaderit, e definuar si njohuri e All-llahut për të gjitha ngjarjet në të kaluarën dhe të ardhmen, si dhe rrjedhojën dhe përfundimin e tyre, në një moment. (Për debat më të detajuar, shih librin e Harun Jahjasë *“Timelessness and the Reality of Fate”*, botues New Delhi: Goodword Publisher, 2001).

Pra, All-llahu i di të gjitha sprovat e njerëzve, në të kaluarën dhe në të ardhmen, si dhe në të tashmen. Nga pikëpamja e Tij, çdo gjë ka përfunduar. Sido që të jetë, për këto ngjarje ne kuptojmë vetëm kur t’i përjetojmë në kohën e caktuar.

Jobesimtarët nuk mund ta kuptojnë “çështjen e kaderit”, dhe për këtë shkak as nuk janë të vetëdijsëm për këtë gjë. Është kjo çështje që bën që myslimanët të shfaqin durim në sprovat dhe

vështirësitë e tyre. E në Kur'an shkruan kështu: “Çfarëdo e keqe që ndodh (godet), nuk mund të jetë ndryshe, vetëm sipas caktimit të All-llahut, e kush i beson All-llahut, Ai ia udhëzon zemrën e tij; All-llahu është i gjithëdijshtëm për çdo send.” (Tegabun, 64:11), e për këtë arsye besimtarët jetojnë në rehati duke qenë në dijeni se çfarëdo që ndodhë është si pasojë e “kaderit”.

Si mëshirë nga Ai, All-llahu krijoi sprovë të ndryshme për besimtarët dhe i bën ata të durueshëm, duke mbetur besnik dhe duke i lënë të gjitha në dorën e Tij. Ata myslimanë që vërtetë besojnë dhe janë të nënshtruar me sinqeritetin më të madh All-llahut, dhe këtë e shohin në ndryshimet që ndodhin, dhe këtë lehtë e kuptojnë dhe janë falënderues. Ngjashëm me atë që është i ulur në rehati në ulësen e kinemasë duke shikuar filmin; përcjellin fatin dhe “kaderin” e përgatitur për ta. Ndonjëherë këto skena janë të mbushura me gjallëri apo frikë; ndonjëherë mund të jenë të këndshme dhe të qeta. Por, në përgjithësi, ka edhe kënaqësi edhe hidhërim. Skenat e frikshme janë të përgatitura dhe të planifikuara deri në detalin më të imtë. Por në fund, të gjitha janë të përfshira në dijeninë e All-llahut dhe janë nën kontrollin e Tij.

Ata myslimanë që kuptojnë realitetin e “kaderit” dhe kuptojnë fshehtësinë e sprovës shohin çdo fatkeqësi, uri apo skamje si një gjë e mirë, duke e ditur se morali i lartë që ata shfaqin duke përballuar këto sprovë janë shumë të vlefshme në praninë e All-llahut. Kjo lloj kënaqësie është unike tek besimtarët. Kur të përballen më kësi lloj vështirësish, myslimanët nuk kalojnë në melankoli, stres, dhimbje, panik apo frikë, pasi e dinë se All-llahu do t'i shpërblejë për të gjitha. Në Kur'an, All-llahu u thotë besimtarëve:

... All-llahu kurrsesi nuk iu mundëson jobesimtarëve mbizotërim të plotë mbi besimtarët. (Nisa, 4:141)

Por, duhet kuptuar një gjë këtu: çfarëdo që myslimanët

FSHEHTËSIA E SPROVËS

përjetojnë në këtë botë, vështirësi apo frustrim, humbje të pasurisë apo fuqie fizike, sëmundje apo lëndim, vdekje apo invaliditet, nuk i konsiderojnë si përjetime të “këqija”: por më mirë të themi, të gjitha këto janë vetëm sprovë e All-llahut. Nëse janë durimtarë gjatë këtyre sprovave dhe i tejkalojnë, All-llahu do t’i shpërblejë ata në këtë dhe në botën tjetër. Dhe në fund të kësaj kohe të shkurtër të sprovave, atyre do të shpërblehen me xhennet në jetën e përhershme.

Ata myslimanë që janë të vetëdijshëm për këtë të vërtetë kanë edhe më shumë shpresa për xhennet kur përballen me vështirësi. Kur jobesimtarët mendojnë se i kanë futur besimtarët në situatë të vështirë, çka tek besimtarët ndjell kënaqësi, jobesimtarët kuptojnë se nuk mund t’iu bëjnë asgjë atyre. Bile, fjalët e besimtarëve në kohët e vështira shprehin nënshtrimin e tyre ndaj All-llahut. Edhe Kur’ani i zbulon disa nga këto fjalë:

E përse të mos i mbështetemi All-llahut derisa Ai na udhëzoi në rrugën tonë (të drejtë). Për Zotin, ne gjithsesi do të durojmë e do të përballojmë mundimet që na bëni, e vetëm All-llahut le t’i mbështeten vazhdimisht ata që gjithnjë iu mbështeten. Ata që mohuan të dërguarit e vet thanë: “Për Zotin, ne do t’iu dëbojmë nga vendi ynë, ose ju domosdo do të ktheheni në fenë tonë!” E atyre (të dërguarve) Zoti u shpalli; Ne gjithqysh do t’i shkatërrojmë zullumqarët. Dhe pas tyre Ne do t’ju vendosim në atë tokë. E këtë (ndihmë) për atë që i frikësohet pranisë Sime dhe i frikësohet dënimit Tim. (Ibrahim, 14:12-14)

Thuaj: “Neve nuk na godet asgjë tjetër, përveç çka na është caktuar nga All-llahu; Ai është ndihmëtar yni”. Prandaj, vetëm All-llahut le t’i mbështeten besimtarët.”(Teube, 9:51)

Qëndrimi i tillë është si rrjedhojë e nënshtrimit të besimtarit ndaj kaderit të All-llahut, i cili e ka paracaktuar atë. Ata që besojnë dhe mbështeten në All-llahun kurrë nuk përjetojnë frikë apo brengosje, për të cilët Kur'ani thotë:

Ata që thanë: “All-llahu është Zoti ynë dhe qëndruan besnikërisht, për ta nuk ka frikë dhe ata nuk do të pikëllohen. (Ahkaf, 46:13)

Nuk është ashtu (si thonë ata), po ai që i është dorëzuar All-llahut dhe është bamirës, ai e ka shpërblimin e vet te Zoti i tij, për ata nuk ka frikë, as nuk kanë pse të mërziten. (Bekare, 2:112)
Ta keni të ditur se të dashurit e All-llahut (evliatë) nuk kanë frikë (në botën tjetër) e as kurrfarë brengosje? (Ata janë ata) Të cilët besuan dhe ishin të ruajtur. Atyre u jepen myzhde në jetën e dynjasë (në çastin e vdekjes) dhe në jetën tjetër (për shpëtim në xhennet). Premtimet e All-llahut nuk mund të pësojnë ndryshim. E, ai është sukcesi i madh. (Junus, 10:62-64)

Në ajetet tjera, All-llahu zbulon se ata shërbëtorë të Tij që i besojnë dhe i janë të nënshtruar janë kapur fort në lidhjen e sigurt:

E kush ia dorëzon veten All-llahut duke qenë edhe punëmirë, ai është kapur për lidhjen më të sigurt dhe vetëm tek All-llahu është përfundimi i çështjeve. (Lukman, 31:22)

Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush nuk i beson të pavërtetat, e i beson All-llahut, ai është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk ka këputje. All-llahu është dëgjues i dijshtëm.(Bekare, 2:256)

Të vështuarit e ngjarjeve nga perspektiva e së ardhmes

Kur besimtarët kuptojnë se ata në këtë jetë janë duke u testuar, ata mund të shohin ngjarjet nga një pikëvështrim të së ardhmes. Çfarë do të thotë kjo?

Pa marrë parasysh se sa e madhe është vështirësia apo frustrimi, situata është e përkohshme. Për shembull, dikush mund të akuzohet i pafajshëm dhe të gjykohet padrejtë. Por e vërteta gjithmonë në fund del në shesh. Edhe nëse padrejtësia nuk përfundon në këtë botë, ata që kanë shkaktuar të padrejtën do të dënohen për atë në Ditën e Gjykimit. Në të njëjtën mënyrë, atij që i është shkaktuar e padrejta, shpreson në atë Ditë, kur do t'i shpërblehet durimi. Koha kalon shpejt, dhe si çdo ngjarje e kësaj bote, çdo vështirësi do të kalojë sa qel e mbyll sytë. Bile, Kur'ani thotë se All-llahu ka premtuar se pas çdo sprove myslimanit do t'i dërgoj lehtësim:

E, pa dyshim se pas vështirësisë është lehtësimi. Vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi. (Inshirah, 94:5-6)

Pra, besimtari beson në drejtësinë e amshueshme të Tij, pret për lehtësim, dhe kurrë nuk e humb shpresën. Përkujton se e mira vjen pas të keqes, ja në këtë ja në botën tjetër. Kjo është domethënia e shikimit nga një pikëvështrim i së kaluarës.

Myslmanët e dinë se ata janë vëzhgues të fatit të tyre dhe të tjerëve. Duke e ditur këtë, ata çdo gjë e marrin me durim, kujdes, dhe bindje. Përveç kësaj, e dinë se nuk mund ndërhyjnë, parandalojnë apo ta ndalojnë se si do të rrjedh një ngjarje. Ata i mbajnë mirë në mend fjalët: **“Por mund që ju ta urreni një send, e ai është shumë i dobishëm për ju, dhe mund që ju ta doni një send, e ai është dëm për ju. All-llahu di (fundin e çdo sendi) e ju nuk dini.”** (Bekare, 2:216). Me fjalë të tjera, edhe nëse iu ndodh

diçka e papëlqyer besimtarëve, ata prapëseprapë do të kenë dobi prej saj, pasi që duke mbetur me bindje ndaj Alla-llahut dhe me durim, ata stërvitin dhe thellojnë besimin e tyre, përmirësojnë karakterin e tyre moral, i kthehen më shumë gjendjes shpirtërore, pjekën më shumë dhe iu ngritët statusi në xhennet.

Vetëm besimtarët e sinqertë që i janë nënshtruar me devotshmëri të plotë All-llahut mund të përjetojnë këtë gjendje. Por njerëzit që nuk i nënshtrohen fatit (kaderit) dhe mohojnë fenë do të bëhen të pashpresë, të frikësuar, dhe të shqetësuar, duke menduar se kurrë nuk do të gjejnë dalje nga situata. Duke mos pasur shpresë në jetën e pastajme, jetojnë në brengë të vazhdueshme shpirtërore dhe në frustrim. Ajeti në vazhdim shpjegon këtë gjendje shpirtërore:

Atë që All-llahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për (të pranuar) islamit. Atë që dëshiron ta lërë të humbur, zemrën e tij ia bën shumë të ngushtë sikur të ngjitej në qiell. Kështu All-llahu lëshon dënimin mbi ata që nuk besojnë. (En'am, 6:125)

Gjendja shpirtërore në frustrim shkaktohen për shkak të mohimit të kaderit që All-llahu e ka krijuar për ta. Është një gjendje e rëndë që ata ia kanë krijuar vetes. Fakti se All-llahu, me fuqinë dhe mençurinë e Tij të pafund, drejton fatin e çdo njeriu dhe qeveris me të gjitha gjërat është një bekim i madh për besimtarët. Por ata që kanë pak ose aspak besim nuk e dinë vlerën e këtij bekimi dhe në këtë mënyrë nuk mund t'i nënshtrohen fatit të tyre. Si rezultat, përfundojnë në kurthin e vet krijuar të frustrimit deri sa të vdesin. Në të vërtetë, kjo gjendje është dënim shpirtëror i kësaj bote si shpallim për mungesën e besimit në All-llahun. Bile, këtë gjë e bëjnë me qëllim:

All-llahu nuk u bën asgjë të padrejtë njerëzve, por ata i bëjnë të padrejtë vetes së tyre. (Junus, 10:44)

MYSLIMANI NË MOMENTETE VËSHTIRA

Cilësia e besimit të myslimanit dhe karakterit moral shfaqet në kohëra të vështira. Nën rrethanat e tilla, shohim moralin, trimërinë, durimin, besimin, kuptimin, guximin, tolerancën e tyre superiore si dhe vullnetin e tyre për të falur, vetëflijimin, mëshirën, humanitetin, vlefshmërinë, ndërgjegjen dhe vetëpërbajtjen.

“Myslimani në çastet e vështira” është personi që ka durim në çdo vështirësi, frustrim dhe humbje duke i shfaqur cilësitë e lart përmendura. Njerëzit e tillë kurrë nuk rrezikojnë moralin e tyre, ndeshen me çdo situatë me pjekuri të plotë dhe besim në All-llahun, shohin arsyen në çdo gjë që ndodh dhe të mirën në të, dhe nxisin të tjerët që të praktikojnë moral të njëjtë. Siç shkruan në Kur’an: “... **kur ata u erdhën juve edhe prej së larti edhe prej së poshti, dhe kur shikimet u shtangën, e zemrat arritën në fyt...**” (Ahzab, 33:10), këto janë kohëra të vështira kur besimtarët i nënshtrohen sprovës serioze dhe janë të kapluar nga frustrimi.

Kur flasim për çastet e vështira, njerëzve që nuk e njohin All-llahun u vijnë shembuj të ndryshëm: fatkeqësi natyrore, humbja e

vendit të punës, bankrotimi dhe ngjarje të ngjashme. Por për ata që kanë besim, momentet e vështira janë në situata më serioze si: kur dikush është i privuar nga kushtet elementare të tij/saj, dhe kur frustrimet janë më serioze sesa ato të përditshmet. Kur'ani definon kohërat e tilla kur “zemrat arritën në fyt” si kohëra kur ndonjë vështirësi, sëmundje dhe fatkeqësi bie në shumë njerëz, si kur dëbohen nga shtëpia, dëbohen nga vendi, përballimi me kurthe të vendosura vetëm për ta, si dhe njerëzve dhe familjeve të tyre, atëherë janë subjekt i brengës shpirtërore.

Kur'ani jep shembuj të vështirësive të përjetuara nga profetët dhe besimtarët e devotshëm. Siç thamë edhe më herët, besimtarët e devotshëm kanë kaluar dhe kanë qëndruar shumë sprovave serioze, si:

Po ju menduat se do të hyni në Xhennet, pa u provuar edhe ju me shembullin e atyre që ishin para jush, të cilët i patën goditur skamjet e vuajtjet dhe qenë tronditur, sa që i dërguari thoshte, e me te edhe ata që kishin besuar: “Kur do të jetë ndihma e All-llahut?!” Ja (u erdhi ndihma) vërtetë ndihma e All-llahut është afër! (Bekare, 2:214)

Në këtë ajet, All-llahu thotë se të gjithë njerëzit do të kalojnë nëpër vështirësi dhe jep lajme të mira se durimtarët do të kenë të mira në jetën e amshueshme. Në këtë kohëra, dallimi mes “myslimanëve në çastet e fatkeqësisë” dhe “myslimanit në çaste të lumtura” do të jetë i qartë. Ata të grupit të parë do të përgjigjen vështirësive dhe frustrimeve kështu:

Të cilët, kur i godet ndonjë e pakëndshme thonë: “Ne jemi të All-llahut dhe ne vetëm tek Ai kthehemi!” (Bekare, 2:156)

Zëri i ndërgjegjes dhe epshit në momentet e vështira

Njeriu dëgjon dy zëra në brendinë e tij kur të përballohet me një vështirësi ose frustrim. Njëri nga këta është zëri i ndërgjegjes që nxitë vetëflijimin, trimërinë dhe moralin e lartë. Ai që e dëgjon këtë zë çdoherë do të vendos që të jetë i durueshëm dhe të ketë besim në All-llahun. Kurse zëri i dytë është zëri i epshit i përshkruar në surën Jusuf, ajeti 53 **“epshi është shumë nxitës për të keqen”**. Ky zë vazhdimisht nxit rebelim, imoralitetin, egoizmin dhe frikën, bën që ata që e dëgjojnë të jenë në humbje të madhe dhe të tërhiqen në “shoqërinë” e shejtanit. Për të shpjeguar njerëzve se çfarë humbin me rastin e kësaj ujdje, është e nevojshme që të dihet se si shejtani ndikon në ta. Kur’ani në detaje shpjegon dhe paralajmëron njerëzit që të kenë kujdes nga kurthet e tij.

Kur All-llahu krijoi Ademin a.s, urdhëroi melaqet dhe shejtanin t’i përulën Ademit (a.s.). Melaqet u përulën para Ademit, kurse shejtani për shkak të mendjemadhësisë dhe krenarisë së tij e refuzoi të përulet para Ademit a.s. dhe shejtani u dëbua nga xhenneti për shkak të kësaj mosbindjeje. Pastaj shejtani pyeti All-llahun që t’i lejoj që të ketë ndikim në njerëz deri në Ditën e Gjykimit. All-llahu i lejoi, por i tha se nuk do të kesh ndikim në shërbëtorët e Tij të sinqertë. Shejtani është betuar para All-llahut se brenda kësaj kohe që iu mundësua, do të mundohet t’i mashtrojë njerëzit me premtime, dinakëri dhe kurthe të llojlojshme dhe t’i largoj nga rruga e drejtë. Ky betim i shejtanit në Kur’an është treguar kështu:

(Iblisi) Tha: “Për shkak se më humbe mua, unë do t’u ulem atyre (do t’u zë pusi) në rrugën Tënde të drejtë, Mandej, do t’ju sillem atyre para, prapa, nga e djathta dhe nga e majta e tyre, e

shumicën e tyre nuk do ta gjesh që të falënderohen (të besojnë)!” (All-llahu) Tha: “Dil nga ai (Xhenneti), i urrejtur, i dëbuar. Kush prej tyre vjen pas teje, Unë kam për ta mbushur Xhehennemin me të gjithë ju. (A’raf, 7:16-18)

Mandej vazhdoi e tha: “A e sheh (i tha Zotit) këtë që Ti e vlerësove mbi mua, nëse më lë të jetojë deri në ditën e kiametit, unë gjithsesi do t’i shfaros pasardhësit e tij, më përjashtim të një pakice”. (Zoti) Tha: “Shko, e kush prej tyre vjen pas teje, shpërblimi juaj është xhehennemi, shpërblim i plotë”. Dhe me atë alarmin e zërit tënd, mashtroje atë që mundesh prej tyre, me kalorësit e këmbësorët tu thirri (bërtitu) ata, përzieju me ta në pasuri dhe në fëmijë dhe premtu atyre, po shejtani nuk u premtonte tjetër, përveç mashtrim. (Isra, 17:62-64)

Siç thuhet në këto ajete, shejtani do të përpiqet me çdo gjë për t’i larguar njerëzit nga rruga e drejtë do t’i parandalojë nga falënderimi ndaj All-llahut dhe nga jeta e moralshme. Si pasojë, do t’i sjell shumicën e njerëzve në anën e tij duke shfrytëzuar zërin e epshit. Për këtë shkak, kur njerëzit kalojnë momente të vështira, shejtani çdoherë do të përpiqet që t’i bëjë ata egoistë dhe si të sigurohen duke u prezantuar si vetë-flijues, i dhembshëm dhe i mëshirshëm, si zgjedhje negative:

O ju njerëz, hani nga ajo që është në tokë e që është e lejuar dhe e mirë, e mos shkoni hapave të djallit se ai është armik i hapët i juaji. Ai iu urdhëron vetëm për të këqija e turpëri, dhe iu shtyn të thoni për All-llahun atë që nuk e dini. (Bekare, 2:168-169).

Për shkak të të gjitha këtyre arsyeve, myslimani që përballohet me një vështirësi, dëshpërim, ose fatkeqësi, duhet të veproj sipas ndërgjegjes dhe mos t’i bashkohet shejtanit. Me pasimin e shejtanit, egoizmi, oportunizmi, dhënia pas kënaqësive, dyfytirësia dhe

FSHEHTËSIA E SPROVËS

shumë cilësi tjera negative mund të ndjellën dhe të dëmtohet morali. Myslimanët e sinqertë dëgjojnë ndërgjegjen e tyre dhe çdoherë pasojnë të mirën. Siç thuhet në Kur'an, është e rëndësishme se morali i mirë kur " çështja të jetë vendosur":

... E kur çështja të jetë vendosur do të ishte më mirë për ata të jenë besnikë ndaj Allahut" (Muhammed, 44:21)

Shumica e njerëzve dinë se besnikëria e treguar gjatë sprovave tregon moral superior. Dhe betohen se do të jenë besnikë dhe të fortë në kohërat e vështira. Por kur sprova arrin, sjellja e tyre nuk i përngjan premtimeve të mëhershme dhe veprojnë negativisht kur preken edhe nga frustrimi i vogël. Ata hidhërohen papritmas dhe në vend që të jenë të dashur dhe të dhembshëm, shfaqin kundërpadi me hidhërim. Në një çast, bëhen të dyshimtë, rebelë dhe shtrojnë kërkesa. Në shembullin e tillë, i forti ndahet nga i dobëti dhe morali i prishur do të shfaqet vetvetiu; ata që kanë besim të dobët do të zbulojnë veten duke u bërë të ngatërruar dhe tregohen se janë në siklet. Këta janë vetëm një hap larg jobesimtarëve dhe veprave anti-muslimane. Rastet e tilla rrisin disa herë vlerën e myslimanit, besimi i të cilit është i fortë dhe i sinqertë.

Të gjitha vështirësitë dhe frustrimet që ndeshemi gjatë jetës së përditshme janë sprovë dhe mjete lumturie që mund të krahasohen me xhenetin që myslimanët shpresojnë ta arrijnë në jetën e pastajme. Është kënaqësi të krahasohen vështirësitë me këtë rehati dhe liri. Dhe, për myslimanët e sinqertë, çdo vështirësi sjell shtim të dashurisë, respektit dhe ngritje të vlerës nga myslimanët tjerë, dhe është bekim që thëllon besimin e tyre. Është bekim hyjnor me dobi dhe të mira të shumta, që bën që besimtarët të marrin shembull në atë person. Bile, kjo ka ndikim pozitiv në besimin e atyre përreth (nga mirësia e All-llahut) dhe i bën ata të mahnitshëm para jobesimtarëve, nëse këtë jobesimtarët e pranojnë apo jo.

Dikush mendon se ngjarja e veçantë është jashtë planifikimit të kaderit, është nën ndikimin e fortë të shejtanit, që shpesh sjell dyshim. Shejtani kënaqet duke shikuar njerëzit se si bijnë në kësi situata. Ndonjëherë, nën ndikimin e tij, njerëzit sëmuren duke e marrë si të parëndësishme çështjen duke qenë jashtë sferës së kaderit apo prapa mëshirës, diturisë dhe qëllimit të All-llahut. Besimtarët duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë gjë dhe të largohen kjo sëmundje, si dhe ta shërojnë, nëse lëshohen në të.

Për shembull, në çdo ngjarje ka dobi si në çështjet e vogla si harrimi apo mos-shikimi i ndonjë emisioni televiziv apo harresa për të porositur diçka për të ngrënë. Për shembull, nëse nuk shikohet një emision televiziv epet mundësia të ketë më shumë kohë për të bërë vepra të mira, të meditohet mirë, apo të arrihet të ndonjë ide që do ta shtonte mundësinë për të shërbyer All-llahun më shumë. Apo, mund ta përkujtojnë All-llahun dhe të kuptojnë më shumë sesa shikimi i një programi televiziv. Harresa për të porositur diçka për të ngrënë mund të konsiderohet si dietë që mund ta shëroj ndonjë sëmundje. Ata që kanë shtypjen e lartë të gjakut mund të iu kthehet gjaku në normale nëse harrojnë të hanë djathë çdo ditë. Duke e vendosur veten në dorë të All-llahut, mund të fitojnë vlerë në praninë e All-llahut dhe fiton miratimin e Tij duke u përpjekur për punë të mira. Përveç kësaj, besimi i përhershëm në All-llahun është gjithashtu mjet i besimtarëve që të fitojnë dashurinë dhe kënaqësinë.

Mund të mblidhen edhe shumë shembuj tjerë nga jeta e përditshme, por pa marrë parasysh është e rëndësishme që të kuptohet kjo çështje dhe mos ta harrojmë. Pa marrë parasysh se me çfarë ndeshen njerëzit në jetën e tyre, e rëndësishme apo jo, janë të përfshira në kader. Shejtani këshillon që këto ngjarje janë komponentë të domosdoshme të jetës së përgjithshme dhe nuk kanë të bëjnë fare me kaderin. Sido që të jetë, besimtarët çdoherë duhet të

jenë vigjilent dhe të vetëdijsëm për të gjitha këto këshilla, të jenë të aftë që të kuptojnë këtë dhe të mbajnë në mend, të shohin arsyen dhe dobinë në çdo gjë dhe çdo ndodhi, dhe të kuptojnë se çdo gjë ndodh në bazë të planit të përgatitur mirë nga All-llahu dhe se është bekim si në këtë ashtu edhe në botën tjetër. Kjo është një e vërtetë që jep urtësi, dëshirë, rehati dhe kënaqësi për të gjithë besimtarët.

Veçimi i të mirës nga e keqja

All-llahu ka krijuar të mirën dhe të keqën, atë që ndihmon dhe atë që dëmton, të bukurën dhe të shëmtuarën dhe i ka bërë prova gjatë rrugës për në xhenet apo xhehenem. Koha e sprovës në këtë botë qartë veçon të mirën nga e keqja, të durueshmit dhe ata që frikohen të ballafaqohen me vështirësi, ata që kundërshtojnë mënyrat jofetare të mendimit dhe ata që vetëm rrinë dhe nuk bëjnë asgjë, ata që pasojnë epshin si dhe ata që dëgjojnë zërin e ndërgjegjes.

Ekziston një arsye e fortë pse e mira dhe e keqja janë të lidhura aq shumë mes veti. Një arsye është se vlera e së mirës dhe e keqes mund të kuptohen brenda kësaj kundërthënie. Nëse e keqja, privimi, apo fatkeqësia nuk do të ekzistonin atëherë njerëzit nuk do të mundnin ta kuptojnë rëndësinë e së mirës. Për shembull, kur ta vendosësh diamantin në mesin e gurëve të zakonshëm, bukuria dhe atraktiviteti i diamantit bëhet më i qartë.

Arsye tjetër është kërkimi i fshehtësisë së sprovave të kësaj bote të përkohshme. Këtu, njerëzit sprovohen me të mira dhe të këqija. Gjatë sprovës, dallimi në shkallë mes dyjave do të jetë evident, dhe e mira do të veçohet në njërën anë, ndërsa e keqja në tjetrën. Kur engjëlli i vdekjes do të marr shpirtrat e njerëzve të këqij me ashpërsi, njerëzit e mirë do të ftohen që të hyjnë në xhenet. Kur'ani thotë se këto prova janë për të dalluar besimtarët:

Ajo që iu goditi juve ditën e ballafaqimit të dy grupeve (besimtarë dhe idhujtarë), ishte me lejen e All-llahut, për t'u dalluar besimtarët e sinqertë. Dhe, për t'u ditur ata që ishin hipokritë. E atyre u është thënë: "Ejani e luftoni në rrugën e All-llahut ose mbroni vetën!" E ata thanë: "Sikur të dinim se do të luftohej, ne do të vinim pas jush!" Në atë moment ata ishin më afër mosbesimit se besimit. Flisnin me gojë të tyre atë që nuk e kishin në zemrat e tyre, po All-llahu e di mirë për atë që fshehin. (Ali Imran, 3:166-67)

Siç thotë edhe ajeti, sjellja e treguar nga bashkë-kohanikët e të dërguarit savs ishte mënyra se si dalloheshin besimtarët e devotshëm nga hipokritët.

Beduizamani diskuton në thellësi se si vështirësitë dhe fatkeqësitë veçojnë të mirën nga e keqja, dhe jep një këshillë të mençur lidhje me këtë çështje. Kur është pyetur se cili është qëllimi i shejtanit dhe të ligës, ai nxori përfundim disa arsyeje shumë të rëndësishme që qëndrojnë pas çdo frustrimi, humbje, dhe ligësi. Më e rëndësishmja prej këtyre është **veçimi mes dispozitës së "thëngjillit" dhe "diamantit"**.

Ai përdor këtë shembull për të treguar se çdo lloj vështirësie dhe frustrimi zbulon personin. Sprovat në këtë botë zbulojnë vetitë e këqija të çdo njeriu dhe kështu jep mundësi që të përmirësohen. Për shembull, sëmundja serioze mund të zbulojë druajtjen apo pafuqinë shpirtërore të njeriut. Prandaj, kur femra kupton për pafuqinë e vet, menjëherë e përmirëson. Prandaj, sëmundja ia mundëson asaj që t'i vërej gabimet e saj dhe t'i ndreq për një kohë të shkurtër. Pas fatkeqësie, do t'i hiqet një njollë dhe morali i saj do të përmirësohet. Të marrim shembull njeriun që ka reputacion si njeri i ndershëm por bankroton dhe fillon që të fitoj para ilegalisht. Kjo tregon se si fati i keq und të zbuloj vetitë e këqija të dikujt. Por nëse nuk bën mëkat

FSHEHTËSIA E SPROVËS

dhe nuk rrezikon nderin e tij pa marrë parasysh nevojën e tij për para, atëherë humbja tregon sinçeritetin dhe devotshmërinë e tij të vërtetë.

Në Letrat e tij, Beduizzamani jep shembuj të mençurisë duke treguar durim në situatat që më vonë mund të ketë dobi prej tyre. Ai shkruan: Pra, krijimi i së ligës, lëndimit, sprovës dhe vuajtjes nuk është diçka e keqe apo e shëmtuar; këto gjëra janë krijuar me një qëllim të rëndësishëm... në botën njerëzore ngritjet dhe rëniet janë të vazhdueshme. Është një distancë e madhe mes nemrudëve dhe faraonëve nga njëra anë dhe të shenjtëve dhe profetëve në anën tjetër. **Prandaj, për të dalluar mes shpitrave “diamant” dhe “thëngjill”, krijimi i shejtanit ka hapur një arenë lufte, gare dhe sprove për të cilat janë dërguar profetët dhe në të cilën është zbuluar fshehtësia e përgjegjësisë. Nëse nuk do të kishte luftë dhe garë, vetitë në thëngjill dhe diamant do të mbeteshin të padallueshme në xehen e njeriut.** Shpirti i lartësuar i Ebu Bekër Es-Siddik dhe shpirti i ultë i Ebu Xhehlit do të mbeteshin në nivelin e njëjtë. Kjo dmth. se krijimi i të ligës nuk është e keqe dhe e shëmtuar pasi që shpie në rezultate të rëndësishme.⁷

Çështje tjetër që theksohet është vlera e sprovave të kësaj bote. Nëse nuk do të kishte ligësi dhe frustrime, vetitë e mira në karakterin e njeriut nuk do të mund të dalloj, morali i lartë i të devotshmëve nuk do të shfaqej, dhe nuk do të kishte përparim në shkallën shpirtërore të njeriut. Ja pse çdo rastisje që duket të jetë negative në fakt hap një horizont të pakufisë të mundësisë që të pjekët morali i dikujt, të forcohet dhe thellohet, dhe të ngritet dhe fitohet një pozitë në xhenet.

Më tutje Beduizzamani shkruan:

Feja është një provim, një test, propozuar nga All-llahu ashtu që në arenën e garave shpitrat e ngritur të dallohen nga shpitrat e ultë. Ashtu siç zhyten në zjarr materialet si diamanti dhe thëngjilli, ari dhe dheu, veçohen

njëri nga tjetri, ashtu edhe feja është sprovë sa i përket obligimeve të vëna njeriut nga All-llahu dhe rrjedha e garës, se kush ku e ka vendin. Në këtë mënyrë margaritarët e lartësuar në minierën e vetive të njeriut do të veçohen nga mbeturinat... Kur'ani është shpallur në këtë vend të sprovës për njeriun që të jetë përsosur gjatë garës në arenë.⁸

Sipas këtij krahasimi, vetitë “diamante” duhet ë veçohen nga ato të “thëngjillit”. Por, pasi që kjo mund të bëhet vetëm me përdorimin e zjarrit, njerëzit duhet kaluar periudhën e sprovave përfshirë vështirësitë, fatkeqësitë dhe frustrime të ndryshme që të largohen vetitë e tyre të këqija ashtu që vetitë e tyre të mira të shndrisin edhe gjatë ditës.

Beduizzamani jep edhe një shembull: veçimi i argjendit dhe bakrit nga xehja kur goditet përkundër gurit të provës. Dy materialet e dobishme veçohen nga njëra tjetra duke goditur xehen për atë gur, dhe largohet xehja e padobishme e bakrit. Në këtë proces së seperacionit (veçimit), xehja duhet që të goditet me fuqi për gur, e pastaj të kalojë nëpër pesë sita. Ky proces ndan argjendin në xehe dhe e pastron nga xehja e bakrit, me çka e zvogëlon vlerën e tij. Se çfarë do të thotë “goditja për gur” për njeriun është kalimi nëpër vështirësi, fatkeqësi dhe frustrime të ndryshme, e që do të bëjë që të del në shesh të bukuria e brendshme të njeriut. Ashpërsia e vështirësive dhe frustrimeve zbulon fuqinë e besimit të njeriut, si dhe superioritetin e karakterit, mendje mprehtësisë dhe besnikërisë së njeriut. Bile, kjo sprovë lë pas një pjekuri të karakterit shpirtëror dhe të besimit. Pra, ky proces pastron karakterin e lartë të besimtarit nga të gjitha vetitë që e dobësojnë, derisa del në shesh sikurse argjendi. Beduizzamani shkruan:

Pastaj në mëngjes mu kujtua kjo: nëse do të aplikohej procedura e njëjtë, dmth. të goditemi nga guri për sa e sa herë që të shikojmë se a jemi ar apo

FSHEHTËSIA E SPROVËS

*bakër, dhe të jemi të sprovuar jo-drejtësisht në çdo aspekt, dhe të kalonim nëpër pesë sita të ima tri-katër herë që të shihet se shpirtrat tanë keq-komandues mos janë duke bërë hile, është e nevojshme për shërbimin tonë, që duhet të jetë i pastër dhe vetëm në emër të së vërtetës dhe realiteti, ashtu që Përcaktimi hyjnor dhe mirësia e Zotit mund ta lejoj. Duke qenë i ekspozuar në sferën e sprovës dhe testit konfrontuar nga kokëfortët, armiqtë e padrejtë dhe pretekstet e tyre, çdokush kupton se **nuk ka hile, egotizëm (kult i vetvetes), shpirtligësi, as interesa personale e as të kësaj bote, e as ata që kërkojnë botën e pastajme, që janë plotësisht të sinqertë dhe rrjedh nga e vërteta dhe realiteti.** Nëse ka mbetur fshehur, mund t'i jepen domethënie të ndryshme. Masa e besimtarëve nuk do të kishte besim në të. Mund të thonin: "Ndoshta janë duke na mashtruar", e gjithashtu edhe elita mund të dyshonin. Duke menduar se "veprojnë sikur ata që e shesin veten për të fituar shkallë shpirtërore për vete dhe të fitohet mirëbesimi," dhe nuk do të jenë plotësisht të sigurt. Tani, me zbatimin e sprovës, edhe ata më kokëfortit dhe më zemërgurët detyrohen të dorëzohen. Nëse vështirësia është njëfish, shpërblimi do të jetë njëmijëfish. Vullneti i All-llahut.⁹*

Në këta shembuj, Beduizzamani tërheq vëmendjen tek shkaqet tjera të frustrimit dhe fatkeqësisë. Tjerët do të shohin dhe do të frymëzohen nga morali i lartë i atyre që i flakin vetitë e tyre të këqija duke kaluar nëpër sprova të ashpra. Besimi tek myslimanët, veprat e tyre të larta dhe i virtytshëm nga ana e drejtë, do të shfaqet derisa të kalojnë nëpër sprova serioze, dhe njerëzit do të shohin se nuk presin ndonjë shpërblim nga njerëzit për shërbimet e bëra. Edhe ata që kanë dyshime të mëdha për myslimanët do të pranojnë se çdo përpjekje që e bëjnë myslimanët janë vetëm për të fituar kënaqësinë e All-llahut, dhe çdokush do të dëshmojë për dëlirësinë e qëllimeve të tyre. Tjerët do t'i njohin myslimanët nga vështirësitë dhe fatkeqësitë që përjetojnë, çka konfirmon se ata janë duke shkuar rrugës së drejtë.

Shfaqja e vetive të larta morale në kohën e vështirësive dhe frustrimeve

Çdokush përjeton gjëra të ndryshme gjatë ditës: lodhje, uri, ligështim, etj. Kjo është krejtësisht e natyrshme. Sido që të jetë, All-llahu thotë se myslimanët mund të zgjedhen që të përjetojnë sprova edhe më të rënda se këto. Morali i shfaqur nga besimtarët dhe jobesimtarët në këto situata janë mjaft dalluese.

Për shembull, frustrimi i tillë shpie jobesimtarët në rebelim, bëhen agresiv dhe humbin shpresën dhe ndershmërinë. Pasi që ata nuk besojnë në jetën e pastajme, mendojnë se çfarëdo që bëjnë është lidhur vetëm me këtë botë:

“Ata edhe thanë: “Nuk ka tjetër, vetëm se kjo jetë jona në këtë botë, po vdesim dhe po lindemi dhe asgjë nuk na shkatërron tjetër pos kohës. Ata për këtë nuk dinë asgjë, ata vetëm fantazojnë” (Xhathije, 45:24)

Sipas tyre, çdo gjë do të përfundojë kur të fundoset bota. Prandaj, ata dëshirojnë që të jetojnë në rehati, qetësi shpirtërore, shpërblim për punën e tyre të bërë, dhe të gjitha gjërat e mira të kësaj bote. Kjo dëshirë i bën vështirësitë dhe frustrimin shumë të dhembshëm për ta. Ata as nuk janë të durueshëm e as të ndershëm, nuk mund të falin dhe nuk i trajtojnë tjerët me njerëzi, apo të kenë ndjenjën e dhembshurisë apo mëshirës. Duke besuar se nuk ka shpërblim apo dobi nga gjërat e tilla; i nënshtrohen gjendjes së pashpresë duke menduar se vështirësitë sjellin vetëm humbje.

Por mendimet e tilla janë krejtësisht të gabuara, pasi që jeta e vërtetë dhe e amshueshme fillon pas vdekjes. Në Ditën e Gjykimit, çdokujt do t'i llogaritet ajo që e ka punuar dhe do të shpërblehet me drejtësi për të. Ata që kanë shfaqur moral të lartë nuk do të humbasin; përkundrazi, do të fitojnë shumë. Në fakt, ata do të shpërblehen për secilin fjalë të mirë që e kanë thënë, çdo vepër të

sinqertë që e kanë bërë, dhe çdo shembull vetë-flijimi, besnikërie dhe njerëzie. Në të vërtetë, besimtarët mbajnë mend një hadithi të të dërguarit-savs: “Sjellja e keqe shkatërron shërbimin hyjnor, sikurse biberi mjaltin”¹⁰ dhe me pedanteri i largohen sjelljes së pahijshme.

Por njerëzit që janë shumë larg nga feja nuk janë të vetëdijshëm për këtë të vërtetë. Ata tremben kur përballen me situata të vështira, sepse mohojnë se çdo gjë që përjetojnë është test. Ja një pikë që duhet të trajtohet me kujdes: **“Mos u tregoni të dobët në ndjekjen e armikut, pse nëse ndieni dhembje edhe ata ndjejnë dhembje sikurse ju, e ju shpresoni nga All-llahu çka ata nuk shpresojnë. All-llahu është i Dijshëm, Ligjdhënës i Matur.”** (Nisa, 4:104). Ashtu siç thotë ajeti, si besimtarët ashtu edhe jobesimtarët janë të nënshtruar vështirësive dhe frustrimeve. Por, për shkak se jobesimtarët nuk kanë besim në All-llahun dhe nuk e konsiderojnë se çdo ngjarje është krijuar nga All-llahu, dhe nuk shpresojnë të shpërblehen nga All-llahu ashtu siç presin besimtarët. Pra, dallimi themelor është se ata janë të pavëmendshëm për domethënien e vërtetë të jetës. Me fjalë tjera, besimi i besimtarëve në All-llahun krejtësisht i veçon nga jobesimtarët në jetën e pastajme.

Për shembull, All-llahu na thotë se njerëzit do të sprovohen me uri dhe skamje. Derisa uria është vështirësi serioze dhe frustrim për jobesimtarët, për myslimanët është provë që ata duhet të tregojnë veti të larta morale dhe rast i mirë që nuk duhet humbur. Në kohëra të tilla, nënshtrimi ndaj All-llahut, besimi dhe durimi janë të një rëndësie të madhe, dhe fakti që nuk e humbin shpresën por përkundrazi shohin dobi për atë që u ndodh janë tregues të qartë se janë duke e kaluar testin.

Jobesimtarët vendosin leverdinë dhe rehatinë e tyre në vend të parë; sido qoftë, morali i besimtarit çdo herë jep përparësi tjetrit. Besimtarët me gjithë dëshirë u japin besimtarëve tjerë vendet më të

mira, ushqimin më të mirë dhe veshjen më të mirë. Kur bën të ftohtë, myslimanët e vërtetë çdo herë përkujdesen për myslimanët tjerë duke iu ofruar batanije dhe pije të ngrohta, edhe nëse ata kanë të ftohtë. Ata ndiejnë kënaqësi që të sigurojnë shëndetin, sigurinë, rehatinë dhe lumturinë e shokëve të tyre, pasi që e dinë se kënaqësia që rrjedh nga këto akte të vetë-flijimit nuk mund të krahasohen me kënaqësinë e pirjes së lëngjeve të ngrohta.

Njerëzit mund të shfaqin moral të lartë nëse çdo gjë shkon siç duhet në bollëk, nëse kanë shëndet të mirë dhe nevojat i kanë të plotësuar. Por, shfaqja e cilësive të larta morale në kohërat e vështirësive, apo trajtimi i mirë i të tjerëve derisa është i fyer me shpifje të rënda, duhet kundërpërgjigjur të ligës me të mirë. Shenjë tjetër i cilësive të moralit të lartë është kur i ngopuri i jep ushqim të pangopurit, i ngrohuri e vesh të ftohurin. Të dytë janë shumë të vlefshëm në prani të All-llahut, por duke shfaqur moral të shkëlqyer kur përballen me vështirësi është gjë shumë e rëndësishme dhe e vlefshme, për shkak të shfaqjes së forcës dhe sinqeritetin e besimit, devotshmërisë dhe virtytit të lartë të dikujt.

Përveç kësaj, ata që jetojnë jetë të virtytshme duke dëgjuar ndërgjegjen e tyre mund të dëgjojnë pëshpëritjet e liga që dërgojnë në ligësi, supozohet se është vështirë të jesh i vitytshëm, dhe përpjekja për të parandaluar të mos-qenit i virtytshëm. Ky zë bën që njerëzit të frikohen se do të ftohen nëse dikujt i jepet palltoja ose do të mbesin të uritur nëse e japin ushqimin. Kjo është ndër taktikat e shejtanit, që ai përdor për të frikësuar me varfëri ashtu që të parandaloj besimtarët që të ndihmojnë të varfrit

“O ju që besuat, jepni nga më e mira e asaj që e fituat dhe nga ajo që u dhamë prej tokës, e mos nxitoni ta jepni atë më të pavlefshmen nga ajo, e që ju nuk do ta pranoni për vete vetëm symbyllas. E, dinë se All-llahu s’ka nevojë për ju, është

i Madhëruar. Djalli ju frikëson nga varfëria dhe ju urdhëron për të këqija, e All-llahu ju garanton falje (mëkatesh) e begati; All-llahu është Dhurues i Madh, i Dijshëm.” (Bekare, 2:267-68)

Ajetet thonë se All-llahu nxjerr në shesh mashtrimet e shejtanit dhe i paralajmëron njerëzit me lajme të mira nga mëshira e Tij. Si shpërblim All-llahu për moralin e tyre të lartë, do t’iu dhuroj një kënaqësi shpirtërore që nuk mund të krahasohet me asnjë kënaqësi të kësaj bote. Nuk ka kufizim të kënaqësisë që buron nga vetëflijimi, durimi, besnikëria, bujaria, njerëzia dhe lojaliteti. Në një ajet, All-llahu vlerëson lart karakterin moral të atyre besimtarëve që me kënaqësi hapin dyert e shtëpive për ata myslimanë që kanë migruar nga vendi i tyre, duke iu siguruar çdo gjë që nevojitet përkundër faktit se edhe ata kanë nevojë për ato gjëra:

“Edhe ata që përgatitën vendin dhe besimin para tyre, i duan ata që shpërnguleshin te ata dhe nuk ndiejnë në gjokset e tyre ndonjë nevojë (për zili a tjetër) nga ajo që u jepej atyre (muhaxhirëve), madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për të, ata u jepnin përparësi atyre para vetvetes. Kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar” (Hashr, 59:9)

All-llahu gjithashtu tregon për shpërblimet që do të merren pas sprovës me etje, lodhje dhe uri për ata që veprojnë drejt:

“Nuk ishte me vend për banorët e Medinës e as për ata që ishin rreth tyre nga beduinët, të ngelin (pa shkuar) pas të dërguarit të All-llahut e as të kursejnë veten e tyre ndaj vetes së tij (Pejgamberit). Nuk ishte me vend ngase, ata nuk i godet as etja, as lodhja, as uria kur janë në rrugën e All-llahut, dhe nuk shkelin ndonjë vend që i hidhëron mosbesimtarët, dhe nuk arrijnë kundër armikut çka do qoftë (mbytje, robërim të tyre ose ngadhënjim mbi ta), vetëm se të gjitha ato do t’u

evidentohen atyre si vepër e mirë (shpërblyese). All-llahu nuk ua humb shpërblimin veprim-mirëve. “ (Teube, 9:120)

Siç thotë edhe ajeti, çdo frustrim që përjeton myslimani në rrugën e All-llahut, në fakt, është vepër e mirë. Duke ditur që të gjithë njerëzit janë krijuar vetëm për t'i shërbyer All-llahut dhe për të bërë punë të mira, ata do të fitojnë shpërblim të përkryer për durim dhe karakterin e moralit, dhe nuk do t'u bëhet e padrejtë.

Gjë e vërtetë është edhe me sëmundjen dhe frustrimet tjera. Besimtarët e dinë se vetëm All-llahu do t'i shpërblejë dhe se kjo botë është e përkohshme. Prandaj, ata çdoherë janë mendjehollë, të vendosur dhe të prerë pasi që kanë lexuar në Kur'an se Ai jep forcë shpirtërore dhe mbështetje besimtarëve që punojnë për Të. Mësimi i fshehtësitë së sprovave të kësaj jete shkakton kënaqësi të madhe dhe lehtësim gjatë ballafaqimit me vështirësi. Për ata që dinë se çfarëdo që iu ndodhë është test asnjëherë nuk bëhen të brengosur, të frustruar, të humbin shpresën, të hutohen nga frika dhe shqetësimi apo të bijnë në depresion.

Forca që mban besimtarin

Forca e kënaqësisë në karakterin kur besimtarët shfaqin kur përballen me vështirësitë dhe frustrimet është diç që ata që nuk besojnë në fuqinë e lartësuar të All-llahut nuk mund ta kuptojnë. Jobsimtarët dyshojnë dhe pyesin veten se çfarë force është duke i mbajtur këta njerëz, pasi që ata nuk besojnë në All-llahun, ata nuk janë të vetëdijshëm për atë se vetëm Ai mund të vendos këtë forcë. Për ta, njerëzit janë të fortë për shkak të mjeteve materiale dhe shokëve. Prandaj, ata çdoherë kërkojnë ndonjë qëllim dhe burim material që ata besojnë është përgjegjëse për fuqinë e besimtarit. Sidoqoftë, kjo fuqi vjen nga besimi i besimtarit në kader dhe në

botën e pastajme, si dhe nënshtrimi dhe besimi në All-llahun. Jetët e profetëve dhe besimtarëve tjerë të devotshëm përmbajnë shumë shembuj të mirë në lidhje me forcën që lind nga ky besim.

Shembull i rëndësishëm është grupi i magjistarëve të faraonit, që tregojnë forcën e karakterit të tyre kur faraoni i ka kërcënuar me vdekje. Kur'ani na thotë se faraoni është përpjekur t'i frikësojë ata me tortura dhe vdekje, t'i mbaj larg pasimit të rrugës së drejtë që profeti Musa as u kishte treguar. Sidoqoftë, përgjigja e tyre tregoi se ata i frikohen vetëm All-llahut dhe iu kthyen Atij përkundër çdo vështirësie që ka mund t'u ndodhte. Përkundër të gjitha kërcënimeve nga faraoni, magjistarët i thanë atij se do të mbetën të paepur në rrugën e nënshtrimit dhe besimit në All-llahun që besimi i tyre u kishte dhënë:

Ai (faraoni) tha: “Ai besuat atij para se t’u japë leje? Ai (Musai) është prijës i juaj, i cili a mësoi magjinë, unë do t’ua pres duart e këmbët tërthorazi e do t’u varë në trungjet e hurmave, e atëherë ju do a kuptoni se cili prej nesh ka dënim më të ashpër e më të vazhdueshëm?” Ata thanë: “Pasha Atë që na krijoi, nuk të japim përparësi ty ndaj argumenteve që na erdhën, e ti bëje atë që mendon ta bësh, dhe mund ta zbatosh vetëm atë që i takon jetës së kësaj bote!” Ne i besuam Zotit tonë që Ai të na falë gabimet dhe magjinë, me të cilën ti na detyrove. All-llahu është më i miri (në të shpërblyerit) dhe më i përjetshmi (në të dënuar)! (Ta Ha, 20:71-73)

Shembull tjetër është kur të rinjtë i besuan profit Musa as. Kërcnimet e faraonit parandaluan që disa njerëz të tij të besonin në All-llahun, dhe kështu pësuan humbje të madhe. Por besimtarët e devotshëm që frikoheshin vetëm fuqisë së All-llahut pasuan rrugën që profeti Musa as ua tregoi. Shtypja dhe përdhunimet e faraonit dhe shoqërisë së tij nuk i largoi nga rruga:

Duke pasur frikë nga faraoni dhe nga rrethi i tij se do t'i torturojnë, Musait nuk i besoi kush pos një pjese të pasardhësve të popullit të tij. Vërtet, faraoni ishte mbizotërues në tokë dhe ai ishte prej shkatërrimtarëve. (Junus, 10:83)

Sikur këta të rinj të devotshëm që i kanë besuar profetit Musa as, gjithë besimtarët shfaqën besim dhe guxim të njëjtë kur ballafaqoheshin me shoqëritë armiqësore apo vështirësi serioze, frustrime apo nevojë. Kur'ani thotë:

E kur myslimanët e panë ushtrinë aleate, thanë: “Kjo është ajo që All-llahu dhe i dërguari i Tij na premtuan neve, e All-llahu dhe i dërguari i Tij e thanë të vërtetën. Ajo (ushtria e armikut që e panë) vetëm ua shtoi atyre besimin dhe mbështetjen. (Ahzab, 33:22)

Nënshtrimi i sinqertë ndaj All-llahut në kohët e vështira

Njëra ndër gjërat më të shquara që dallon myslimanin e devotshëm nga të tjerët është përkujdesja ndaj urdhrave dhe këshillave të All-llahut. Asnjë vështirësi, frustrim apo kufizim nuk do ta pakësojë vendosmërinë e tyre për t'iu përmbajtur atyre apo që të rrezikojnë karakterin e tyre moral. Nuk është me rëndësi se në çfarë nevoje apo hall të gjenden, ata kurrë nuk mendojnë të bëjnë diçka që All-llahu e ka ndaluar. Në situatën kur është i sëmurë, ka nevojë, dështon apo ka presion, nuk e rrezikojnë nderin dhe sinqeritetin e tyre.

Siç thamë edhe më parë, shejtani dëshiron që t'i shmang njerëzit nga rruga e vërtetë dhe e dëgjojnë zërin e lig. Pra, ai nxit njerëzit që të bëjnë gjëra që All-llahu i ka ndaluar dhe i ndalon që të bëjnë atë që All-llahu e pëlqen. Ky zë negativ i brendshëm çdoherë

punon në këtë drejtim, vazhdimisht duke pëshpëritur gjëra të liga në mendjen e tyre. Për shembull, ky zë negativ dëshirë që t'i parandaloj njerëzit dhe mos të çohen në namaz; i bën të përgjumur, të flashkët, dhe të padisponueshëm; dhe vazhdimisht përpiket që t'i bëj që të harrojnë se përse duhet bërë këtë. Shejtani i frymëzon që të pyesin veten: “Çka ka lidhje edhe nëse nuk çohem sot?”

Por besimtarët nuk e dëgjojnë këtë zë negativ. Ata çohen çdo mëngjes pa përtesë dhe të vendosur që të kryejnë namazin, duke përkujtuar se kjo është rruga për në bukuri të vërtetë dhe shpëtim. Ky zë negativ gjen lloj-lloj arsyesimesh që të bëhet agjërimi i vështirë, edhe pse All-llahu ka urdhëruar këtë adhurim. Ai përpiket që ta paraqet urinë dhe etjen shumë të vështirë. Nëse agjërojnë, ky zë vë dyshim në ta se a do të jenë të aftë të qëndrojnë. Por myslimanët e devotshëm agjërojnë me përcaktim të prerë përkundër presionit të këtij zëri. Ata shpresojnë në shpërblimin që do ta kenë nga Zoti i tyre për urinë, etjen dhe lodhjen që ata duhet ta durojnë për ta fituar kënaqësinë e All-llahut. Dhe gjatë kësaj kohe ata ndiejnë kënaqësi të madhe.

Ngjashëm, në situatat kur fitimi i ndaluar i parave konsiderohet i lejuar, ky zë i brendshëm e bën që të duket gjë e lehtë dhe sugjeron se të gjithë e bëjnë të njëjtën gjë. Edhe pse mund të kenë nevojë të madhe dhe ky zë i brendshëm bën presion edhe më të madhe tek ta, myslimanët duhet që mos ta japin veten dhe të përulen që të marrin të ndaluarën, dhe të hanë bukë me para të fituar në mënyrë të ndaluar, pa marrë parasysh se sa janë të uritur. Edhe situata e tillë do t'i bënte të mos ndihen këndshëm. Ata kurrë nuk do të pohojnë se nevoja është arsyetim për sjellje të gabuar, por e dinë se është e rëndësishme që çdo herë të largohen nga ajo që All-llahu e ka ndaluar. Ata praktikojnë këtë rregull me një ndjenjë të brendshme të mirëqenies dhe sinqeritetit të vërtetë.

Kur'ani fton myslimanët që të sillen ashtu që të fitohet kënaqësia e All-llahut 'si ata që garojnë mes veti në punimin e veprave të mira'. Duke u përpjekur që të fitojnë xhenetin e premtuar, myslimanët përjetojnë paqe dhe mirëqenie duke dhënë kur të munden dhe çka të munden dhe nga të qenit i durueshëm në çdo vështirësi. Për shembull, mund të kenë ndonjë shok mysliman që është në nevojë. Pra, zgjohen një mëngjes dhe përpiqen që t'i kënaqin shokët e tyre duke iu dhënë atë që iu nevojitet. Shumicën e rastit ata që pranojnë dhuratat as nuk e dinë se kush iu ka dhënë, ndërsa dhuruesit të kënaqur me sjelljen e tyre të lartë, kurrë nuk do ta bënin këtë gjë të ditur nëse do të paraqiste ndonjë vështirësi për ta.

All-llahu thotë se myslimanët kanë ndjenjë të thellë kënaqësie duke jetuar në pajtim me moralin kuranor dhe qortojnë sjelljen e kundërt:

... All-llahu juve ua bëri të dashur besimin dhe ua zbukuroi atë në zemrat tuaja, ndërsa mosbesimin, shfrenimin dhe kundërshtimin, ua bëri që t'i urreni. Të tillë janë ata që gjetën rrugën e drejtë. Kjo është dhuratë dhe begati prej All-llahut, e All-llahu është i dijshtëm dhe i urtë. (Huxhurat, 49:7-8)

Por, përkundër të gjithave, shejtani përpiket që të gjitha veprat e ndaluara t'i paraqes si të lejuara. Për të bërë këtë, shejtani tregon se ata që bëjnë gjëra të liga janë më shumë. Shumica e njerëzve marrin para të ndaluara, duke mos ia vënë veshin se a është e lejuar kjo apo jo, dhe shkelin parimet e moralit kuranor. Prandaj, shejtani çdoherë aludon logjikën se shumica kanë të drejtë dhe ka kuptim. Por, Kur'ani thotë se ata që bëjnë vepra të liga nuk janë në rrugë të drejtë, edhe pse janë shumicë: **"Në qoftë se u bindesh shumicës (mohuese që janë) në tokë, ata do të largojnë ty nga rruga e All-llahut. Ata nuk ndjekin tjetër vetëm supozime dhe nuk janë tjetër vetëm se rrenacakë."** (En'am: 6:116), por, në të kundërtën, All-llahu thotë se

FSHEHTËSIA E SPROVËS

vetëm një grup i vogël e njerëzve ka besim dhe se shumica janë në rrugë të gabuar. Për këtë shkak, shejtani nuk mund të mashtrojë besimtarët por vetëm tek ata që e kanë besimin e dobët, që mendjen e kanë të hapur për dyshime dhe frikë, si dhe ata që haptazi mohojnë All-llahun.

Suçeltësia e myslimanëve të devotshëm rrjedh nga besimi në All-llahun dhe vendosmëria e palëkundur që besimi sjell me vete, si dhe morali i tyre i lartë. Myslimanët e dinë se sjellja e mirë përbëhet nga veprat që shpërfillin epshin. Për shembull, kur bujaria, besnikëria, durimi, dhe vetitë tjera të larta morale vihen në praktikë, epshi neveritet. Por si rezultat i tërë kësaj do të jetë e mira materiale dhe shpirtërore. Jeta në këtë dhe botën tjetër në shpresën për shpërblim për moralin e pastër është më e mirë sesa të gjitha gjërat e kësaj bote dhe kënaqësia e epshit. Për shembull, ata që refuzojnë pëshpëritjet e epshit për të hyrë në ndonjë marrëdhënie të palejuar, dhe parapëlqejnë që të presin shpërblimin e tyre në jetën e pastajme, do të përjetojnë nder dhe drejtësi në këtë jetë. Në të njëjtën mënyrë, ata që mbesin të uritur apo pa gjumë për të plotësuar nevojat e shokëve myslimanë, pa marrë parasysh vështirësitë, do të jenë të kënaqur në shpresën për të fituar kënaqësinë e All-llahut.

Myslimanët që kanë këto veti të mira të moralit, që All-llahu i ka lartësuar në Kur'an, fitojnë edhe respektin dhe dashurinë e myslimanëve tjerë. Nëse punojnë shumë për çështjen e All-llahut dhe me kënaqësi përballen me çdo pengesë, nëse veprojnë me përkushtim të pashoq për çështje të drejtë pa frikë të konfrontimit, dhe nëse janë të gatshëm për çdo lloj vetëflijimi, dashuria dhe respekti që tjerët kanë për ta, do të rritet shumëfish. Në Kur'an, All-llahu i referohet atyre që jetojnë sipas moralit të lartë: **“E atyre të cilëve u priu e mbara nga ana jonë, do të jenë larg tij (Xhehennemit).”** (Enbija, 21:101) dhe na tregon për vetitë e larta të moralit.

Myslimanët janë shokë të vërtetë në kohërat e duhura

Ekziston një thënie tek jofetarët: Në vështirësi njihet shoku. Kjo është një shprehje e mirë për idenë se nuk mund të gjesh shok të vërtetë kur të duhen. Sido që të jetë, shoqëria, besnikëria janë shumë të rëndësishme në jetën e njeriut, për ata që janë në vështirësi financiare apo të sëmurë, që kanë nevojë për mbështetje morale, që dëshirojnë shok të afërt- shok që është besimtar- t'i ndihmoj. Por, meqenëse të gjitha marrëdhëniet në shoqëritë jofetare bazohen në oportunitizëm, jobesimtarët nuk mund të gjejnë shok të vërtetë. Vetëm kur janë në hall apo nevojë i shohin njerëzit dhe fytyrën e vërtetë të atyre që ata çdoherë i kanë konsideruar si shokë. Shokët e tyre të supozuar, bile edhe më shumë i komplikojnë gjërat në kohërat e vështira. Për shembull, kur dikush përjeton vështirësi dhe i nevojitet dikush me e qa hallin, nuk kanë me kënd, dhe mbesin të vetmuar.

Për shembull, pasaniku që nget veturën luksoze dhe han në restorante ekstravagante në përgjithësi ka rreth të gjerë shokësh, e bile edhe disa të ngushtë. Por nëse humb punën dhe punon për një rrogë të zakonshme në fabrikën e vet, si do të vejnë marrëdhëniet më tutje? A do të tregojnë respektin dhe interesin e njëjtë rrethi i tij i shokëve sikur atëherë kur ka ngarë veturën luksoze dhe ka pasur veshur rroba të shtrenjta? Si do të trajtohet kur të vishet me modesti, dhe nuk hedh para andej këndej si përpara, dhe nuk i qeras shokët e tij me darkë? Shumë qartë, nuk do ta ketë vëmendjen e njëjtë. Në të vërtetë, të gjithë ata që i ka konsideruar shokë do t'ia kthejnë shpinën. Kur e takojnë atë, ata bëhen se nuk e shohin e bile ndoshta edhe e përqeshin. Në të vërtetë, shpirti i tij nuk ka ndryshuar; por vetëm pamja e jashtme e tij. Por, pasi që shokët e tij të mëparshëm mbështetën vetëm në pamjen e jashtme materiale, e braktisin atë, duke e lënë të vetëm.

FSHEHTËSIA E SPROVËS

Marrim një shembull tjetër, të një çifti të martuar. Kur janë martuar, kanë dhënë premtimin se do të jenë bashkë në të mirë e në të keqe. Por çfarë ndodhë nëse gruaja paralizohet nën bel për shkak aksidenti dhe nuk mund të ec as të bëj asgjë vetë? Çfarë do të bëj burri? Ndoshta do ta ndihmojë për pak kohë. Por kur do të kuptojë se kjo është situatë e përhershme dhe prej së cilës më nuk do të sheh ndonjë dobi, papritmas çdo gjë ndryshon. Ky shembull tregon se si jobesimtarët konsiderojnë besnikërinë, lojalitetin dhe miqësinë. Kur humbet profiti, mbaron lidhja. Shumica e atyre që nuk e braktisin gruan në situata të tilla dhe mbesin për shkak se frikohen se çfarë do të mendojnë miqtë e tyre, e jo për shkak të dashurisë dhe dhembshurisë për bashkëshorten e paaftë. Në sipërfaqe, duken të përkushtuar dhe besnikë, por nuk e ndiejnë dhembshuri dhe ndjeshmëri për gruan e tij kur më së shumti i nevojitet.

Situatë tjetër e shpeshtë që haset në shoqëritë jofetare që tregon se ata janë shumë larg nga morali kuranor është se si të rinjtë sillen ndaj prindërve të tyre. Me vite, familjet e tyre plotësojnë çdo nevojë; por kur i plaken prindërit dhe gjymtyrët e tyre më nuk i mbajnë, të rinjtë nuk shfaqin dashurinë dhe besnikërinë ndaj tyre. Ata ndihen të prangosur me prindërit e tyre dhe zakonisht i vendosin në shtëpi të pleqve.

Sido qoftë, si në çdo situatë, myslimanët shfaqin besnikëri ndaj anëtarëve të familjes së vet. Ata ushqejnë prindërit e tyre por ta lënë veten të uritur, dhe kujdesen maksimalisht që t’iu plotësojnë të gjitha dëshirat. All-llahu këshillon se si duhet sjellë ndaj prindërve:

Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as “of - oh”, as mos u bë i

vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjalë të mira (të buta respektuese). (Isra, 17:23)

Me fjalë tjera, myslimanët nuk ankohen për besimtarët që janë në nevojë; por iu ndihmojnë njerëzisht me çka kanë. I vetmi vend që mundesh me gjetur miqësinë e vërtetë dhe besnikërinë e sinqertë është në mesin e myslimanëve të devotshëm. Myslimanët janë miqë, përkrahës dhe ndihmës i njëri tjetrit. Të obliguar nga morali i tyre i lartë për përfilljen e mirëqenies së shokëve të tyre, edhe nëse bien në vështirësi të pashpresë, ata do të bëjnë çmos që të dalin në ndihmë shokëve të tyre dhe ndiejnë kënaqësi me veprën e tyre vetëflijuese. Kur miqtë e tyre janë të sëmurë apo në vështirësi financiare, ata kujdesen për ta bile para se kjo të kërkohet nga ata. Edhe nëse humbin gjumin apo uriten, ata nuk lejojnë që të shohin shokun mysliman të trajtohet padrejtësisht apo në nevojë. Në Kur'an All-llahu na tregon për shokët e vërtetë të besimtarëve:

Mik (i afërt) juaji është vetëm All-llahu, është i dërguari i Tij dhe ata që besuan e që falin namazin dhe japin zekatin duke bërë rukunë (duke qenë respektues). (Maide, 5:55)

Është e vërtetë se ata që besuan, u shpërngulën dhe luftuan me pasurinë e tyre në rrugën e All-llahut, dhe ata që strehuan (të shpërngulurit) dhe u ndihmuan, të tillët janë miq të njëri tjetrit (në ndihmë dhe në trashëgim). Ata që besuan por që nuk u shpërngulën, ju nuk keni përkujdes as ndihmë për ta deri sa të shpërngulen edhe ata. E nëse ata kërkojnë ndihmë prej jush për çështjen e fesë, atëherë jeni të obliguar t'u ndihmoni, përveç nëse është puna kundër një populli që me të keni marrëveshje (nuk mund t'u ndihmoni në luftë kundër atij populli). All-llahu mbikëqyr atë që veproni. (Enfal, 8:72)

Me çdo vështirësi ka edhe lehtësi

Që në fillim, kemi folur rreth vështirësive dhe frustrimeve të ndryshme që All-llahu teston besimtarët dhe zbulon moralin e lartë të tyre që e shfaqin në situatat e tilla. Kemi folur edhe për mirëqenien, ndjenjat e dashurisë dhe respektit që ata përjetojnë duke vepruar sipas vetive të tyre morale. Sidoqoftë, nuk duhet lënë pas dore e mos të përmendet se në çdo sprovë, All-llahu sjell edhe të mirën dhe lehtësim tek shërbëtorët e Tij. Në Kur'an, All-llahu përkujton këtë premtim:

E, pa dyshim se pas vështirësisë është lehtësimi. Vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi. (Inshirah, 5-6)

... All-llahu me këtë dëshiron lehtësim për ju...(Bekare, 2:185)

Dhe Ne do të drejtojmë ty në më të lehtën. (A'la, 87:8)

... E kush i frikësohet All-llahut, Ai atij ia lehtëson punën. Ky është vendim i All-llahut që ua zbriti juve, e kush e ka frikë All-llahun, Ai atij ia shlyen të këqijat dhe ia shton shpërblimin. (Talak, 65:4-5)

Ai që është i pasur, le të shpenzojë sipas mundësisë së vet, e ai që është ngushtë nga pasuria, le të japë nga ajo që i ka dhënë All-llahu, e All-llahu nuk ngarkon askënd, vetëm aq sa i ka dhënë; mirëpo pas vështirësisë All-llahu sjell çlirim (begati). (Talak, 65:7)

E, sa i përket atij që jep dhe ruhet, Dhe vërteton bindshëm për më të mirën, Ne do ta përgatitim atë për më të lehtën. E sa i përket atij që bën koprraci dhe ndien veten të pavarur (nga Zoti), Dhe që përgënjeshton atë më të mirën, Ne do ta përgatisim për më të vështirën. E pasuria e tij nuk do t'i bëjë dobi, kur ai të zhduket. (Lejl, 92:5-11)

Siq tregojnë edhe vetë këto ajete, all-llahu lehtëson ata besimtarë duke punuar në vështirësi dhe frustrim dhe dërgon ndihmë nga

prania e Tij. Kur'ani thotë se All-llahu dërgon ndihmën përmes engjëjve, dhe këtë Ai e bën vetëm që të inkurajohen me lajme të mira.

All-llahu u ndihmoi juve në Bedër kur ju ishit pak në numër, e për të qenë mirënjohës, keni frikë nga Zoti. Kur ti u thoshe besimtarëve: “A nuk është mjaft për ju që Zoti juaj t’ju vazhdojë ndihmën me tre mijë engjëjt e zbritur?” Po, nëse jeni të qëndrueshëm e të matur, e ata (armiqtë) t’ju vinë tash në këtë moment, Zoti juaj ua vazhdon juve ndihmën me pesë mijë prej engjëjve të ushtruar (për luftë) ose të shënuar. E atë (ndihmë) All-llahu nuk e bëri për tjetër por vetëm për t’ju gëzuar dhe me të të qetësojë zemrat tuaja, për ndryshe ndihma vjen vetëm prej All-llahut, ngadhënjyeshit, të urtit. (u ndihmoi) Që ta këpusë një grup nga ata që nuk besuan (duke i mbytur a zënë robër), ose për t’i demoralizuar dhe ashtu të kthehen të dëshpëruar. (Ali Imran, 3:123-27)

Përveç ndihmës nga engjëjt, All-llahu gjithashtu mbron besimtarët me një armatë të padukshme dhe u jep atyre ndjenjë të sigurisë dhe mirëqenies. Për shembull, Kur'ani përshkruan mbështetje që All-llahu i ka dhënë të dërguarit gjatë një periudhe të vështirë në misionin e tij:

Në mos e ndihmofshi atë (Pejgamberin), atë e ka ndihmuar All-llahu; kur ata që nuk besuan e nxorën atë vetë të dytin; kur që të dy ishin në shpellë, kur po i thoshte shokut të vet: “Mos u pikëllo (friko), All-llahu është me ne!” E All-llahu zbriti qetësi (në shpirtin e) atij, e fuqizoi me një ushtri që ju nuk e patët; e fjalën e atyre që nuk besuan më të ultën, kurse fjala e All-llahut (është) më e larta. All-llahu është më i fuqishmi, më i urti. (Teube, 9:40)

Siç po shihet nga ajeti i sipërm, një ndjenjë e thellë e lehtësimit pason pas çdo periudhe të vështirë. Në të vërtetë, fakti se myslimanët

FSHEHTËSIA E SPROVËS

veprojnë si një njësi, duke ditur se çdo ngjarje përmban një test dhe duke ditur se duhet përgatitur për jetën e amshueshme i jep atyre ndjenjë të thellë të lehtësimit gjatë sprovave. Përveç kësaj, All-llahu sjell besimtarëve lajme edhe më të mira. Siç kemi parë nga jeta e të dërguarit savs dhe myslimanëve të devotshëm, pasi përfundojnë vështirësitë, All-llahu u jep besimtarëve fitore definitive. Jeta e profetit Jusuf as është shembull për këto lajme të mira.

Kur Jusufi as ishte shumë i ri, vëllai i tij e hodhi në bunar dhe e la që të vdes aty. At që e gjetën e shitën si rob një vezir egjiptas. Më vonë, Jusufi as ishte paditur padrejtësisht nga gruaja e vezirit, ishte arrestuar dhe kishte kaluar me vite në burg, ku përjetoi një mori vështirësish pa u rrezikuar morali i tij. Çfarëdo që i ndodhte, ai kërkonte strehim tek All-llahu dhe koha e tij e kaluar në burg u kthye si përvojë pozitive. Ai u bë shembull për të gjithë besimtarët me besnikërinë, mirëbesimin dhe nënshtrimin ndaj All-llahut në të gjitha fatkeqësitë. Si shpërblim, All-llahu e largoi nga burgu në kohën kur Ai ka dëshiruar dhe i ka dhënë pushtet dhe pasuri në Egjipt.

Për këtë arsye, jeta e tij është shembull i mirë për besimtarët. All-llahu premtan besimtarëve të Tij që shfaqin mirëbesim dhe durim në vështirësi si Ai do t'i sjell të mirat dhe lehtësim.

... Kështu këshillohet ai që i beson All-llahut dhe ditës së fundit, e kush iu përmbahet dispozitave të All-llahut, atij Ai i hap rrugë, dhe e furnizon atë prej nga nuk e kujton fare. Kush i mbështetet All-llahut, Ai i mjafton atij, All-llahu realizon dëshirën e vet dhe All-llahu çdo gjëje ia ka caktuar kohën (afatin). (Talak, 65:2-3)

Ky shembull zbulon se All-llahu teston robërit e Vet kohë pas kohe me vështirësi dhe frustrime. Por besimtarët që kanë njohuri se janë duke u sprovuar dhe vazhdojnë të jenë të nënshtruar All-llahut

kanë fituar diçka me rëndësi të madhe. E dinë se shpërblimi i tyre do të shumëfishohet në botën e ardhme për gjërat që kanë vuajtur në jetën e tyre, për moralin e lartë të treguar në lloj-lloj situata të vështira, si dhe për vetësakrificën, durimin dhe nënshtrimin. Ndoshta disa minuta vështirësi që ata durojnë do t'u sjell atyre miliona vjet shpërblim në xhenet. Sigurisht, ata që kanë njohuri për këtë premtim të madh jetojnë në pritje dhe shpresë se do të fitojnë xhenetin të mbushur me sende të mira. All-llahu përshkruan gjendjen e këtyre njerëzve me këto ajete:

(Robërit e Zotit janë) Edhe ata që nuk dëshmojnë rrejshëm dhe kur (rastësisht) kalojnë pranë së keqes, kalojnë duke e ruajtur karakterin e vet. Edhe ata që kur këshillohen me ajetet e Kur'anit të Zotit të tyre, nuk u kthejnë shpinën si të shurdhët e të verbër. Edhe ata që thonë: "Zoti ynë, na bën që të jemi të gëzuar me (punën) e grave tona dhe pasardhësve tanë, e neve na bën shembull për të devotshmit". Për shkak se duruan, të tillët shpërblehen me një shkallë të lartë (Xhennet) dhe aty priten me përshëndetje të selamit. Aty janë përgjithmonë, e sa vendqëndrim dhe vendbanim i mirë është ai. (Furkan, 25:72-76)

Ata janë njerëz që nuk i pengon as tregtia e largët e as shitblerja në vend për ta përmendur All-llahun, për ta falur namazin dhe për ta dhënë zeqatin, ata i frikësohen një dite kur do të tronditen zemrat dhe shikimet. (ata i luten) që All-llahu t'i shpërblejë më së miri për atë që punuan dhe për t'ua shtuar të mirat nga Ai. All-llahu e dhuron pa masë atë që do. (Nur, 24:37-38)

SI SILLEN JOBESIMTARËT KUR PËRBALLEN ME VËSHTIRËSI

Më herët, treguam se pa marrë parasysh gjendjen e brendshme, nuk ka ndryshim në karakterin moral të myslimanit. Ata që nuk kanë besim apo e kanë zemrën e sëmurë nuk mund t'i përballen vështirësive, pasi që e kanë durimin e kufizuar dhe kanë pikën e ultë të vlimit. Ndonjëherë, edhe gjëja më imtë mund të ngrit tensionin, që shkakton tërbimin e tyre, sharje, fillojnë grindje, fyerje të menjëhershme, shfaqin agresivitet dhe dhunë. Ata që janë zakonisht të hareshëm, të buzëqeshur dhe gazmor në rrethanat normale pësojnë ndryshim të përnjëhershëm të karakterit gjatë kohërave vështira. Ata shndërrohen në njerëz agresivë, të padisponuar, kokëfortë dhe të ngrysur. Kur myslimanët flasin me kujdes rreth të vërtetës dhe bukurisë, jobesimtarët zgjedhin të sulmojnë, dhe në këtë mënyrë zbulojnë fytyrën dhe karakterin e vërtetë.

Ajo që mund ta zbuloj karakterin e tyre të vërtetë mund të jetë mbetja papritmas papunë, ndonjë sëmundje, aksident, fatkeqësi etj. Nëse mbesin pa shtëpi për dy ditë apo mbesin pa gjumë, apo rehatia

e zakonshme iu mungon, brengosen. Në Kur'an, All-llahu përshkruan karakterin jofisnik që ata tregojnë në kohërat e vështira:

E njeriu, kur e sprovon Zoti i tij, e nderon dhe e begaton, ai thotë: "Zoti im më ka nderuar!" Por, kur për ta sprovuar ia pakëson furnizimin (e varfëron), ai thotë: "Zoti im më ka nënçmuar!" (Fexhr, 89:15-16)

Pra, All-llahu sprovon edhe jobesimtarët duke i begatuar si dhe duke ia u pakësuar furnizimin sipas vullnetit të Tij. Në situatën e tillë, myslimanët mbajnë besimin në All-llahun dhe i mbesin falënderues Atij, derisa jobesimtarët reagojnë menjëherë dhe bëhen mosmirënjohës. Ata nuk janë të vetëdijshëm se janë në sprovë, humbasin edhe këtë edhe botën tjetër.

Jobesimtarët reagojnë në sprova duke u brengosur apo duke shkuar aq larg sa të bëjnë vetëvrasje apo të gjejnë strehim në alkool apo drogë. Asnjëri nuk e merr parasysh arsyen e vështirësisë së tyre dhe nuk mendojnë për dobitë që rrjedhin nga ajo (vështirësia). Sido qoftë, All-llahu bezdis jobesimtarët me vështirësi **"...në mënyrë që të tërhiqeshin nga rruga që praktikonin"** (Zuhruf, 43:48). Me fjalë tjera, Ai i shpie në kohëra të vështira, ashtu që të ktheheshin në rrugë të drejtë, të pendohen dhe të besojnë me zemër. Por shumicën e kohës, këto vështirësi dhe frustrime vetëm sa u ngurtëson edhe më shumë zemrat e tyre dhe mohojnë edhe më shumë All-llahun.

E pse të mos përuleshin kur ju erdhi atyre dënimi jonë? Por zemrat e tyre ishin ngurosur, po edhe djalli ua hijeshoi atë që bënin. Meqë lanë pas dore atë me çka u këshilluan (t'i i drejtohen Zotit), Ne ua hapëm dyert e çdo gjëje (begatie) derisa kur u gëzuan për atë që ju kishte dhënë, i kapëm befas, e ata mbetën të zhgënjyer. (En'am, 6:43-44)

Gjendja e brendshme e atyre që janë dhënë pas kësaj bote

Botëkuptimi i myslimanëve mbi fshehtësinë e sprovave u jep lumturi dhe ndjenjë të mirëqenies, derisa të tjerët që janë dhënë pas kësaj bote jetojnë të frustruar, në dhimbje, dhe degjenerim moral. Derisa myslimanët kënaqen në frutat e durimit të tyre, ata që jepen pas kësaj bote dhe besojnë se do të jetojnë gjatë në këtë botë dhe nuk janë të vetëdijshëm se janë vetëm në sprovë dhe për këtë arsye përjetojnë frustrim dhe dhimbje nga mosdurimi, mosbesimi, egoizmi, zilia dhe ambiciet e kësaj bote. Kjo dhimbje shfaqet në çdo çast të jetës së tyre. Për shembull, çdo gjë që bëjnë është e pavlerë dhe e trishtueshme, si dhe joaftësia që të dallojnë se çfarë është e mirë dhe të shijojnë kënaqësinë që sjell morali i lartë.

Ata as nuk kanë nder e as moral, jeta e tyre sundohet nga hipokrizia. Gabimi më i madh i tyre është se mendojnë çdo kohë vetëm për vetveten. Si rezultat, ata mendojnë se të qenit ziliqar dhe vetjak sjell dobi dhe nuk shohin dëmin që rrjedh nga sjellja e tillë. Në fakt, ata që mendojnë kështu humbin të dy botërat. Jobsimtarët kanë humbur begatitë e pafundme të xhenetit; por çka është edhe më e rëndësishme, ata kanë humbur kënaqësinë dhe mëshirën e Allahut. Siç thotë Kur'ani, me të vërtetë kjo është një humbje e madhe:

Ai është që juve ju bëri zëvendësues në Tokë, e kush nuk besoi të keqen e mosbesimit e ka kundër vetes; dhe mosbesimi i jobsimtarëve nuk u shton tjetër te Zoti i tyre vetëm se urrejtje të fortë dhe jobsimtarëve nuk u shton tjetër, mosbesimi i tyre vetëm se dëshpërim. (Fatir, 35:39)

Ky ajet është mjaft mësimdhënës duke parë jobsimtarët paanësisht nga jashtë. Për shembull, prishja shpirtërore e dikujt që grabit jetimin apo grabit pasurinë e të varfrit dhe përdorë këtë pasuri të ndaluar që të blej tesha nuk kalon pa u vërejtur. "... **Kështu**

All-llahu lëshon dënimin mbi ata që nuk besojnë.“(En’am, 6:125)
Kjo prishje ndoshta nuk është e dukshme nga jashtë, por nga aspekti shpirtëror mund të vërehet nga ata që kanë frikë dhe respektojnë All-llahun. Këta njerëz përballen me prishje shpirtërore: janë të poshtër edhe pse kanë para dhe pasuri dhe nuk ushqejnë të varfrit dhe nevojtarët. Por, edhe nëse ndihmojnë, lënë mbresën se të obligojnë që t’iu kthehet. Përshkrimi kuranor për ta (të pamoralshmit, ushqehen me ushqim të ndaluar, grumbullojnë para pa dhënë lëmoshë, dhe shpenzojnë paratë në mënyrë të ndaluar) ngjallin ndikim në besimtarët.

A e ke parë ti (a e sheh) atë, që përgënjeshtrojnë përgjegjësinë dhe llogarinë në botën tjetër? Po ai është që e përzë në mënyrë të vrazhdë bonjakun. Dhe që nuk nxit për të ushqyer të varfrit. (Ma’un, 107:1-3)

Ne shpesh shohim fytyrat e këtyre njerëzve, që pasurohen në mënyra ilegale dhe të pandershme. Tregojnë shenjat se kanë fituar pasurinë duke vrarë, korruptuar, dhe mashtruar; kanë bërë përfitime të mëdha padrejtësisht; plaçkitin bonjakun dhe nuk japin as të varfrit e as nevojtarit; dhe veshin nga njerëzit të mirën dhe dinjitetin. Derisa përpiqen të të bëhen të mirë,, janë të rrethuar me prishje shpirtërore dhe zymtësi të thellë e të errët. Kjo është shenjë e jondershmërisë, mëkateve dhe imoralitetit. All-llahu përdorë fjalën “nënçmim” për të përshkruar këtë zymtësi dhe prishje, që është e dukshme në ta:

Atyre që bëjnë vepra të mira, u takon e mira (xhenneti) edhe më tepër (e shohin All-llahun). Fytyrat e tyre nuk i mbulon pluhuri i zi as nënçmimi, ata janë banues të xhennetit, aty janë përgjithmonë. E ata që bëjnë të këqija, dënimi i së keqes është aq sa është ajo, ata i mbulon poshtërimi. Ata nuk mund t’i mbrojnë kush nga All-llahu, fytyrat e tyre, porsì t’i kishte

mbuluar ndonjë copë e errët e natës. Ata janë banues të përjetshëm të zjarrit. (Junus,10:26-27)

Siç tregojnë këto ajete, bukuria e atyre me moral të lartë rritet derisa imoraliteti mbulon fytyrën e jobesimtarit sikurse errësira e natës. Është e domosdoshmëri e kësaj bote sprovash dhe testesh që All-llahu të shpërblejë njerëzit sipas veprave të tyre. Ata që kanë punuar mirë do të shpërblehen me të mirë; e ata që kanë bërë ligësira, do të shpërblehen me të liga. Besimtarët neveriten nga sjellja dhe qëndrimi i jobesimtarëve.

Për shembull, nëse mysafiri shkon në shtëpinë e jobesimtarit, çdo veprim i nikoqirit do ta bën mysafirin të mos ndihet rehat. Pa marrë parasysh se sa mirë duket ushqimi i ofruar, nuk i duket ashtu mysafirit i cili e njeh moralin e nikoqirit dhe se tërë jetën e ka kaluar në kundërshtim me urdhrat e All-llahut. Padrejtësia e bërë bonjakëve dhe varfërve len shumë larg ushqimin dhe pijen e ofruar. Besimtarët më shumë do të preferonin që të kenë gjyveç pa mish me para hallall sesa biftek të shijshëm me para haram. Mysafirit i ofrohet që të ulet në kolltuk. Por pasi e di se paratë që janë dhënë për ta blerë atë kolltuk, kurrë nuk do të ulej. Ai do të kuptoj se çdo gjë që është blerë në atë shtëpi është blerë me shfrytëzim të padrejtë të grave, fëmijëve dhe pleqve të varfër. Edhe nëse çdo gjë do të jetë shumë e pastër, do të jetë një kutërbim shpërndarës të prishjes shpirtërore që do ta bënte mysafirin që të ndihet keq. Kur'ani thotë se ata që hanë ushqim haram dhe dëgjojnë gënjeshtarët do të jenë të poshtëruar në të dy botët, dhe se edhe njerëzit tjerë do ta shohin këtë poshtërim.

... Po atë që All-llahu do, ta humbë, ti nuk mund të bësh asgjë për te (nuk mund ta shpëtosh). Janë ata të cilëve All-llahu nuk deshi t'iu pastrojë zemrat (prej kufrit). Janë ata që në këtë jetë kanë poshtërim, kurse në jetën tjetër kanë dënim të madh.

Janë ata që i përgjigjen të pavërtetës dhe hanë shumë haramin (ryshfetin). Në qoftë se vijnë te ti (për ndonjë gjykim), gjyko mes tyre ose hiq tyre. Nëse prapsesh prej tyre (nuk gjykon), ata nuk mund të sjellin ty kurrfarë dëmi. Po nëse gjykon mes tyre, gjyko drejtë; All-llahu i do të drejtit. (Ma'ide, 5:41-42)

Në të vërtetë, këta njerëz janë të pakënaqur si me veten ashtu edhe me tjerët si vetë, pasi që në ta shohin mizorinë dhe sjelljen e vet të pamoralshme. Pasi që me vetëdije punojnë atë që All-llahu e ka ndaluar, ata duken të paturp. Sot, ata që më së shumti janë të pacipë janë ata që angazhohen në prostitucion dhe të tjerët që fitojnë nga kjo. Ata që punojnë në këtë profesion të jomoralshëm shpejt largohen nga njerëzia dhe përfundimisht arrijnë në pikën ku nuk kanë më as mirësi e as dinjitet. Prostitucioni nxit meshkujt dhe femrat që të bezdisin të tjerët, dhe All-llahu i shqetëson ata me sëmundje, bezdisje, fatkeqësi, humbje, poshtërim dhe neveritje. Nënçmimi e tyre është gjë e qartë për të gjithë.

Në Kur'an, All-llahu përshkruan gjendjen e tyre në xhehenem atyre që kuptojnë fshehtësinë e sprovave të kësaj bote. Të rrethuar nga zjarri, e tëra që mund të bëjnë është të shikojnë habitur paraqitjen e shpejt të besimtarëve që kanë fituar begatitë e pafundme të All-llahut. Këta njerëz përjetojnë humbje të madhe si dhe ata afër tyre. Kur'ani thotë:

Do t'i shohësh ata duke iu afruar atij (zjarrit) të frikësuar nga nënshtrimi, se si e shikojnë me bisht të syrit tinëzisht (me një shikim të vjedhur). Ata që besuan do të thonë: "Vërtet, të humbur në ditën e kiametit janë ata që e humbën vetveten dhe familjen e vet!" Ta dini pra, se mizorët janë në dënim të përjetshëm. (Shura, 42:45)

SPROVA VAZHDON DERI NË VDEKJE

Cdo njeri sprovohet në këtë botë deri në ditën e vdekjes. Për këtë shkak, të gjithë njerëzit duhet që çdo çast të jetojnë në pajtim me urdhrat e All-llahut, të përkujtojnë All-llahun, të kërkojnë kënaqësinë e All-llahut dhe të adhurojnë All-llahun.

Ky realitet sjell me vete një të vërtetë tjetër: nëse njerëzit disi largohen nga rruga e drejtë dhe shfaqin jofalenderim ndaj All-llahut në momentin e vdekjes, mund të bien nga provimi dhe e tërë jeta të mos i vlejë. Edhe nëse kalojnë tërë jetën e tyre ashtu që të fitohet kënaqësia e All-llahut, dhe rebelimi në çastin e fundit mund të shndërrohet në zero.

Gjithë myslimanët duhet që ta marrin këtë rrezik seriozisht, pasi që shejtani, armiku më i madh i njeriut, nuk do të kursen asnjë moment që të sulmoj në pikat më të dobëta dhe në çastet e pakujdesshme, bile deri edhe në vetë çastin e vdekjes, që të largohen nga rruga e drejtë. Prandaj, çasti i vdekjes është moment i rëndësishëm. Dikush që thotë: “Paj, unë besoj në All-llahun. Aq shumë kam bërë që të fitoj miratimin e Tij. Me siguri se kam

shpëtuar”, është në një gabim të madh, pasi që edhe në Kur’an thuhet se njeriu duhet lutur për shpëtim “... duke e lutur Zotin e tyre nga frika dhe nga shpresa” (Sexhde, 32:16) deri në çastin e fundit të jetës. Secili mysliman ftohet që të ketë parasysh këtë urdhër:

O ju që besuat, kine frikë All-llahun me sinqeritet të vërtetë dhe mos vdisni, pos vetëm duke qenë myslimanë (besimtarë)! (Ali Imran, 3:102)

Ata që besojnë por më vonë mohojnë

Besimi është njëra ndër begatitë më të mëdha të All-llahut, që shpie në lumturi dhe mirëqenie në këtë botë si dhe shpëtim në botën tjetër. Prandaj, si për çdo begati, duhet falënderuar All-llahun, pasi që Ai është që jep dhe mban ashtu siç do Ai. Atyre që All-llahu nuk iu ka dhuruar besimin kurrë nuk do të mund ta marrin, edhe nëse tërë bota do të përpiquej që të bëj që të besojnë, çka edhe në Kur’an thuhet:

Nëse ti (Muhammed) përpiqesh për t’i vënë në rrugë të drejtë ata (dije se), All-llahu nuk e udhëzon atë që e ka humbur, dhe për ata nuk ka ndihmëtar. (Nahl, 16:37)

Pra, nga mëshira e Tij besimtarët janë të shpëtuar nga mosbesimi. Prandaj, çdo mysliman duhet falënderuar në çdo lutje, ashtu siç u takon njerëzve të xhenetit:

... e ata thonë: “falënderojmë All-llahun që na udhëzoi për këtë (për iman, për punë të mira, na hoq zilinë, na futi në Xhennet), pse sikur të mos na drejtonte All-llahu, ne nuk do të dinim të udhëzohemi. (A’raf, 7:43)

Të falënderoheni për bekimet të lavdërohet All-llahu me gojë dhe me vepra në mënyrë që të fitohet kënaqësia e Tij. Pasiqë namazi është falënderim për besim, çdo mysliman duhet që të bëj namaz me kujdes të madh pasiqë falënderimi është një dhuratë e madhe, të bëjnë çdo gjë që të fitojnë kënaqësinë e Tij dhe të bëhen të devotshëm.

FSHEHTËSIA E SPROVËS

Nëse nuk e bëjnë këtë gjë, duke menduar gabimisht se statusi i tyre i besimtarit është se janë në rrugë për xhenet, apo nëse harrojnë se ata janë sprovuar, atëherë këto bekime mund të largohen. Ashtu siç është shpallur në Kur'an, zemrat e tyre mund të ngurtësohen dhe përfundimisht, mund ta mohojnë All-llahun. Në atë shkallë, krejt çka kanë bërë apo besuar deri në atë shkallë humb vlerën, dhe të gjitha shpërblimet anulohen. All-llahu tregon këtë realitet në disa ajete:

... E kush zmbropset prej jush nga feja e tij dhe vdes si pabesimtar, ata i kanë zhdukur veprat e veta në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Të tillët janë banorë të zjarrit dhe në të do të qëndrojnë përjetshëm. (Bekare, 2:217)

Pasha All-llahun, ty të është shpallur, e edhe atyre para teje: "Nëse i bën shok (All-llahut), veprat tua janë të asgjësuara dhe ti do të jesh prej të humburve. (Zumer, 39 :65)

Ata që besuan ju thonë: "A këta ishin që u betuan në Zotin me betimin më të fortë të tyre se ishin me ju? I shkatërruan veprat e veta dhe aguan të dëshpëruar. O ju që besuat! Kush largohet prej nga feja e vet (i bën dëm vetes) s'ka dyshim se All-llahu do të sjellë një popull që Ai e do atë (popull) dhe ata e duan Atë (Zotin), (një popull) që është modest e i butë ndaj besimtarëve, por i ashpër dhe i fortë ndaj mohuesve, që lufton në rrugën e All-llahut dhe që nuk i frikësohet kërcënimit të asnjë kërcënuesi. Kjo (cilësi e atij populli) është dhuratë e All-llahut që i jep atij që do. All-llahu është dhurues i madh, i dijshtëm. (Ma'ide, 5:53-54)

Në Kur'an, All-llahu na tregon se disa besimtarë më vonë mohojnë besimin e tyre dhe sa larg shmangen nga rruga e vërtetë:

Vërtet, ata që besuan e pastaj tradhtuan, përsëri besuan pastaj tradhtuan dhe e shtuan mosbesimin, All-llahu nuk u falë atyre as nuk i udhëzon në rrugë të drejtë. (Nisa, 4:137)

Ata, të cilët pas besimit të tyre u bënë pabesimtarë, e pastaj e

shtuan mosbesimin, atyre kurrsesi nuk du pranohet pendimi. Të tillët janë mu ata të humburit. (Ali Imran, 3:90)

Ai gjithashtu përshkruan gjendjen e tyre në botën e pastajme: Në ditën kur ka fytyra që zbardhen dhe ka fytyra që nxihen. E për sa u përket atyre fytyrave që janë nxirë (u thuhet): **“A edhe pas besimit tuaj u bëtë pabesimtarë? Vuani pra, dënimin për shkak se ishit që nuk besonit!” (Ali Imran, 3:106)**

Këto ajete tregojnë për rrezikun nëse braktiset feja dhe pasohet rruga e gabuar. Të tillët kalojnë një pjesë të jetës së tyre në besimin në ekzistencën e Tij dhe jeton në pajtim me urdhrat e Tij. Por më vonë, epshi i largon nga feja e All-llahut e deri në mohim. Si rrjedhim, ata bëhen jofetarë, bile edhe më jofetarë se tjerët, pasiqë kishin mësuar të vërtetën, e kishin pranuar e pastaj e braktisën. Për këtë shkak, e gjithë puna e tyre e mirë do të anulohet. (All-llahu e di më së miri) Prandaj, njerëzit nuk duhet që të harrojnë bile as një moment të vetëm se në këtë botë ata janë të vënë në sprovë dhe shejtani do të përpiqet që t'i josh në rrugë të gabuar përmes pëshpëritjeve dhe dyshimeve në mendje se këto sprova nuk do të mbarojnë kurrë. Mohimi i All-llahut pas besimit në Të është rrugë për në agoni të pafund.

Bile, këta njerëz jetojnë një jetë të mjerë. Edhe nëse kanë fituar një masë të pasurisë materiale dhe komfor, ata vuajnë shpirtërisht për tërë jetën. Pasi që ata e dijnë të vërtetën, ata mundohen çdoherë që të bëjnë presion në ndërgjegje; sido që të jetë, ndjenjë e fajsisë çdoherë do t'ia djeg shpirtin. Por dhembja që përjetojnë në këtë botë nuk krahasohet me atë që kanë për të përjetuar pas vdekjes. Për këtë Kur'ani zbulon:

Ata që nuk besuan dhe vdiqën si mosbesimtarë, asnjërit prej tyre nuk do t'u pranohet për kompensim, qoftë edhe plotë faqen e dheut ari. Ata i pret dënim dhimbshëm dhe për ta nuk ka ndihmëtarë. (Ali Imran, 91)

Pasiqë ekziston ky rrezik, besimtarët duhet të jenë të kujdesshëm deri në çastin e fundit të jetës së tyre. Duhet që të rezistojnë çdoherë. Momentin që mendojnë se kanë bërë mjaft që të arrihet jeta e amshueshme, mund të fillojnë që të braktisin fenë. Siç thuhet edhe në Kur'an: **“Jo, është e vërtetë se ai i kalon kufijtë, për shkak se e ndien veten të pavarur.”** (‘Ale, 96:6-7)

Pra, çdoherë përkujtoje këtë rrezik dhe vepra në mënyrë që ta fitosh kënaqësinë e All-llahut. Sprovat e kësaj jete do të zgjasin deri në çastin më të fundit të jetës.

Të mbeturit mbrapa dhe të ikurit nga përpjekjet

Njerëz me pak apo aspak besim mund të jetojnë në mesin e myslimanëve sikurse kurrgjë nuk ka të keqe, në dukje duke pasuar rregullat e fesë. Por, All-llahu ka krijuar sprova të caktuara që të shfaqet karakteri i tyre i vërtetë. Myslimanët që me durim sprovohen nga vështirësitë, uria, nevoja, sëmundja apo humbje të pasurisë apo të të dashurve, bëhen të fortë; e ata që kanë zemrën e sëmurë i afrohen edhe më tepër mosbesimit në çdo moment.

Pra, edhe një herë e shohim rëndësinë e secilit moment. Disa njerëz mund të jetojnë një pjesë të madhe të jetës së tyre në besim në All-llahun, promovim të fesë dhe bëjnë vepra të mira. Por nëse ndalen së vepruari sipas ndërgjegjes së tyre, shndërrohen në njerëz të shkujdesur dhe zemërgur, nuk do të jenë në gjendje të shfaqin mendjehollësinë e tyre kur duhet. Brengat e kësaj bote mund të mbizotërojnë ndjenjën e tyre për të kërkuar kënaqësinë e All-llahut, një çështje që i shpie në mosbesim.

Shumë ajete tregojnë për përpjekjet e të dërguarve që të mbrojnë të pafajshmit nga shoqëria agresive dhe mbrojtjen e fesë së All-llahut. Atëherë, kjo përpjekje ishte akt i rëndësishëm adhurimi. I dërguari ynë s'ishte angazhuar në një luftë të rreptë kundër shoqërisë së tij

jobesimtare. Çdo luftë e ndërmarrë me urdhër të All-llahut dhe të të dërguarit savs është përgjegjësi fetare. Kur'ani thotë se ata që tentojnë të ikin tregon se ata janë larguar krejtësisht nga besimi.

Sot, lufta e myslimanëve kundër jobesimtarëve bëhet në sferën e ideve. Kjo luftë tenton që t'i përgënjeshtrojnë të gjitha argumentet e atyre që përdorin shkencën për të mohuar ekzistimin e All-llahut. Secili mysliman ka përgjegjësi të madhe, dhe asnjëri nuk mund të mbetet në prapavijë apo i papërfshirë. Në Kur'an, All-llahu thotë se ata që e bëjnë këtë i kanë zemrat e ngurta:

E kur zbritët një kaptinë (që thotë): të besoni All-llahun dhe luftoni së bashku me të dërguarin e Tij, ata të pasurit kërkuan leje prej teje dhe thanë: "Na le të mbesim me ata që rrinë!" U pajtuan të mbesin me ata që nuk vajtën (në luftë). Po zemrat e tyre janë mbyllur, andaj ata nuk kuptojnë. (Teube, 9:86-87)

Shembull tjetër është i atyre që gjejnë arsyetime kur të përballen me vështirësi dhe shuan shpirtin e vet duke u përpjekur që t'i largohet përgjegjësisë së vet:

Sikur të ishte fitim i afërt dhe udhëtim mesatar, ata (hipokritët) do të vinin pas teje, por për ta ishte largësi e vështirë. Ata do të betohen në All-llahun: "Sikur të kishim pasur mundësi, do të dilnim me ju". E shkatërrojnë veten e tyre; All-llahu e di se ata janë rrenacakë. (Teube, 9:42)

Këta shembuj nga periudha e të të dërguarit savs dhe nga periudha e profetëve të mëhershëm tregojnë për një realitet shumë të rëndësishëm: All-llahu sprovon vazhdimisht njerëzit dhe ka krijuar një fushë ndarëse ndërmjet atyre që flasin të vërtetën dhe ata që gënjejnë. Derisa myslimanët shfaqin fortësi dhe përcaktim në kohërat e vështira dhe frustrime, të dobët zbulojnë veten dhe largohen nga feja. Shembull i tillë ka ndodhur gjatë kohës së të dërguarit savs, kur zhvillohej luftë në mes myslimanëve dhe jobesimtarëve. Sipas Kur'anit,

FSHEHTËSIA E SPROVËS

disa myslimanë shfaqën dobësi atëherë dhe në kokë u silleshin mendime shqetësuese, duke menduar tjetër gjë e jo në të vërtetën për All-llahun. Në këtë kohë të vështirë, shejtani tentonte që t'i largonte këta myslimanë nga rruga e drejtë:

Vërtet, ata që u zbrapsën prej jush ditën e ndeshjes së dy grupeve (besimtarë dhe idhujtarë në Uhud), ata vetë djalli i shtyri të rrëshqasin me disa punë të tyre që i bënë, po All-llahu ua fali atyre gabimin; All-llahu është mëkatfalës dhe i butë. (Ali Imran, 3:155)

Kjo ngjaje përmban porosi të rëndësishme për besimtarët: All-llahu ka premtuar se njerëzit do të sprovohen ashtu që të ndahen të mirët nga të ligët, dhe se e vetmja rrugë që të kalohen këto momente të vështira është besimi i fortë dhe i sinqertë në All-llahun. Sigurisht, All-llahu i bën të lehta për shërbëtorët e Tij të devotshëm, dhe vendos një ndjenjë mirëqenie dhe sigurie në zemrat e tyre gjatë të gjitha vështirësive. Por duhet të mos harrojmë se premtimi i Tij për të sprovuar njerëzit në këtë botë dhe të ndajë të mirën nga e keqja është gjë e sigurt:

A mos menduat se do të mbeteni anash (pa u provuar), e pa u sqaruar te All-llahu ata që luftuan prej jush dhe, përpos All-llahut, pos të dërguarit të Tij dhe pos besimtarëve, nuk morën ndonjë të jashtëm mik intim. All-llahu e di hollësisht atë që bëni ju. (Teube, 9:16)

A menduan njerëzit të thonë: "Ne kemi besuar, e të mos vihen në sprovë?" Ne i sprovuam ata që ishin para tyre, ashtu që All-llahu gjithqysh do t'i dallojë ata që e thanë të vërtetën do t'i dallojë dhe gënjeshtarët. (Ankebut, 29:2-3)

PËRFUNDIM

Në këtë moment, çdo njeri është duke shkuar çdo herë e më afër momentit të vdekjes. Vdekja nuk respekton moshën, ajo është larg, si tek i riu ashtu edhe tek plaku. Një 68 vjeçar që është duke pritur vdekjen i shtrirë në shtrat, është afër vdekjes poashtu si një femër 18 vjeçare duke kaluar rrugën. Aksidenti mund të shkaktohet në kalimin për këmbësorë, kështu ky moment mund të jetë i fundit për të dytë... Kjo është njëra ndër realitetet më të rëndësishme në jetën njerëzore.

Gjithsesi, secili është i përfshirë në garë për të bërë sa më shumë për jetën e ardhshme ashtu siç munden në kohën e caktuar të tyre në këtë botë. Ashtu siç thotë Beduizzamani, 'Kjo botë e përkohshme është sikurse shesh. Është vend i këshillave, dhe shitblerjes.'¹¹ Me fjalë tjera, njerëzit mund të bëjnë diçka shumë të dobishme duke bërë tregti dhe të marrin kompensim të pafund në jetën e ardhshme për atë që e kanë bërë në këtë botë.

Këtu njerëzit me mendje të shëndoshë duhet që të dëgjojnë zërin e ndërgjegjes së tyre dhe të kenë parasysh se All-llahu i sprovon vazhdimisht. Në këtë rrugë që duket mjaft e vështirë, All-llahu shpalli Kur'anin si udhërrëfyes për çdo njeri si dhe ka dërguar profetë dhe myslimanë të devotshëm që të tregojnë rrugën e drejtë.

FSHEHTËSIA E SPROVËS

Pa marrë parasysh se me çfarë vështirësie përballen, ata që i kthehen All-llahut me zemër të çiltër do t'u dhurohet lehtësim në rrugën për shpëtim. Me fjalë të tjera, njëra ndër fshehtësitë të këtyre sprovave është se janë të mbushur me plot mundësi për secilin besimtar.

Që nga tash, e vetmja gjë që besimtarët duhet të bëjnë është që të vëzhgojnë 'kaderin' duke u shpaluar dhe të përvetësojnë karakterin e myslimanit të devotshëm, ashtu siç është shpallur në Kur'an. Kur'ani përshkruan gjendjen e atyre që mbeten gjithmonë besnik All-llahut dhe shfaqin durim dhe përcaktim gjatë rrugës së tyre për në jetën e ardhshme, në këtë mënyrë:

E sa profetë pati që së bashku me të luftuan turma të mëdha besimtarësh dhe për atë që i goditi në rrugën e All-llahut, ata nuk u dobësuan dhe nuk u përlulën. All-llahu i do durimtarët. Fjala e tyre nuk ishte tjetër pos vetëm të thonin: "Zoti ynë, na i falë mëkatet tona dhe lëshimet në punët tona dhe na forco në vendet tona (në luftë), ndihmona kundër popullit jobesimtar!" Ndaj All-llahu ua dha atyre shpërblimin e kësaj bote dhe shpërblimin më të mirë të botës tjetër; All-llahu i do punëmirët. (Ali Imran, 3:146-48)

MASHTRIMI I EVOLUCIONIT

Darvinizmi, me fjalë të tjera teoria e evolucionit, u prezantua me qëllim të mohimit të faktit të krijimit, por që në të vërtetë nuk është asgjë përveç një marrëzi e dështuar joshkencore. Kjo teori, e cila pretendon se jeta lindi rastësisht nga materia e pajetë, u zhvlerësua nga faktet shkencore të “projektimit” të qartë në gjithësi dhe në gjërat e gjalla. Në këtë mënyrë, shkenca vërtetoi se Allahu krijoi gjithësinë dhe gjallesat në të. Propaganda e zhvilluar sot për të mbajtur në jetë teorinë e evolucionit mbështetet kryekëput në shtrembërimin e fakteve shkencore, interpretimin e paragjykuar dhe gënjeshttrat dhe pavërtetësitë e maskuara si shkencë.

Mirëpo kjo propagandë nuk mund ta fsheh të vërtetën. Fakti se teoria e evolucionit është mashtrimi më i madh në historinë e shkencës ka ardhur në shprehje shumë e më shumë në botën shkencore gjatë 20-30 viteve të fundit. Hulumtimet e bëra pas viteve të 80-ta në veçanti kanë zbuluar se pohimet e Darwinizmit janë krejtësisht të pabaza, gjë që është thënë nga një numër i madh i shkencëtarëve. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në veçanti, shumë shkencëtarë prej fushave të ndryshme biologjia, biokimia dhe paleontologjia pranojnë gjymtinë e Darwinizmit dhe e përdorin konceptin e projektimit inteligjent për të shpjeguar zanafillën e jetës.

Ky “projektim inteligjent” është një shprehje shkencore e faktit se Allahu i krijoi të gjitha gjallesat.

Ne kemi ekzaminuar rënien e teorisë së evolucionit dhe provat e krijimit në mënyrë shumë të hollësishme shkencore në shumë prej punimeve tona dhe vazhdojmë ta bëjmë këtë. Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të kësaj çështjeje, do të jetë shumë e dobishme që ta bëjmë një përmbledhje të saj këtu.

Dështimi shkencor i Darwinizmit

Teoria e evolucionit, edhe pse është një doktrinë që i ka fillimet në Greqinë e lashtë, u përqaftua gjerësisht në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri teorinë temën kryesore të botës së shkencës ishte botimi në vitin 1859 i librit Origjina e Llojeve të Çarlls Darvinit. Në këtë libër, ai doli me pretendimin se llojet e ndryshme në tokë nuk janë krijuar veç e veç, por rrjedhin nga një stërgjysh i përbashkët dhe kanë ndryshuar nga njëra-tjetra nëpërmjet ndryshimeve të vogla me kalimin e kohës. Teoria e Darvinit nuk mbështetet në asnjë zbulim shkencor konkret, siç e pranoi edhe ai vet, ajo ishte vetëm një “supozim”. Veç kësaj, ashtu siç e pranoi Darvini në kapitullin e gjatë të librit të tij të titulluar “Vështirësitë e Teorisë”, teoria dështoi përballë një sërë çështjesh vendimtare.

Darvini mbështeti të gjitha shpresat e tij në zbulimet e reja shkencore, të cilat shpresonte që do të zgjidhnin këto vështirësi. Mirëpo, në kundërshtim me atë që ai shpresonte, zbulimet shkencore zgjeruan përmasat e këtyre vështirësive. Disfata e darvinizmit përballë shkencës mund të përmblihet në tre tituj kryesorë:

- 1) Teoria nuk arrin të shpjegojë se si ka zënë fill jeta në tokë.
- 2) Nuk gjendet asnjë zbulim shkencor që tregon se

“mekanizmat e evolucionit” të propozuara nga kjo teori, posedojnë asnjë force evoluese.

3) Të dhënat fosile provojnë pikërisht të kundërtën e ideve të parashtruara nga kjo teori.

Në këtë pjesë, do të shtjellojmë në vija të përgjithshme këto tri çështje themelore:

Pengesa e parë e pakapërcyeshme: Zanafilla e jetës

Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha speciet rrjedhin nga një qelizë e vetme e shfaqur në Tokën primitive 3.8 miliardë vjet më parë. Si është e mundur që një qelizë e vetme të ndërtojë miliona specie të gjalla e të komplikuar dhe, nëse me të vërtetë ka ndodhur diçka e tillë, përse nuk gjendet asnjë gjurmë në të dhënat fosile janë disa nga pyetjet në të cilat teoria nuk është në gjendje të jap përgjigje. Por në fillim, duhet të pyetemi: Si u krijua kjo “qelizë e parë”?

Meqë teoria e evolucionit e mohon krijimin dhe çfarëdo ndërhyrje të mbinatyrshme, ajo supozon se “qeliza e parë” është shfaqur rastësisht pa asnjë projektim, planifikim apo rregullim, përbrenda ligjeve të natyrës. Sipas kësaj teorie, materia e pajetë duhet të ketë krijuar rastësisht qelizën e gjallë. Por kjo hipotezë bie ndesh me ligjet më të pakundërshtueshme të biologjisë.

“Jeta rrjedh nga jeta”

Darvini, në librin e tij, nuk ka folur kurrë mbi zanafillën e jetës. Koncepti primitiv shkencor në periudhën kur jetoi ai supozonte se gjallesat zotërojnë një konstrukt shumë të thjeshtë. Sipas teorisë së krijimit të rastësishme që besohet në mesjetë, lëndët e pajetë/inorganike, duke u bashkuar, mund të formojnë një qenie të gjallë. Në atë periudhë ishte shumë i përhapur mendimi se insektet formoheshin nga tepricat e ushqimeve, ndërsa minjtë nga gruri. Për

të provuar diçka të tillë janë bërë eksperimente nga më të çuditshmet: Një leckë e ndotur me pak grurë mbi të, në një anë, ndërsa në anën tjetër një shkencëtar, duke pritur që pas një kohe të formoheshin minj.

Gjithashtu mendohej se shfaqja e krimbave në një copë mishi ishte dëshmi e krijimit të vetvetishëm/spontan. Por më vonë do të kuptohej se ata krimba nuk formoheshin vetvetiu në mish, por nga larvat e padukshme për syrin që silleshin nga mizat.

Madje edhe kur Darvini shkroi librin *Origjina e Llojeve*, besimi se bakteret formoheshin nga materia e pajetë ishte një gjë e pranuar gjerësisht në botën e shkencës.

Por vetëm 5 vite pas botimit të librit të Darvinit, Lui Paster shpalli përfundimet e arritura pas shumë studimeve dhe eksperimenteve të gjata që rrëzuan plotësisht krijimin spontan, i cili përbënte gur-themel in e teorisë së Darvinit. Në ligjëratën e tij triumfale në Sorbonë në vitin 1864, Pasteri tha: “Kurrë më nuk do të rimarr veten krijimi spontan prej grushtit vdekjeprurës të dhënë nga ky eksperiment i thjeshtë.”¹²

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit i kundërshtuan për një kohë të gjatë zbulimet e Pasterit. Mirëpo shkenca, e cila po përparonte duke nxjerrë në dritë ndërtimin kompleks të qelizës së organizmit të gjallë, e përforcoi edhe më tepër pavlefshmërinë e pretendimeve mbi krijimin e rastësishëm të jetës.

Përpyekjet e pafrytshme të shekullit njëzet

Evolucionisti i parë, i cili u mor me çështjen e zanafillës së jetës në shekullin e njëzet ishte biologu i njohur rus Aleksandër Oparin, i cili u mundua të provonte, me anë të një sërë tezash të hedhura nga vetë ai në vitet 1930, se qeliza e gjallë mund të krijohej rastësisht. Por këto punime do të dilnin të pasuksesshme dhe Oparin do të detyrohej ta bënte këtë rrëfim:

Mirëpo, fatkeqësisht, çështja e zanafillës së qelizës përbën ndoshta pikën më të errët të gjithë studimit të evolucionit të organizmave.¹³

Pasuesit evolucionist të Oparinit u munduan të bënin eksperimente për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje. Më i njohuri nga këto eksperimente ishte ai që u ndërmor në vitin 1953 nga kimisti amerikan Stenli Miler, i cili, duke bashkuar gazrat, që ai pretendonte se kishin ekzistuar në atmosferën primitive në një ambient eksperimental dhe duke i ekspozuar ato ndaj një burimi të jashtëm energjie, Milleri formoi disa molekula organike (aminoacide) të pranishme në strukturën e proteinave.

Mezi kishin kaluar disa vite para se të zbulohesh se ky eksperiment, i cili atëherë u paraqit si një hap i rëndësishëm në emër të evolucionit, ishte i pavlefshëm, sepse atmosfera e përdorur në këtë eksperiment ishte shumë më e ndryshme nga kushtet reale të Tokës.¹⁴

Pas një periudhe të gjatë heshtjeje, Milleri pranoi se atmosfera e përdorur nga ai nuk ishte reale.¹⁵

Të gjitha përpjekjet evolucioniste që u ndërmorën gjatë shekullit të njëzet për të shpjeguar zanafillën e jetës përfunduan pa sukses. Xhefri Bada, gjeo-kimisti i njohur nga Instituti Skrips i San Diegos, në një artikull të botuar në vitin 1998 në revistën “*Earth (Toka)*”, pranon këtë fakt:

Sot, duke e lënë pas shekullin e njëzet, akoma përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim kur hymë në shekullin e njëzet: Si zuri fill jeta në tokë?¹⁶

Ndërtimi i ndërlikuar i jetës

Shkaku kryesor që çështja mbi zanafillën e jetës ka hyrë në një dilemë të tillë është se madje ata organizma të gjallë që mendohej të

jenë më të thjeshtat kanë ndërtim jashtëzakonisht të ndërlikuar. Qeliza e një gjallese është shumë më e ndërlikuar se të gjitha produktet teknologjike që ka arritur të prodhojë njeriu. Sot, madje edhe në laboratorët më të përparuara të botës, duke bashkuar materie kimike organike, nuk do të mund të arrijmë kurrë të përfitojmë një qelizë të vetme.

Kushtet që nevojiten për formimin e një qelize janë aq të shumta sa kurrë nuk mund të shpjegohen me rastësi. Probabiliteti që proteinat, njësia bazë e qelizës, të sintetizohen rastësisht është 1 në 10^{950} (për një proteinë mesatare me 500 aminoacide). Në matematikë probabilitetet më të vogla se 10^{50} konsiderohen të pamundura.

Molekula e ADN-së përmban informacionet gjenetike si një bankë informacionesh me kapacitet të pabesueshëm. Nëse do ta hidhnim në letër informacionin që përfshin ADN-ja e njeriut, do të krijohej një bibliotekë me 900 volume enciklopedike me nga 500 faqe secili.

Në këtë pikë shfaqet një dilemë shumë interesante: ADN-ja mund ta kopjoj/përsëris vetveten vetëm me ndihmën e disa proteinave të specializuara (enzimave). Mirëpo, sinteza e këtyre enzimave mund të realizohet vetëm me anë të informacionit të koduar në ADN. Pasi që ato të dyja janë të varura nga njëra tjetra, ato duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë për kopjim/përsëritje. Kjo e sjellë skenarin se jeta ka zënë fill vetvetiu në një rrugë pa krye. Prof. Lesli Orgel, një evolucionist me reputacion nga Universiteti i San Diegos në Kaliforni, e pranon këtë fakt në botimin e revistës *Scientific American* të Shtatorit të vitit 1994:

Është krejtësisht e pamundshme që proteinat dhe acidet nukleike, duke qenë të dyja komplekse për nga ndërtimi, të jenë krijuar vetvetiu në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Po ashtu duket e pamundshme ta kemi

njërën pa tjetrën. Dhe kështu, në shikim të parë, njeriut do t'i duhej të vjen në përfundimin se, në të vërtetë, jeta kurrë nuk ka mundur të zë fill me anë të mjeteve kimike.¹⁷

Padyshim, nëse është e pamundur që jeta të ketë zënë fill nga shkaqet natyrore, atëherë duhet të pranohet se jeta u “krijua” në mënyrë të mbinatyrshme. Ky fakt zhvlerëson në mënyrë të qartë teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është të mohoj krijimin.

Mekanizmat imagjinarë të evolucionit

Çështja e dytë e rëndësishme që e bën teorinë e Darvinit të pavlefshme është se të dy konceptet e paraqitura nga kjo teori si “mekanizma të evolucionit”, u kuptua se në të vërtetë nuk zotërojnë asnjë forcë evoluese.

Darvini e mbështeti hipotezën e tij në tërësi në mekanizmin e “seleksionimit natyror.” Rëndësia që i jepte këtij mekanizmi mund të kuptohet fare lehtë edhe nga titulli i librit të tij: Origjina e Llojeve nëpërmjet seleksionimit natyror”...

Seleksionimi natyror pohon se ato gjallesa që janë më të fuqishme dhe që i përshtaten më mirë kushteve natyrore të vendbanimeve të tyre do të mbijetojnë në luftën për jetë. P.sh., në një kope sorkadhesh që kërcënohet prej kafshëve të ndryshme grabitqare, do të mbijetojnë vetëm ato sorkadhe që vrapojnë më shpejt. Kështu që kopeja e sorkadheve do të përbëhet nga individët më të fortë dhe më të shpejtë. Mirëpo, sigurisht që ky mekanizëm nuk mund të shkaktojë evoluimin e sorkadheve e t'i kthejë në një lloj tjetër gjallese, për shembull, në kuaj.

Për këtë arsye, mekanizmi i seleksionimit natyror nuk zotëron asnjë forcë evoluese. Edhe Darvini ishte i ndërgjegjshëm për këtë realitet, ndaj në librin e tij Origjina e Llojeve u detyrua të pohonte:

Seleksionimi natyror s'mund të bëjë asgjë përderisa nuk shfaqen dallime dhe ndryshime të dobishme individuale.¹⁸

Ndikimi i Lamarkut

Si mund të formoheshin këto ndryshime të dobishme? Darvini, kësaj pyetjeje u mundua t'i përgjigjej nga këndvështrimi i të kuptuarit primitiv të shkencës së asaj kohe. Sipas biologut francez Shevalie Lamark (1774-1829), i cili ka jetuar para Darvinit, gjallesat ia përcollën brezit pasardhës të gjitha ndryshimet fizike, të cilat kishin fituar gjatë jetës së tyre. Ai pohonte se këto cilësi, të cilat u akumuluan nga një brez në tjetrin, bënë që të formohen specie të reja. Për shembull, ai pohonte se gjirafat evoluuan nga antilopat gjatë përpjekjeve të tyre për të arritur gjethet e pemëve të larta, qafat e tyre u zgjatën nga njëri brez në tjetrin

Edhe Darvini ka dhënë shembuj të ngjashëm. Në librin e tij Origjina e Llojeve, për shembull, ai thotë se disa arinj për të gjetur ushqim në thellësi të detit me kohë u shndërruan në balena.¹⁹

Por zbulimet e Gregor Mendelit (1822-1884) të ligjeve të trashëgimisë, të cilat u saktësuan nga shkencë e gjenetikës, e cila lulëzoi në shekullin e njëzet, hedhën poshtë plotësisht legjendën e përcjelljes së karakteristikave të fituara në brezat pasardhës. Kështu, u vërtetua përfundimisht se seleksionimi natyror ishte një mekanizëm joefektiv.

Neo-darvinizmi dhe mutacionet

Për të gjetur një zgjidhje, darvinistët nxorën në dritë "Teorinë Sintetike Moderne", apo siç njihet ndryshe Neo-Darvinizmin, në fund të viteve 1930. Neo-Darvinizmi shtoi mutacionet, të cilat janë shtrembërime të formuara në gjenet e gjallesave për shkak të

faktorëve të tillë të jashtëm si rrezatimi apo gabimet në përsëritje, si “shkaqe të ndryshimeve të dobishme” përveç mutacionit natyror.

Modeli, i cili edhe sot e ruan vlerën në emër të evolucionit, është Neo-Darvinizmi. Sipas kësaj teorie miliona gjallesa në botë u formuan si rezultat i një procesi me anën e të cilit organe të shumta komplekse të këtyre organizmave (p.sh., veshët, mushkëritë dhe krahët) iu nënshtruan “mutacioneve,” domethënë çrregullimeve gjenetike. Por ekziston një fakt i prerë shkencor që plotësisht e hedh poshtë këtë teori: Mutacionet nuk i zhvillojnë gjallesat, përkundrazi, ato janë gjithmonë të dëmshme.

Arsyeja për këtë është shumë e thjeshtë: ADN-ja zotëron një ndërtim shumë të ndërlikuar dhe çdo ndikim spontan mbi këtë molekulë, mund vetëm t’i shkaktojë dëm asaj. Gjeneticisti amerikan B. G. Ranganathan e shpjegon këtë fakt si në vazhdim:

Së pari, mutacionet e vërteta janë shumë të rralla në natyrë. Së dyti, shumica e mutacioneve janë të dëmshme pasi që janë të rastësishme, më parë se ndryshime të rregullta në strukturën e gjeneve; çfarëdo ndryshimi i rastësishëm në një sistem tejet të rregullt do të ndikojë për të keq, jo për të mirë. Për shembull, nëse një tërmet do të dridhte një ndërtim tejet të rregullt siç është një ndërtesë, do të ndodhte një ndryshim i rastësishëm në kornizën e ndërtesës, i cili sipas të gjitha gjasave, nuk do të ishte një përmirësim.²⁰

Nuk çudit fakti se deri më sot nuk është vëzhguar asnjë rast i ndonjë mutacioni të dobishëm, domethënë, i cili është parë të zhvilloj kodin gjenetik. Është vërtetuar se të gjitha mutacionet janë të dëmshme. Është kuptuar se mutacioni, i cili është paraqitur si një “mekanizëm i evolucionit,” është në të vërtetë një dukuri gjenetike që dëmton gjallesat dhe i lë të gjymtuara. (Efekti më i zakonshëm i mutacionit në qeniet njerëzore është kanceri.) Natyrisht, një

mekanizëm shkatërrues nuk mund të jetë “mekanizëm evolutiv.” Seleksionimi natyror, në anën tjetër, “s’ mund të bëj asgjë i vetëm,” siç e pranoi edhe Darvini. Ky fakt na tregon se nuk ekziston ndonjë “mekanizëm evolutiv” në natyrë. Pasi që nuk ekziston asnjë mekanizëm evolutiv, asnjë proces i tillë i imagjinuar i quajtur “evolucion” nuk ka mundur të ndodhë.

Të dhënat fosile: asnjë gjurmë e formave kalimtare

Të dhënat fosile janë treguesi më i qartë se skenari që sugjerohet nga teoria evolucionit nuk ka ndodhur kurrë.

Sipas kësaj teorie, të gjitha gjallesat kanë evoluar nga një paraardhës. Një specie, e cila ekzistonte më parë, me kalimin e kohës, u shndërrua në diçka tjetër dhe të gjitha speciet u krijuan në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera, ky transformim u zhvillua gradualisht gjatë një periudhe të gjatë prej qindra miliona vjetësh.

Po të kishte qenë kështu, lloje të shumta kalimtare duhej të kishin ekzistuar dhe jetuar brenda kësaj periudhe të gjatë transformimi.

Për shembull, disa krijesa gjysmë peshk–gjysmë zvarranik duhej të kishin jetuar në të kaluarën të cilat kishin fituar disa tipare zvarranikësh, përveç tipareve të peshkut të cilat ato tashmë i kishin. Apo duhej të kishin ekzistuar disa zvarranik-zogj, të cilët fituan disa tipare të zogjve përveç tipareve të zvarranikëve që ato tashmë i kishin. Meqë këto gjallesa do të duhej të kishin ekzistuar në një periudhë kalimtare, gjallesat duhet të kenë qenë të gjymtuara dhe me një sërë të metash. Evolucionistët, këto qenie imagjinare që besojnë të kenë jetuar në të kaluarën, i quajnë “forma kalimtare”.

Nëse me të vërtetë do të kishin ekzistuar gjallesa të tilla në të kaluarën, atëherë do të duhej të kishte me miliona dhe madje miliarda sosh për nga numri dhe llojllojshmëria. Ajo që është më me

rëndësi, mbetjet e këtyre qenieve të çuditshme do të duhej të haseshin në të dhënat fosile. Darvini, në librin Origjina e Llojeve, këtë fakt e shpjegon kështu:

Nëse teoria ime është e vërtetë, atëherë forma kalimtare të panumërta që lidhin speciet e të njëjtit grup, duhet të kenë ekzistuar sigurisht... Si rrjedhim, provat për ekzistencën e tyre të mëparshme do të mund të gjendeshin vetëm në mbetjet fosile.”²¹

Shpresat e venitura të Darvinit

Mirëpo, edhe pse janë bërë shumë kërkime intensive për të gjetur fosilet që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë në mbarë botën, ende nuk është gjetur asnjë formë kalimtare. Të gjitha fosilet, në kundërshtim me atë që shpresonin evolucionistët, tregojnë se jeta në Tokë u shfaq rastësisht, krejt papritur dhe plotësisht e formuar.

Një paleontolog i njohur britanik, Derek V. Ager, edhe pse një evolucionist, e pranon këtë realitet:

Problemi ynë është ky: Tek analizojmë me hollësi të dhënat fosile në nivelin e klasave apo llojeve, hasim gjithmonë e më tepër jo evolucion gradual, por shpërthim të papritur të një lloji në llogari të një tjetri.²²

Me fjalë të tjera, te fosilet e gjetura, të gjitha llojet e gjallesave shfaqen papritmas dhe në formën e tyre të përfunduar, pa asnjë formë të ndërmjetme në mes. Kjo është pikërisht e kundërta e supozimeve të Darvinit. Për më tepër, kjo është një provë shumë e fortë që gjallesat janë krijuar. I vetmi shpjegim që një specie e gjallë të shfaqet papritmas e plotë dhe pa paraardhës nga i cili të ketë evoluar është se ajo u krijua. Kjo e vërtetë është pranuar po ashtu nga biologu i mirënjohur evolucionist Douglas Futuyuma:

Krijimi dhe evolucioni janë dy shpjegimet e vetme që mund të bëhen rreth origjinës së qenieve të gjalla. Krijimi dhe evolucioni, në mes tyre, shter

shpjegimet e mundshme për zanafillën e gjallesave. Organizmat ose janë shfaqur në tokë të zhvilluara plotësisht, ose jo. Në rast se nuk janë zhvilluar gradualisht, ato duhet të jenë zhvilluar nga specie që kanë ekzistuar më parë me anë të ndonjë procesi modifikimi. Në rast se janë shfaqur plotësisht të zhvilluara, ato me të vërtetë duhet të jenë krijuar nga ndonjë intelekt i plotfuqishëm.²³

Fosilet tregojnë se qeniet e gjalla u shfaqën në Tokë të formuara plotësisht dhe në gjendje të përkryer. Me fjalë të tjera “origjina e llojeve,” në kundërshtim me supozimin e Darvinit, nuk është evolucioni, por krijimi.

Përralla e evolucionit të njeriut

Çështja që trajtohet më shpesh nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit është prejardhja e njeriut. Mendimi darvinist mbi këtë çështje thotë se qeniet njerëzore moderne që jetojnë sot kanë evoluar nga disa krijesa të ngjashme me majmunët. Gjatë kësaj periudhe të supozuar, e cila mendohet të ketë filluar rreth 4-5 milionë vjet më parë, pretendohet se kanë jetuar “forma kalimtare” midis njeriut modern dhe të parëve të tij. Ka katër “kategori” bazë në gjithë këtë skenar të imagjinuar:

1. Australopiteku
2. Homo habilis
3. Homo erectus
4. Homo sapiens

Evolucionistët i japin emrin “Australopitek” (që do të thotë “majmuni i jugut”), të ashtuquajturit paraardhës të parë të njeriut të ngjashëm me majmunët. Këto qenie të gjalla nuk janë në fakt asgjë tjetër, përveçse një specie e zhdukur majmuni. Kërkimet e shumta të Lordit Solli Cukerman dhe Profesorit Çarlls Oksnard, dy anatomistë

me famë botërore nga Anglia dhe SHBA-ja, rreth mbetjeve të australopitekëve tregojnë se këto qenie i përkisnin një lloji të majmunit të zhdukur dhe se nuk kishin asnjë ngjashmëri me qeniet njerëzore.²⁴

Evolucionistët e quajnë fazën tjetër të evolucionit njerëzor “homo,” domethënë “njeri”. Sipas këtij pretendimi, qeniet e gjalla të serisë “homo” ishin më të zhvilluara se australopitekët. Evolucionistët i vendosën fosilet e këtyre krijesave të ndryshme pranë njëra-tjetrës me një renditje të caktuar dhe përpiluan një plan imagjinar evolucioni. Ky plan është imagjinar, sepse faktikisht asnjë lidhje evolucionare mes këtyre klasave të ndryshme nuk është provuar. Ernst Majër, njëri prej mbrojtësve më të rëndësishëm të teorisë së evolucionit në shekullin e njëzet në librin e tij Një argument i gjatë pohon se: “në veçanti (enigmat) historike si zanafilla e jetës apo e Homo sapiensit, janë tejet të vështira dhe mund madje t’i bëjnë ballë një shpjegimi përfundimtar të kënaqshëm.”²⁵

Kur konturojnë zinxhirin Australopitek > Homo Habilis > Homo Erektus > Homo Sapiens, evolucionistët nënkuptojnë se këto specie kanë qenë paraardhëse të njëra-tjetrës. Mirëpo, zbulimet më të fundit të paleo-antropologëve tregojnë se Austrolopiteku, Homo Habilis dhe Homo Erektus kanë jetuar në të njëjtën periudhë në pjesë të ndryshme të botës.²⁶

Për më tepër, një segment i caktuar njerëzish i klasifikuar si Homo Erektus ka jetuar deri në kohërat moderne. Homo sapiensi, Neandertalët dhe Homo Sapiens Sapiens (njeriu modern) kanë bashkëjetuar në të njëjtin rajon.²⁷

Kjo, sigurisht, provon përfundimisht se këto specie nuk ishin paraardhëse të njëra-tjetrës. Stefën Xhej Gould, njëri prej

paleontologëve të universitetit të Harvardit, megjithëse është evolucionist, e shpjegon qorrsokakun në të cilin gjendet teoria darviniste në këtë mënyrë:

Çfarë i ndodhi shkallës sonë, nëse bashkekzistojnë tri linja hominide (A. Afrikanus, Robust Australopitekët robust (shtatmëdhenj) dhe H. Habilis) që nuk rrjedhin nga njëra-tjetra? Për më tepër, asnjë nga të tre nuk shfaq ndonjë tendencë evolutive gjatë qëndrimit të tyre në tokë.²⁸

Me pak fjalë, i gjithë skenari i evolucionit njerëzor që po mbahet gjallë me ndihmën e vizatimeve të ndryshme të krijesave imagjinare “gjysmë-majmun-gjysmë-njeri”, që shfaqen në media apo libra shkollorë, domethënë, sinqerisht, me anë të metodave propagandistike, s’janë gjë tjetër veçse një mit pa asnjë bazë shkencore.

Lordi Solli Cukerman, një nga shkencëtarët më të njohur dhe më të spikatur të Mbretërisë së Bashkuar, e ka studiuar këtë çështje për vite me radhë dhe ka kryer një punë kërkimore 15-vjeçare mbi fosilet e Australopitekut. Edhe pse evolucionist, ai arriti në përfundimin se, në të vërtetë, nuk ekziston asnjë pemë gjenealogjike midis majmunit dhe njeriut.

Cukerman gjithashtu bëri një “spektër interesant të shkencave”, duke i radhitur ato nga ato që ai i konsideronte si më shkencoret tek ato që i konsideronte si më joshkencoret. Sipas spektrit të Cukermanit, më “shkencoret,” duke marrë parasysh mbështetjen e tyre në argumente, janë shkenca e fizikës dhe kimisë. Më pas vijnë shkencat biologjike dhe pastaj shkencat shoqërore. Në fund fare, në pjesën që konsiderohet të jetë si pjesa më “joshkencore”, radhitet “perceptimi jashtë-shqisor” – konceptet si telepatia dhe shqisa e gjashtë – dhe në fund të fundit u vendos “evolucioni i njeriut”. Cukerman shpjegon kështu arsyetimin e tij:

Më pas zhvendosim regjistrin e të vërtetës objektive në drejtim të atyre fushave të shkencës të konsideruara si shkenca biologjike, si p.sh. perceptimi jashtë-shqisor apo interpretimi i historisë së fosileve të njeriut, ku për (evolucionistin) besnik gjithçka është e mundur – dhe ku besimtari i zjarrtë (i evolucionit ndonjëherë është në gjendje të besojë shumë gjëra kontradiktore në të njëjtën kohë.²⁹

Siç shihet, evolucioni njerëzor nuk është gjë tjetër veçse një përmbledhje e “disa interpretimeve të paragjykuara të fosileve të zhvarrosura prej njerëzve të caktuar, të cilët ndjekin verbërisht teorinë e tyre.

Formula e Darvinit!

Përveç të gjitha provave teknike me të cilat jemi marrë gjer më tani, le ta shtjellojmë njëherë, se çfarë paragjykimi kanë evolucionistët me një shembull të thjeshtë që të kuptohet madje edhe prej fëmijëve:

Teoria e evolucionit pohon se jeta u krijua rastësisht. Sipas këtij pohimi, atomet e pajetë dhe të pavetëdije u bashkuan për të formuar qelizën dhe pastaj ata disi formuan gjallesat tjera, duke përfshirë edhe njeriun. Le të mendojmë për këtë. Kur i bashkojmë elementet që janë bazë e ndërtimit jetës si karboni, fosfori, nitrogjeni dhe potasiumi, vetëm një grumbull formohet. Pa marrë parasysh se çfarë trajtimi i nënshtrohet, ky grumbull atomesh nuk mund të formojë madje as edhe një gjallesë të vetme. Nëse dëshironi, le ta formulojmë një “eksperiment” në lidhje me këtë çështje dhe ta shtjellojmë në emër të evolucionistëve atë që ata vërtet e pohojnë pa e shprehur zëshëm me emrin “formula e Darvinit”:

Le të vendosin materialistët plot materiale të pranishme në përbërjen e gjallesave si fosfori, nitrogjeni, karboni, oksigjeni, hekuri dhe

FSHEHTËSIA E SPROVËS

magneziumi në fuçi të mëdha. Veç kësaj, le të shtojnë në këto fuçi çfarëdo lloj materiali që nuk ekziston në kushte normale, por që ata mendojnë se është i domosdoshëm. Le të shtojnë në këtë përzierje aq sa të dëshirojnë amino acide – të cilat nuk kanë mundësi të formohen në kushte natyrore – dhe proteina – që një e vetme e ka probabilitetin e formimit 10 në 950 – sa të duan. Le t’ia ekspozojnë këto përzierje deri në masën që dëshirojnë nxehtësisë dhe lagështisë. Le t’i përziejnë këto me çfarëdo pajisje të përparuar teknologjike që të duan. Le t’i vënë shkencëtarët më të shquar pranë këtyre fuçive. Le të presin këta ekspert me radhë pranë këtyre fuçive për miliarda dhe trilionë vite. Le të lejohen të përdorin të gjitha llojet e kushteve që ata besojnë të jenë të domosdoshme për formimin e një njeriu. Pa marrë parasysh se çfarë bëjnë, ata nuk mund ta krijojnë një njeri prej këtyre fuçive, të themi një profesor që ekzaminon strukturën e qelizës së tij nën një mikroskop elektronik. Ata nuk mund të krijojnë gjirafa, luanë, bletë, kanarina, kuaj, delfinë, trëndafila, orkide, zambakë, karafila, banane, portokaj, molla, hurma, domate, pjepra, shalqi, fiq, ullinj, rrush, pjeshka, pallojë, fazanë, flutura shumëngjyrëshe apo me miliona gjallesa si këto. Me të vërtetë, ata nuk do të mund të përfitonin as edhe një qelizë të vetme prej cilëso prej tyre.

Thënë shkurt, atomet e pavetëdijshme nuk mund të formojnë qelizën duke u bashkuar. Ato nuk mund të marrin një vendim të ri dhe ta ndajnë këtë qelizë më dysh dhe pastaj të marrin vendime tjera dhe të krijojnë profesorët të cilët së pari shpikin mikroskopin elektronik dhe pastaj ekzaminojnë strukturën e qelizës së vet nën atë mikroskop. Materia është një grumbull i pavetëdijshëm, i pajetë dhe ajo vjen në jetë me krijimin e lartë të Allahut.

Teoria e evolucionit, e cila pohon të kundërtën e kësaj, është një gjykim plotësisht i gabuar i kundërt me arsyen. Të menduarit madje edhe vetëm për pak kohë për pohimet e evolucionistëve zbulon këtë të vërtetë, sikurse në shembullin më lartë.

Teknologjia e syrit dhe veshit

Një çështje tjetër që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e shkëlqyer e perceptimit të syrit dhe veshit.

Para se të kalojmë te syri, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes "Si shohim ne?" Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt, bien në retinën e syrit duke dhënë një imazh të përmbysur të objektit. Këtu, këto rreze drite transformohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe pastaj përcillen në një zonë të vogël në pjesën e prapme të trurit, ku ndodhet "qendra e shikimit". Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër të trurit si imazh pas një sërë procesesh. Le të mendojmë pak, duke u bazuar në këto njohuri teknike.

Truri është i izoluar tërësisht nga drita. Kjo do të thotë se pjesa e brendshme e trurit është në errësirë të plotë dhe drita nuk arrin atje. Qendra e shikimit është një vend në errësirë të plotë ku nuk hyn kurrë dritë. Ka mundësi që të jetë vendi më i errët që ekziston. Megjithatë, ne shikojmë një botë të ndritshme plot dritë në këtë errësirë të plotë.

Imazhi i formuar në sy është kaq i mprehtë dhe i qartë, sa që as teknologjia e shekullit njëzet nuk ka arritur ta realizojë. Për shembull, shikoni librin që jeni duke e lexuar, duart me të cilat e mbani atë dhe pastaj ngrini kokën dhe shikoni përreth. A keni parë ndonjëherë një imazh të tillë të mprehtë e të qartë si ky në ndonjë vend tjetër? Edhe ekrani më i zhvilluar i televizorit i prodhuar nga prodhuesi më i fuqishëm i televizorëve në botë nuk mund të sigurojë një imazh aq të mprehtë për ju. Ky është një imazh tre-dimensional, me ngjyra dhe jashtëzakonisht i pastër. Për vite të tëra, mijëra inxhinierë janë përpjekur të prodhojnë një televizor tre-dimensional, i cili mund të arrijë cilësinë e shikimit të syrit. Ata kanë arritur të shpikin një sistem TV tre-dimensional, por ai nuk mund të shihet pa vendosur një palë syze speciale 3-D. Për më tepër, bëhet

fjalë vetëm për një tre-dimensional artificial. Sfondi është më i mjegulluar, ndërsa plani i parë duket sikur është dekor prej letre. Asnjëherë s'ka qenë e mundur të arrihet një imazh me cilësinë e syrit. Edhe në kamera apo në televizor, ka një humbje të cilësisë së imazhit.

Evolucionistët pretendojnë se mekanizmi që prodhon këtë imazh të mprehtë e të qartë është formuar krejt rastësisht. Nëse dikush do t'ju thoshte se televizori në dhomën tuaj është formuar si rezultat i bashkimit të rastësishëm të miliona atomeve, çfarë do të mendonit ju? Si mund ta bëjnë atomet atë që mijëra njerëz s'e bëjnë dot?

Nëse një pajisje që prodhon një imazh më primitiv se syri nuk mund të jetë formuar rastësisht, atëherë është shumë e qartë që edhe syri apo imazhi që shikohet prej tij nuk mund të jenë krijuar rastësisht. E njëjta gjë vlen edhe për veshin. Veshi i jashtëm i kap tingujt dhe i drejton te veshi i mesëm, i cili ia përcjell veshit të brendshëm duke i përforcuar ato. Veshi i brendshëm ia dërgon valët zanore trurit, duke i kthyer në sinjale elektrike. Ashtu si me shikimin, procesi i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit në tru.

Ajo që thamë për syrin është e vërtetë edhe për veshin. D.m.th. truri është i izoluar nga tingujt, ashtu si është i izoluar edhe nga drita: asnjë tingull nuk mund të depërtojë brenda. Prandaj, s'ka rëndësi sa zhurmë ka jashtë, brenda trurit mbizotëron një qetësi absolute. Megjithatë edhe tingujt më të mprehtë perceptohen nga truri.

Nëpërmjet trurit tonë, i cili është i izoluar nga tingujt, ne dëgjojmë simfoninë e ekzekutuar nga një orkestër apo zhurmat në një vend të mbushur plot me njerëz. Megjithatë, nëse bëhet një matje ekzakte e nivelit të tingujve në trurin tonë në këto momente, do të kuptonim se një qetësi absolute mbizotëron aty.

Ashtu si në rastin e imazhit, dekada të tëra përpjekjesh kanë

kaluar për të krijuar dhe riprodhuar tinguj sa më të afërt me origjinalin. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë regjistruesit e zërit, sistemet HI-FI dhe sistemet e ndryshme për kapjen e tingujve. Pavarësisht nga teknologjia e përparuar dhe përpjekjet e mijëra inxhinierëve e ekspertëve, nuk është përfituar asnjë tingull që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi si tingulli që kapet nga veshi. Mendoni për sistemet HI-FI të cilësisë më të lartë të prodhuar nga kompania më e madhe e industrisë së muzikës. Edhe në këto pajisje, kur regjistrohet zëri, humbet një pjesë e cilësisë. Kur ndizni një HI-FI gjithmonë dëgjoni një zhurmë të lehtë para se të fillojë muzika. Veshi i njeriut asnjëherë nuk e kap një tingull të shoqëruar me zhurmë; ai e kap tingullin pikërisht ashtu siç është, i mprehtë e i qartë. Kështu ka qenë gjithmonë që nga krijimi i njeriut.

Kujt i takon ndërgjegjja që sheh dhe dëgjon në brendi të trurit?

Kush shikon një botë joshëse në trurin tonë, dëgjon simfonitë dhe cicërimën e zogjve dhe ndien aromën e trëndafilut?

Nxitjet që vijnë prej syve, veshëve dhe hundës së një personi shkojnë në tru si impulse nervore elektro-kimike. Në librat e biologjisë, fiziologjisë dhe biokimisë, mund të gjeni shumë hollësi për mënyrën se si ky imazh formohet në tru. Mirëpo, kurrë nuk do të mund të ndesheni me faktin më të rëndësishëm: Kush i pranon këto impulse nervore elektro-kimike si imazhe, tinguj, aroma dhe ngjarje shqisore në tru? Ekziston një ndërgjegje në tru që i pranon gjithë këto pa ndier ndonjë nevojë për një sy, vesh apo hundë. Kujt i takon kjo ndërgjegje? Natyrisht se nuk u takon nervave, shtresës yndyrore dhe neuroneve që e përbëjnë trurin. Kjo është arsyeja pse darvinistët-materialist, të cilët besojnë se gjithçka përbëhet prej materies, nuk mund të japin përgjigje në këto pyetje.

Sepse kjo ndërgjegje është shpirti i krijuar prej Allahut, i cili nuk ka nevojë as për syrin për të shikuar imazhet dhe as për veshin për t'i dëgjuar tingujt. Për më tepër, nuk ka nevojë për trurin për të menduar.

Çdo njeri që e lexon këtë fakt të qartë shkencor do të duhej të mendonte thellë për Allahun e Gjithëfuqishëm dhe të ketë frikë dhe të kërkoj strehim tek Ai, sepse Ai ngjesh tërë gjithësinë në një vend plotësisht të errët prej disa centimetrave kub në një formë tre-dimensionale, me ngjyra, me hije dhe të ndritshme.

Një besim materialist

Informacioni që kemi paraqitur deri tani tregon se teoria e evolucionit është një pretendim që bie hapur në kundërshtim me faktet shkencore. Pretendimi i teorisë në lidhje me prejardhjen e jetës është në kundërshtim me shkencën, mekanizmat e evolucionit të propozuara nga kjo teori nuk kanë asnjë forcë evolutive, dhe fosilet tregojnë se format kalimtare nuk kanë ekzistuar kurrë. Prandaj, teoria e evolucionit duhet të hidhet poshtë si një ide joshkencore. Në këtë mënyrë shumë ide, si modeli i gjithësisë me qendër Tokën, janë nxjerrë jashtë agjendës së shkencës gjatë historisë.

Por teoria e evolucionit vazhdon të mbahet me vendosmëri në listën e teorive shkencore. Disa njerëz madje përpiqen t'i paraqesin kritikën në adresë të saj si "sulm ndaj shkencës". Po pse ndodh kjo gjë?

Arsyeja për këtë situatë të krijuar është se për disa njerëz të cilët u përkasin disa qarqeve të caktuara, teoria e evolucionit është shndërruar në një besim dogmatik të domosdoshëm. Këto qarqe kapen fort pas filozofisë materialiste dhe ndikohen nga Darwinizmi, i cili për ta është shpjegimi i vetëm materialist për natyrën.

Nganjëherë ata e pranojnë hapur këtë. Riçard Levontin, gjenetist i famshëm nga universiteti i Harvardit dhe në të njëjtën kohë një evolucionist i njohur pranon se është “së pari materialist, pastaj shkencëtar”:

Nuk është puna se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyre na detyrojnë të pranojmë një shpjegim material për botën, por përkundrazi, ne jemi të detyruar nga përkrahja jonë arbitrare e kauzës materialiste të krijojmë një aparat hetimi dhe një sërë konceptesh që japin shpjegime materiale, edhe nëse janë kundër intuitës, pa marrë parasysh se sa të mjegullta janë për të panisurën. Për më tepër, materializmi është absolut, kështu që ne nuk mund të lejojmë të dalë në skenë një Qenie Hyjnore.³⁰

Këto fjalë janë deklarata të qarta se Darwinizmi është një dogmë e mbajtur gjallë për hir të lidhjes me filozofinë materialiste. Sipas kësaj dogme asgjë nuk ekziston përveç materies. Prandaj, ajo predikon se materia e pajetë dhe e pavetëdijshme krijoi jetën. Ajo këmbëngul se miliona specie të gjalla, (si zogjtë, peshqit, kafshët, insektet, pemët, lulet, balenat dhe qeniet njerëzore) u shfaqën si pasojë e bashkëveprimit të materies si shiut, rrufeve dhe kështu me radhë prej materies së pajetë. Ky besim është në kundërshtim të plotë si me arsyen ashtu edhe shkencën. Por darvinistët vazhdojnë të mbrojnë këtë besim me qëllim që “të mos lejojnë daljen në skenë të një Qenie Hyjnore.”

Kushdo që nuk e shikon prejardhjen e gjallesave me paragjykim materialist do ta kuptojë këtë të vërtetë të qartë: të gjitha gjallesat janë rezultat i krijimit të një Krijuesi, i Cili zotëron fuqi, dije dhe inteligjencë superiore. Ky Krijues është Allahu, i Cili krijoi tërë gjithësinë nga asgjëja, i Cili e konstrukttoi atë në mënyrën më të përkryer dhe u dha formë të gjitha gjallesave.

Teoria e evolucionit:

Magjia më e fuqishme në botë

Çdo njeri i lirë prej paragjykimit dhe ndikimit të çfarëdo ideologjie të caktuar, që përdor arsyen dhe logjikën e tij apo të saj, do të kuptojë qartë se besimi në teorinë e evolucionit, i cili na përkujton besëtytnitë e shoqërive pa dijeni të shkencës apo qytetërimit, është plotësisht i pamundshëm.

Siç u shpjegua më lartë, ata që besojnë në teorinë e evolucionit mendojnë se disa atome dhe molekula të hedhura në një fuçi të madhe do të mund të krijonin profesorë dhe studentë universiteti që janë në gjendje të mendojnë dhe gjykojnë; shkencëtarë si Ajnshtajni dhe Galileo; artistë si Hemfri Bogart, Frenk Sinatra dhe Luçano Pavaroti; si edhe antilopa, drurë limoni dhe karafila. Për më tepër, pasi që shkencëtarët dhe profesorët të cilët besojnë në këto gjeputura janë njerëz të shkolluar, është krejtësisht e arsyeshme të flitet për këtë teori si për “magjinë më të fuqishme në histori.” Asnjëherë më parë asnjë besim apo ide tjetër nuk ua ka larguar aftësinë e të gjykuarit të njerëzve, nuk ka pranuar t’i lejojë ata të mendojnë me mençuri dhe me arsye dhe ua ka fshehur të vërtetën sikur ata t’i kishin sytë e lidhur. Kjo është një verbëri madje edhe më e keqe dhe më e pabesueshme se adhurimi i Zotit të Diellit Ra nga egjiptianët, adhurimi i totemeve në disa pjesë të Afrikës, adhurimi i Diellit nga populli i Sabës, adhurimi i idhujve që kishin mbaruar me duart e tyre nga ana e fisit të Profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të) apo adhurimi i Viçit të Artë nga ana e popullit të Profetit Musa (paqja qoftë mbi të).

Në të vërtetë, Allahu ka theksuar këtë mungesë arsyeje në Kuran. Në shumë vargje, Ai zbulon se mendjet e disa njerëzve do të jenë të mbyllura dhe se ata do të jenë të pafuqishme të shohin të vërtetën. Disa nga këto vargje jepen në vazhdim:

Sa për ata që mohojnë, njësoj është, i paralajmërove apo nuk i paralajmërove - ata nuk besojnë. Allahu i ka vulosur zemrat e tyre, ndërsa në veshët dhe sytë e tyre kanë mbulesë; ata i pret një dënim i madh. (Sure Bekare: 6-7)

... Ata kanë zemra me të cilat nuk kuptojnë. Ata kanë sy me të cilët nuk shohin. Ata kanë veshë me të cilët nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur! Ata janë të pavetëdijshëm. (Sure A'raf: 179)

Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lart në të (e të shihnin engjëjt e fshehtësitë), ata vetëm do të thoshin: "Neve na janë ndalë sytë (të parët). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur. (Sure Hixhr: 14-15)

Fjalët nuk mund ta shprehin se sa është e habitshme se si kjo magji ka arritur të mbajë një komunitet aq të gjerë në skllavëri, t'i largojë njerëzit nga e vërteta dhe të mos ndërpritet për 150 vjet. Është e kuptueshme se një apo disa njerëz do të mund të besonin në skenarë dhe pohime të pabesueshme përplot marrëzi dhe mungesë arsyeje. Mirëpo, "magjia" është shpjegimi i vetëm i mundshëm për njerëzit në mbarë botën që besojnë se atomet e pavetëdijshme dhe të pajetë papritur vendosën të bashkohen dhe të formojnë një gjithësi që funksionon me një sistem të organizimit, rregullit, arsyes dhe vetëdijes së përkryer; një planet të quajtur Tokë me të gjitha veçoritë e saj të përshtatura në mënyrë aq të përkryer për jetën; dhe gjallesat përplot sisteme të panumërta komplekse.

Në të vërtetë, Kurani rrëfen ngjarjen e Profetit Musa dhe Faraonit për të treguar se disa njerëz të cilët përkrahin filozofitë ateiste në të vërtetë ndikojnë tek të tjerët me anë të magjisë. Kur iu tha Faraonit për fenë e vërtetë, ai i tha Profetit Musa të ndeshet me magjistarët e tij. Kur Musai e bëri këtë, ai u tha atyre që të tregojnë aftësitë e tyre të parët. Vargjet pasojnë:

“Hidhni ju!” – u përgjigj ai. Kur magjistarët hodhën shkopinjtë e tyre, i magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe shfaqën një magji të madhe. (Sure A’raf: 116)

Siç kemi vënë re, magjistarët e Faraonit ishin në gjendje të mashtrorjme çdo njeri, përveç Musait dhe atyre të cilët i besuan atij. Mirëpo, dëshmia e tij zhdukoi magjinë, apo “gëlltiti atë që ata kishin sajuar,” siç përshkruhet në ajet.

Atëherë Ne i kumtuam Musait: “Hidhe shkopin tënd!” - dhe ai filloi të gëlltiste gjithçka që trilluan ata. Në këtë mënyrë, doli në shesh e vërteta dhe dështoi ajo që kishin bërë ata. (Sure A’raf: 117-118)

Siç kemi vënë re, kur njerëzit e kuptuan se ata u magjepsën dhe se ajo që panë ishte vetëm një iluzion, magjistarët e Faraonit humbën gjithë besueshmërinë e tyre. Edhe në ditët tona, përveç nëse ata të cilët, nën ndikimin e një magjie të ngjashme, besojnë në këto pretendime qesharake nën maskën e tyre shkencore dhe kalojnë jetët e tyre duke i mbrojtur ato, i braktisin besimet e tyre paragjykuese, ata po ashtu do të poshtërohen kur e vërteta e plotë shfaqet dhe magjia priset. Në të vërtetë, Malkolm Magerixh, një filozof ateist dhe përkrahës i evolucionit, pranoi se ishte i brengosur pikërisht nga kjo perspektivë:

Unë personalisht jam i bindur se teoria e evolucionit, posaçërisht shtrirja e zbatimit të saj, do të jetë njëra prej shakave më të mëdha në librat e historisë në të ardhmen. Brezat e ardhshëm do të çuditen se si një hipotezë aq jo bindëse dhe e dyshimtë ka mundur të pranohej me naivitetin e pabesueshëm që ajo posedon.³¹

Se e ardhmja nuk është larg: Përkundrazi, njerëzit së shpejti do ta shohin se “rasti” nuk është hyjni dhe do të shikojnë prapa në teorinë e evolucionit si në mashtrimin më të keq dhe magjinë më të

tmerrshme në botë. Ajo magji tashmë ka filluar të ngrihet me shpejtësi prej shpatullave të njerëzve në mbarë botën. Shumë njerëz që e shohin fytyrën e saj të vërtetë po pyeten me habi se si është e mundur që të jenë kapluar prej saj.

***Engjujt thanë: “Larg nga të metat je
Ti o Zot! Ne nuk kemi asnjë dije tjetër
përveç asaj që na mësove Ti. Vërtet,
Ti je i Gjithëdijshëm e i Urtë.”
(Sure Bekare: 32)***

SHËNIMET

- 1- Fiqh as-Sunnah, vëll. 4, nr. 13.
- 2- Bediuzzaman Said Nursi, Pëmbledhja Risale-i Nur, Fjalët, Stacioni i dytë i fjalës së njëzetë.
- 3- Bediuzzaman Said Nursi, Pëmbledhja Risale-i Nur, Fjalët, Fjala e njëmbëdhjetë.
- 4- Bediuzzaman Said Nursi, Pëmbledhja Risale-i Nur, Dritët, Drita e njëzet e pestë, Ilaçi i nëntë.
- 5-Bediuzzaman Said Nursi, Pëmbledhja Risale-i Nur, Fjalët, Fjala e nëntëmbëdhjetë, Pikëza e dhjetë.
- 6-Bediuzzaman Said Nursi, Pëmbledhja Risale-i Nur, Dritët, Drita e dytë, Arsyeya e tretë
- 7-Bediuzzaman Said Nursi, Pëmbledhja Risale-i Nur, Maktubat.
- 8- Bediuzzaman Said Nursi, Pëmbledhja Risale-i Nur, Fjalët, Stacioni i dytë i fjalës së njëzetë.
- 9-Bediuzzaman Said Nursi, Pëmbledhja Risale-i Nur, Rrezet, Rrezja e katërmëdhjetë, Letrat.
- 10-Imam Ahmed, vëll. 1, nr. 387; Imam Ibën Kathir, Jeta e kësaj bote është kënaqësi e shkurtër.
- 11- Bediuzzaman Said Nursi, Pëmbledhja Risale-i Nur, Fjalët, Fjala e dhjetë, Aspekti i dymbëdhjetë.
12. Sidney Fox, Klaus Dose, Molecular Evolution and The Origin of Life, E.H. Freeman and Company, San Francisco, 1972, p. 4.
13. Alexander I. Oparin, Origin of Life, Dover Publications, NeëYork, 1936, 1953 (reprint), p. 196.
14. "Neë Evidence on Evolution of Early Atmosphere and Life", Bulletin of the American Meteorological Society, vol 63, November 1982, p. 1328-1330.
15. Stanley Miller, Molecular Evolution of Life: Current Status of the Prebiotic Synthesis of Small Molecules, 1986, p. 7.
16. Jeffrey Bada, Earth, February 1998, p. 40.
17. Leslie E. Orgel, "The Origin of Life on Earth", Scientific American, vol. 271, October 1994, p. 78.
18. Charles Darëin, The Origin of Species by Means of Natural Selection, The Modern Library, Neë York, p. 127.
19. Charles Darëin, The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition, Harvard University Press, 1964, p. 184.
20. B. G. Ranganathan, Origins?, Pennsylvania: The Banner Of Truth Trust, 1988, p. 7.
21. Charles Darëin, The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition, Harvard University Press, 1964, p. 179.
22. Derek A. Ager, "The Nature of the Fossil Record", Proceedings of the British Geological Association, vol 87, 1976, p. 133.
23. Douglas J. Futuyma, Science on Trial, Pantheon Books, Neë York, 1983, p. 197.
24. Solly Zuckerman, Beyond The Ivory Toëer, Toplinger Publications, Neë York, 1970, pp. 75-14; Charles E. Oxnard, "The Place of Australopithecines in Human Evolution: Grounds for Doubt", Nature, vol 258, p. 389.
25. "Could science be brought to an end by scientists' belief that they have final ansëers or by society's reluctance to pay the bills?" Scientific American, December 1992, p. 20.
26. Alan Ëalker, Science, vol. 207, 7 March 1980, p. 1103; A. J. Kelso, Physical Antropology, 1st ed., J. B. Lipincott Co., Neë York, 1970, p. 221; M. D. Leakey, Olduvai Gorge, vol. 3, Cambridge University Press, Cambridge, 1971, p. 272.
27. Jeffrey Kluger, "Not So Extinct After All: The Primitive Homo Erectus May Have Survived Long Enough To Coexist Ëith Modern Humans", Time, 23 December 1996.
28. S. J. Gould, Natural History, vol. 85, 1976, p. 30.
29. Solly Zuckerman, Beyond The Ivory Toëer, p. 19.
30. Richard Leëontin, "The Demon-Haunted Ëorld," The Neë York Revieë of Books, January 9, 1997, p. 28.
31. Malcolm Muggeridge, The End of Christendom, Grand Rapids:Eerdmans, 1980, p. 43.